



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 30 JANAR 2019**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 30. JANUARA 2019. GODINE**

**JANAR - JANUAR
2019**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark të Holandës (SPARK) mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica,
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-136 për ratifikimin e Marrëveshjes për kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria Ag për Projektin e sistemit për largimin e ujërave të zeza për komunën e Podujevës,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për protokollin shtesë 5 të Marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore,
7. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëfinancimin e bursave në nivel të studimeve master ndërmjet Ambasadës së Francës në Prishtinë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
8. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Raiffeisen Bank International AG për Projektin e ndërtimit të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm për komunën e Ferizajt,
9. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG në lidhje me financimin e Projektit për ndërtimin e sistemit të kanalizimit për komunën e Shtimes,
10. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG si huadhënës lidhur me financimin e Projektit ndërtimi i sistemit të furnizimit me ujë për komunën e Graçanicës,
11. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG në lidhje me financimin e Projektit për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit për komunën e Istogut,
12. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës,
13. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korigjim të kufijve” në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë,
14. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave,
15. Votimi në parim i Projektligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës,
16. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore,

17. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,
18. Votimi në parim i Projektligjit për peticione,
19. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
20. Votimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,
21. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
22. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës,
23. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin nr. 04/L-122, si dhe Ligjin nr. 03/L-073 për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256,
24. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve,
25. Interpelanca e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë nga GP i PSD-së, në lidhje me vdekjet dhe lëndimet e punëtorëve në vendin e punës,
26. Interpelanca e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, sipas kërkesës së kryetarit të GP të Partisë Socialdemokrate, z. Dardan Sejdiu, i mbështetur edhe nga 11 deputetë, në lidhje me themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës sh. a. /NKEC,
27. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë nënshkrues, në lidhje me të drejtat e pensionistëve kontributëdhënës,
28. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, në lidhje me mosekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. KI 08/09, datë 17 dhjetor 2010, vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-799, datë 19 mars 2014, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 08/186, datë 29 prill 2014, i hyrë në fuqi më 12 maj 2014 dhe të dy (2) udhëzimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr. C-V-14-4099 dhe nr. C-V-14-4332, datë 13 qershor 2014,
29. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Korab Sejdiu, lidhur me nevojën urgjente për vendosje të sanksioneve ekonomike (përfshirë embargon) dhe sanksioneve politike kundër Serbisë, si masë reciprociteti,
30. Raporti i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Razmatranje Nacrt zakona o ratifikaciji Međunarodnog Sporazuma između Ministarstva Obrazovanja, Nauke i Tehnologije Republike Kosovo (MONT) i Stitching Spark iz Holandije (SPARK) o pružanju podrške Međunarodnom Poslovnom Koledžu u Mitrovici,
5. Razmatranje N/zakona o ratifikaciji Sporazuma o kreditu između Republike Kosova i UniCredit Bank Austria AG za Projekat sistema za uklanjanje otpadnih voda za Opštinu Podujevo,
6. Razmatranje N/zakona o ratifikaciji za Dodatni Protokol 5 uz Sporazum o izmjeni i pristupanju Centralno Evropskom Sporazumu o slobodnoj trgovini,
7. Razmatranje N/zakona o ratifikaciji Sporazuma o zajedničkom finansiranju stipendija nivo master studija između Ambasade Francuske u Prištini i Ministarstva Obrazovanja, Nauke i Tehnologije,
8. Razmatranje Nact zakona o ratifikaciji Sporazuma između Republike Kosova i Raiffeisen Bank International AG za projekat izgradnje sistema nabavke pijaćom vodom Opštinu Uroševac,
9. Razmatranje Nacrt zakona o ratifikaciji kreditnog sporazuma između Republike Kosovo i UniCredit Bank Austria AG o finansiranju projekta za izgradnju sistema kanalizacije za Opštinu Štimlje,
10. Razmatranje Nacrt zakona o ratifikaciji Sporazuma o kreditu između Republike Kosovo i Unicredit Bank Austria AG u ulozi zajmodavac u vezi za finansiranjem projekta izgradnje sistema vodosnabdevanja za Opštinu Gračanica,
11. Razmatranje Nacrt zakona o ratifikaciji kreditnog sporazuma između Republike Kosova i UniCredit Bank Austria AG o finansiranju projekta za izgradnju vodovodnog sistema za Opštinu Istog,
12. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi neuspeha i skandala spoljne politike Republike Kosovo,
13. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi angažovanja Predsednika Kosova u uključivanju “razmene teritorija” ili “korigovanja granica” u dijalogu između Kosova i Srbije,
14. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi sa neuspesima vladajuće koalicije koji su kulminirali zbog ne liberalizacije viza,
15. Glasanje u načelu Nacrta zakona o javnom prenosniku Kosova,
16. Glasanje u načelu Nacrta zakona za izmene i dopune zakona br.02/L-88 o kulturno nasleđe,
17. Glasanje u načelu Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br.03/L-064 o službenim praznicima u Republici Kosovo,
18. Glasanje u načelu Nacrta zakona o peticijama,
19. Glasanje u načelu Nacrta zakona za zaštiti od buke,

20. Glasanje u načelu Nacrta zakona o izmenama i dopunama zakona br.05/L-010 o Kosovskoj Agenciji za upoređivanje i verifikaciju imovine,
21. Prvo razmatranje N/zakona o porezu na dodatu vrednost,
22. Prvo razmatranje N/zakona o visokom obrazovanju Republike Kosova,
23. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama Zakona br.03/L-174 o finansiranju političkih subjekata, izmenj Zakonom br. 04/L-058, Zakonom br. 04/L-122 i Zakonom br. 03/L-073 o opštim izborima u Republici Kosovo, izmenj Zakonom br. 03/L-256,
24. Prvo razmatranje N/zakona o lustraciji figura visokih službenika u Javnim Institucijama i izabranih,
25. Interpelacija Ministra za rad i socijalna pitanja Skender Reçica, na zahtev poslanika Faton Topalli, podržan od 11 poslanika PG PSD, u vezi smrti i povreda radnika na radnim mestima,
26. Interpelacija ministra za ekonomski razvoj g. Valdrin Lluka, na zahtev predsednika PG- PSD g. Dardan Sejdiu, uz podršku 11 poslanika, u vezi osnivanja Novog energetskog preduzeća Kosova a. d. /NKEC,
27. Parlamentarna debata, na zahtev poslanice Teuta Haxhiu, podržan od 9. (devet) poslanika–potpisnika za održavanje parlamentarne rasprave o pravima penzionera platiša doprinosa,
28. Parlamentarna debata, na zahtev poslanika Faton Topalli o neizvršenju Presude Ustavnog suda Republike Kosovo, br. KI 08/09, od 17. decembra 2010. godine, Odluke Skupštine Republike Kosovo , br. 04-V-799, od 19. marta 2014. godine, Odluke Vlade Republike Kosovo, br. 08/186, od 29. aprila 2014. godine koji je stupio na snagu 12. marta 2014 i dva (2) uputstva Posebnog veća Vrhovnog suda Republike Kosovo br. C-V-14-4099 i br. C-V-14-4332, od 13. juna 2014. godine,
29. Parlamentarna debata, na zahtev poslanika Korab Sejdiu o hitnoj potrebi uspostavljanja ekonomskih sankcija (uključujući embargo) i političkih sankcija protiv Srbije, kao mera reciprociteta,
30. Izveštaj Parlamentarne istražne komisije u vezi sa troškovima za lobiranje od strane Predsednika i Vlade Republike Kosova.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Sesionit pranveror të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 18 janar 2019.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se diskutime për pikat e rendit të ditës 12 deri 20 kanë përfunduar në seancat e mëparshme, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

1. Koha për deklaratime jashtë rendit të ditës

Koha për deklaratime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Flora Brovina, në emër të grupit, të lutem! Të bëhet gati Albin Kurti.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje,

Përshëndetje kolege dhe kolegë,

E mora fjalën për ta ngritur një çështje, një shqetësim që po më shtohet për ditë, edhe pse po flas në emrin tim personal, unë megjithatë e prezantoj edhe Partinë Demokratike.

Për një dukuri që ka filluar të shfaqet me të madhe bëhet fjalë për gjuhën politike që po përdoret në Kuvendin e Kosovës.

Jo vetëm nga mediat dhe nga Facebook-u, por kjo “gjuhë politike” e papërshtatshme po hyn çdo ditë dhe gjithnjë e më rëndë, është e paargumentuar, e pabazuar dhe po fyejnë rëndë njëri-tjetrin.

Me lehtësi të madhe, edhe të pashoqe, ne po e akuzojmë dhe po e kritikojmë njëri-tjetrin si tradhtar dhe kriminel, vetëm e vetëm se e kemi rival dhe kundërshtar politik. Mendoj se duhet pasur shumë guxim kur flasim për këto çështje, sidomos kur përmendim dhe e konsiderojmë veten ekspert të gjenetikës dhe përmendim ADN-në e tradhtarit si intelektual ose intelektuale, “ekspert” pa analizuar se peshën e kësaj fjale dhe pa analizuar se dikush tjetër mund ta kthejë me të njëjtën mënyrë. Fatkeqësisht kësi shembujsh kemi shumë.

Si përfaqësuese e qytetarëve të Kosovës në këtë Kuvend, si prind dhe si aktiviste e hershme në fushën e politikës, por edhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut kërkoj një komunikim më njerëzor, një komunikim më intelektual dhe ju ftoj që të ndryshojmë fjalorin.

Është kundër traditës sonë një fjalor i tillë, ne e dimë se pesha e fjalës është më e rëndë se sa pesha e një të rëne, është kundër parimeve themelore demokratike, të cilat aprovojnë tolerancën dhe pluralizmin e shprehjes së mendimeve dhe, natyrisht tolerancën e gjuhës dhe të argumentimit.

Është madje negative si shembull që u japim të rinjve tanë në ndërtimin e një shoqërie, e cila nesër do të jetë e tyre, por nëse këtë gjuhë e trasojmë tani, ajo do të përdoret edhe nga ta.

Mendoj se fjala është ajo e para, e cila i nxit të gjitha konfliktet, fjala është ajo e cila ndonjëherë peshon më shumë se sa diçka tjetër.

Ne po ndërtojmë një shoqëri ndryshe dhe e kuptojmë se shoqëria jonë, ajo që na dëgjon, e cila na ka zgjedhur, është shoqëri e traumatizuar nga lufta dhe në tranzicion, prandaj shumë e ndjeshme ndaj fjalës së deputetit në Kuvendin e Kosovës.

Unë do të shpreh edhe një mendim popullor, thotë: “Mos e nguc se e prek plagën”, ose një mendim tjetër; “Kallajit i del ngjyra” dhe nëse ne e prekim shumë kallajin, i del ngjyra dhe tjetri mund ta kthejë ndryshe, do të kërkojë edhe ADN-në tënde në qoftë se ti e akuzon dikë dhe nuk do të jetë mirë.

Prandaj, ju thërras për një gjuhë tjetër politike, për një gjuhë të tolerancës, kundër urrejtjes. Ne nuk jemi armiq ndaj njëri-tjetrit, ne jemi rivalë politike dhe si të tillë të sillemi në shoqëri.

Mosdurimi ndaj njëri-tjetrit shpreh mosdurimin që kemi brenda vetvetes, sepse është e vërtetë që në këtë moment ne të gjithë gati kemi zgjedhje në kuadër të partive tona politike dhe të mos e shprehim këtë rivalitet që kemi brenda subjektit tonë, të mos e shprehim këtu në Kuvend duke i ofenduar kolegët tanë rivalë dhe duke dëshmuar se...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Albin Kurti e ka fjalën. Të bëhen gati Faton Topalli e Islam Pacolli, pastaj pa grup.

ALBIN KURTI: Të nderuar qytetarë të Republikës,
Deputetë të Kuvendit,
Kabinet i Qeverisë,

Në vitin që shkoi është rritur papunësia e përgjithshme, është rritur papunësia te të rinjtë, vetëm papunësia te gratë ka mbetur njësoj, sepse është aq e lartë saqë s'rritet dot më: vetëm një në tetë gra ka vend pune. Sot lajm po bëjnë punëtorët që nuk janë në grevë, e jo ata që janë në grevë. Paga e Presidentit është 17 herë më e lartë se paga minimale e përcaktuar me ligj, ndërsa pagat e shoferëve të administratës së lartë janë me koeficient më të lartë se të drejtorëve të shkollave. Është rritur edhe korrupsioni, teksa rendet e njerëzve për viza para ambasadave po shtohen, kurse korrigjimi i demarkacionit Meha, me të cilën u mashtruan deputetët, nuk është askund.

Sikur këto të mos mjaftonin, një rrezik tjetër po na dominon: ndarja e Kosovës që emërohet herë si 'shkëmbim territorial' e herë si 'korrigjim i kufirit'. Në vitin e kaluar, Presidenti i Kosovës paralajmëroi 'kompromis të dhimbshëm', ndërkaq këtë vit e filloi duke shprehur gatishmëri dhe vullnet për kompromiset e nevojshme me Serbinë, në marrëveshjen e cila na qenka afër.

Presidenti Thaçi ose bën bluf me idenë e zgjidhjes finale dhe pajtimit historik me Serbinë, ose tashmë ka marrëveshje të fshehtë me Serbinë. Shpjegim tjetër nuk ka. Por, edhe dilema nuk ka, sepse në secilin rast ky President është delegjitimuar dhe diskredituar. Ajo çfarë kemi sot nuk është dialog, por pazar. Sepse nuk është dialog me Serbinë, ku Kosova do të ishte subjekt, por veçse pazar me Serbinë, ku Kosova është bërë objekt.

Pasi që Rusia dështoi me puçet e saj në Mal të Zi dhe Maqedoni, pse do të duhej që ajo të ketë sukses në Kosovë!? Presidenti Thaçi e thekson ulësen në OKB pikërisht që të na e sjellë Rusinë në lojë, sepse ajo është në Këshillin e Sigurimit. Shteti i Kosovës ka bërë ndryshim të madh në politikën e jashtme, duke zëvendësuar Gjermaninë, por edhe Britaninë e Madhe, me Rusinë. Prapa këtij riorientimi është besimi se Evropa ka vdekur, se Bashkimi Evropian ka mbaruar dhe se ne duhet ta braktisim atë. Ne mund ta ndryshojmë gjendjen tonë me punë e drejtësi dhe të bëhemi anëtar të BE-së një ditë, por ne nuk mund ta ndryshojmë as për shekuj faktin se jemi e do të mbetemi në kontinentin evropian. Ne nuk e kemi filluar Bashkimin Evropian dhe ne nuk mund ta përfundojmë atë, ne nuk duhet ta dëshirojmë këtë.

Se çka do Serbia e dimë mirë. Jo vetëm nga përvoja jonë e hidhur, por edhe nga aspiratat e shprehura të saj. Pas 'razgraniçenjes', siç e quajnë ata, me shqiptarët duke e ndarë Kosovën, Serbia do edhe 'razgraniçenje' me kroatët për ta ndarë Bosnjën. Ky është skenar për luftë, e jo dëshirë për paqe.

Në vend të reciprocitetit të plotë politik, ekonomik dhe tregtar me Serbinë, ashtu siç e kemi votuar në këtë Kuvend më 7 dhjetor 2011, tash kemi tarifën 100% për mallrat e Serbisë. Ne kemi qëndrim të kundërt si Lëvizje Vetëvendosje me Presidentin dhe kryeparlamentarin. Ata duan që të hiqet tarifa 100% me Serbinë dhe të mbetet Haradinaj kryeministër, ne kërkojmë të kundërtën: të largohet kjo qeveri dhe Haradinaj, e të mbetet kjo tarifë. Skandalet e panumërta të keqkqeverisjes dhe korrupsionit nuk mbulohen me një tarifë. Mbi të gjitha, nuk ka kuptim dialogu

i ri me Serbinë përderisa për çdo ditë kemi ftesa të reja nga Gjykata Speciale për luftëtarët e UÇK-së. Nuk ka kuptim dialogu i ri, përderisa ky Kuvend yni ndodhet në Gjykatën Kushtetuese, tek e cila Presidenti ka pyetur se a mund të na anashkalojë neve deputetëve kur ai nënshkruan marrëveshje ndërkombëtare. Edhe gjykata, edhe negociata, nuk shkon. Edhe UÇK-në edhe Kuvendin i kemi në gjykatë dhe, na thonë, ejani të bëjmë shpejt e shpejt marrëveshje finale e gjithëpërfshirëse e pajtim historik me Serbinë, pikërisht në këtë pranverë, kur ne do të shënojmë përvjetorin e 20-të të nja 300 masakrave të Serbisë anembanë komunave të Kosovës. Sivjet, midis 24 marsit dhe 12 qershorit për çdo ditë do të përkujtojmë nga tri a katër masakra të vitit 1999, të cilat i mbushin dy dekada. Prandaj, ndaluni! Nuk guxojmë të gabojmë. Duhet të nxjerrim mësim, që të mos përsërisim gabime nga dialogu 2011-2017. Nuk bën që për ato gjashtë vjet të mos diskutojmë as gjashtë orë në këtë Kuvend. Pra, le ta shqyrtojmë raportin 41-faqësh të qeverisë për të arriturat dhe sfidat e marrëveshjeve të Brukselit. Kemi hyrë në javën e 30-të, jo të tretë, por të 30-të, edhe ai nuk po vjen këtu. Pastaj, kërkesat tona ndaj Serbisë: njohja, reciprociteti, reparacioni, suksesioni etj., dhe vetëm më pas platforma me parime dhe ekipi negociator legjitim.

Protesta e 29 shtatorit ishte masive e madhështore, por ajo do të jetë e vogël krahasuar me protestat e ardhshme nëse nuk ndalet ky president...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Faton Topalli e ka fjalën në emër të PSD-së.

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë,

Të nderuara deputete,

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Më lejoni që në fillim të përgëzoj zonjën Flora Brovina për vlerat që proklamoi në këtë vend dhe e pashë që shumica nuk e dëgjuam se çfarë tha, sepse kush është konstruktiv në vendin tonë, nuk është interesat. Sot është koha e mashtruesve dhe e maskarenjve që flasin shumë e bëjnë pak.

Sot dua të flas për pagën minimale në Kosovë, kjo temë është e domosdoshme për të diskutuar, sidomos duke pasur parasysh faktin që përkundër rritjes së shpenzimeve të jetës, filluar prej bukës, energjisë, prodhimeve bujqësore, qirasë, shpenzimeve shëndetësore, paga minimale në Kosovë nuk ka ndryshuar prej vitit 2011, e që do të thotë 130 euro për të punësuarit deri në moshën 35-vjeçare dhe 170 euro për të punësuar deri në moshën 64-vjeçare.

Mjerisht, deri në vitin 2011 dialogu social është zhvilluar në baza ad hoc, as nuk ka pasur organizim strukturor, e as iniciativa të rregullta institucionale për zhvillimin e dialogut.

Në vitin 2011 është miratuar Ligji për Këshillin Ekonomik Social.

Sipas këtij ligji, kompetencat e tij shtrihen nga udhëheqja e konsultimeve, e deri te propozimet pranë institucioneve përkatëse.

Sipas ligjit, njëra ndër kompetencat e Këshillit Ekonomik Social është propozimi i pagës minimale, propozim i cili duhet të bëhet në çdo fund të vitit. Qeveria pas këtij propozimi obligohet të përcaktojë lartësinë e pagës minimale.

Sipas Ligjit të punës, konkretisht nenit 77, Qeveria e Kosovës në fund të çdo viti kalendarik përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomik Social dhe atë duke i marrë parasysh këta faktorë: koston e shpenzimeve jetësore, përqindjen e shkallës së papunësisë, gjendjen e përgjithshme në tregun e punës dhe shkallën e konkurrencës dhe produktivitetit në vend.

Deri më sot janë bërë 9 vjet që kur është caktuar paga minimale nga Qeveria e Kosovës, edhe pse ajo do të duhej të vendoste në çdo fund të vitit për pagën minimale.

Jemi dëshmitarë që kjo nuk ka ndodhur asnjëherë. Pra, as nuk janë bërë propozime nga Këshilli Ekonomik Social, së paku kjo nuk na është e njohur, e nuk ka pasur ndonjë vendim Qeveria për përcaktimin e pagës minimale. Sipas informacioneve të paverifikuara, në vitin 2013, në njërin nga mbledhjet e Këshillit Ekonomik Social, është diskutuar që paga minimale të jetë 220 euro dhe mosha të hiqet si kusht, por që asnjëherë nuk është bërë e ditur a ka shkuar ky propozim në Qeveri, apo jo? Ajo që dihet është se asnjëra prej qeverive të deritashme, po flas për 9 vjetët e fundit, nuk e ka trajtuar dhe nuk ka sjellë ndonjë vendim të ri për pagën minimale.

Si duket, për qeverinë ka qenë problem i madh të marrë vendim për pagën minimale, sepse rritja e shumës do të afektonte buxhetin e shtetit, sepse me Ligjin e vjetër të veteranëve lartësia e shumës së pensioneve nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë. Por, me Ligjin që është miratuar në vitin 2014 ky nen është fshirë dhe nuk ka asnjë pengesë për të vendosur pagën minimale. Si duket në dhjetor të vitit 2017 KES-i i ka dërguar Qeverisë propozimin për caktimin e pagës minimale, e që edhe Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka dërguar propozimin në Qeveri, por që sërish nuk kemi asnjë informacion se çka ka ndodhur më pas. Tani jemi në vitin 2019, pra paga minimale vazhdon të mbetet e njëjtë për 9 vjet me radhë. Mendoj që Qeveria e Kosovës duhet të sjellë një vendim të ri për pagën minimale. Nuk është e drejtë që çdo punëtor në sektorin privat të mbajë dy qytetarë që marrin të ardhura nga sektori publik, ndërsa rrogat minimale të jenë 130, respektivisht 170 euro. Unë pres nga Qeveria e Kosovës që të sjellë sa më shpejt që është e mundur një vendim, i cili nuk është nën minimumin e koeficientit, që sipas Ligjit për paga është 239 euro. Shpresoj që Qeveria do të ketë parasysh ato mijëra gra e burra që punojnë në pastrim, në pompa të benzinës e në vendet e

paguara pak që mezi arrijnë t'i paguajnë borxhet, e këtu nuk mund të flitet as për mbijetesë, sepse ata vazhdojnë të jetojnë gjithmonë me borxhe. Faleminderit!

KRYETARI: Islam Pacolli, s'është, Valentina Bunjaku-Rexhepi e ka fjalën.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Besoj shumë se kemi shumëçka të diskutojmë rreth grevës në arsim. Greva e mësimdhënësve ka bregosur të gjithë prindërit e nxënësit në Kosovë. Është paralizuar krejtësisht arsimi parauniversitar, si kurrë më parë në vendin tonë.

Greva do të ketë pasoja të mëdha në procesin mësimor, nxënësit dhe mbarë shoqërinë. Pasojat më të mëdha janë për nxënësit në klasën e parë dhe të dytë, ku mësojnë alfabetin, matematikën elementare, ku mësojnë A,B,C-në e jetës. Për shumë shkronja nxënësit e klasës së parë kanë mbetur mbrapa. Efektet negative të demotivimit për nxënësit do të jenë afatgjate dhe askush nga ne nuk do të ketë të drejtë t'i dëmtojë fëmijët tanë dhe të askujt tjetër, por me gjithë pasojat, nuk është as e drejtë, as e arsyeshme dhe as e vërtetë se për këto pasoja janë përgjegjës mësimdhënësit dhe SBASHK-u. Këto janë akuza të pabaza, është vetëm një adresë e fajësisë dhe e përgjegjësisë direkte për këto pasoja dhe për këto greva: është Qeveria aktuale, e cila rriti pagën vetes dhe irritoi të gjithë mësimdhënësit dhe shumë shtresa të shoqërisë tonë.

Kjo rritje e dyshimtë e pagesës për veten dhe Kabinetin e tij pezmatoi, irritoi dhe e zemëroi të gjitha kategoritë e tjera të shoqërisë për të shtuar kërkesat me të drejtë për rritjen e pagave. Vendimi i Qeverisë ka krijuar reaksion zinxhiror të pakënaqësisë qytetare, por edhe të mësimdhënësve, shërbyesve civilë, mjekëve, infermierëve e tjerë. Mësimdhënësit kanë shumë të drejtë për grevën e tyre, edhe mësimdhënësit e kanë konfirmuar për të satën herë se nuk është fjala vetëm për pagën e tyre, sa e kanë më tepër për degradimin qeveritar që po bëhet ndaj tyre. Është e turpshme të degradohen mësimdhënësit në këtë mënyrë dhe të vendosen në nivelin më të ulët pagash me rojat dhe shoferët e politikanëve. Është e turpshme të degradohen edhe para syve të nxënësve, duke përçarur mesazhin se sa pak vlen profesioni i mësimdhënësit me këtë koeficient të pavlerë. Po ashtu, me deklaratat e pamatura të Qeverisë po krijohet qëndrim negativ i prindërve dhe nxënësve ndaj mësimdhënësve, duke prishur dhe dëmtuar rëndë bashkëpunimin e ardhshëm dhe trekëndëshin nxënës-mësimdhënës-prindër i cili bashkëpunim është më se i domosdoshëm.

Ne po rrezikojmë dhe po futemi në një krizë të përgjithshme shoqërore me menaxhim joserioz të buxhetit të Kosovës. Kjo Qeveri ka nxitur tash në protesta të drejtat edhe të shërbyesve civilë dhe po futet në krizë edhe Administrata Publike dhe, në fakt, krejt shteti.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të grupit, në qoftë se ke, edhe 2 minuta, të lutem, regjia!

VALENTINA BUNJAKU- REXHEPI: Në fund, ne kërkojmë që Qeveria të bjerë me këto vlime të drejta të kategorive të ndryshme shoqërore, ose të merren shpejt masat, të bie menjëherë koeficienti i pagës për kryeministrin dhe Kabinetin qeveritar, e të ngrihet koeficienti i pagave për kategoritë më të rëndësishme të shoqërisë: mjekët, mësimmshënësit, shërbyesve civilë, infermierët e tjerë. Le të dalim nga paralizimi i institucioneve më të rëndësishme të vendit, sikurse ato arsimore, administrative dhe shëndetësore. LDK-ja ka mbajtur gjallë arsimin shqip në vitet e '90-ta në shtëpi dhe asnjëherë nuk ka pasur greva dhe bojkot institucional. Faleminderit!

KRYETARI: Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Po e tërheq fjalën, s'po ia prishi Valentinës, se e pati një fjalim historik, po s'dinte ta lexonte, s'di kush ia ka shkruar.

KRYETARI: Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Kam hezituar të flas a të mos flas në këtë seancë, por jam detyruar të flas për shkak të disa deputetëve paraprakë, të cilët në mënyrë absolute, lakuriq, po e demonstrojnë interesin e tyre, jo politik, jo partiak, por interesin e tyre personal, në kohën kur Kosova kurrë nuk ka qenë në krizë më të madhe, për shkakun e të gjitha partive politike të Kosovës, për shkakun e të gjithë neve, edhe si deputetë të këtij vendi që nuk kemi aprovuar ligje, nuk e kemi përmbushur arsyetimin pse jemi deputetë të Parlamentit të Kosovës, e mora fjalën duke u bërë thirrje të gjithë mësuesve, të gjithë punëtorëve të arsimit që të kthehen në vendet e tyre të punës dhe të mos dëgjojnë deputetë demagogë që rrejnjë publikisht, që manipulojnë publikisht, që i hedhin benzinë zjarrit të Kosovës vetëm për do vota të mjera dhe këtë e bëjnë ata deputetë, të cilët në jetën e tyre kurrë nuk kanë pasur as nuk do të kenë perspektivë.

Ne, të gjitha partitë politike që jemi në Kuvend, jemi marrë vesh për zbritjen e rrogës së pari të Presidentit, e dyta të kryeministrit, e treta të kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veselit, dhe ua kemi zbritur rrogat të gjithë deputetëve dhe krejt shtresat e ulëta janë me rritje të rrogave. Në mënyrë absolute nuk më intereson a do të rrijë edhe një javë, një muaj, një vit Qeveria e Ramush Haradinajt ose nuk do të rrijë. Mua më intereson që, edhe në rast se shkon kjo qeveri, të mos shkojë me rrena, të mos shkojë me akuza false, sepse po ua jap besën e Zotit që po të ketë njeriu vetëm 2 gramë karakter në trurin e vet, sot, në situatën aktuale, cilës parti politike t'i kishe thënë a po e merr pushtetin, do ta refuzonte! Cila parti do të kishte guximin sot ta marrë pushtetin në Kosovë? Prandaj, edhe një herë thirrje publike të gjithë punëtorëve të arsimit, në emrin e nënave, në emrin e fëmijëve tanë që janë traumatizuar, jeni duke bërë greva

politike, jeni duke bërë grevë pa arsye, sepse rrogat i keni të rritura me Ligjin e ri të pagave, ndërsa rrogat janë zbritur për Presidentin, për deputetët, për kryetarin e Parlamentit dhe kryeministrin. Kaq desha, zoti kryetar, faleminderit!

KRYETARI: Kjo e fundit, Milaim, për deputetët, janë rritur pak, po flisni veç për të tjerët e po e harroni veten. Dauti u largua prej fjalës, nga AAK-ja, Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Shumë çështje me të cilat ishte dashur të mendohet që edhe rritjen e pagave në Kuvend e keni bërë ju si kryetar kohë pas kohe, ju apo ish-kryetari me vendime të Kuvendit dhe është mirë nganjëherë të dihet sa është paga e kryetarëve të komisioneve dhe a e tejkalon pagën e kryeministrit, pa arsyetuar asgjë më shumë. Është mirë të jenë publike dhe të shihen që ato kanë qenë vendime pikërisht të Kuvendit, janë marrë në Kuvend, për t'u rritur kohë pas kohe, janë fakte.

Cilado pagë që të flasim, për qytetarët po flas, për mësimdhënësin është më e pakta që mund të themi, se ka rritje rreth 20% të pagave të mësimdhënësve nga arsimi parafillor e deri në arsimin e mesëm, e tha mbrëmë për të gjithë qytetarët ministri i Financave shumë konkretisht, që është përgjegjësi kryesor i kuletës së shtetit. Pra, për jo rreth 2 vjet, më pak se dy vjet, Qeveria Haradinaj ka rritur pagat e mësimdhënësve nga arsimi parauniversitar dhe në arsimin e mesëm, pra, me përqindje që e tregoi mbrëmë ministri, por si të doni, po jua përmend këtu. 513.9 euro paga e arsimit parashkollor për të gjithë mësimdhënësit në arsimin parashkollor, paga e tyre që është rritur është për 513.9 euro. Në shkollat fillore, nga klasa e parë deri në klasën e 9-të, pra paga e një mësimdhënësi shkon mbi 530 euro. Nga ajo që u tha prej ministrit të Financave, se është personi që unë i besoj më së shumti, se ishte shumë konkret për ata që duan ta kuptojnë, me një rritje rreth 20% të një Qeverie që ka kaluar vetëm 1 vit, me një injorancë të skajshme që bëri Qeveria Mustafa për mësimdhënësit duke ua rritur 7 apo 8 euro për një mandat, sa e kishte, aq sa e kishte, 7 apo 8 euro në kuletën e mësimdhënësit janë rritur pagat nga Qeveria e fjetur Mustafa.

Pra, le të deklarojnë të kundërtën, në qoftë se ka pasur, injorimi i skajshëm që iu ka bërë SBASHK-ut, që janë pikërisht shumica e tyre sot nga Qeveria Mustafa, që i ka injorua skajshmërisht...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në qoftë se është në emër të grupit, edhe 2 minuta. Po, po demokraci, zonja deputetes.

TEUTA HAXHIU: SBASHK-u e ka pasur derën e hapur në Qeveri sa herë ka dashur, për çka do, sepse në fund të fundit Qeveria nuk është e një individi, nuk është i një subjekti politik, por

është Qeveri e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës me një transparencë. SBASHK-u ka pasur një bashkëpunim me Komisionin Parlamentar, të mos them të çdoditshëm pothuajse, për çfarëdo çështje dhe të gjitha kërkesat e tyre janë marrë parasysh dhe kemi bashkëpunuar deri në momentet e fundit që unë po dua të besoj që nuk janë të ndikuar politikisht. Kemi Ligjin për punëtorët e viteve të '90-ta, e dimë se si nëpër cilat faza ka kaluar, e solli Qeveria Haradinaj, pesë vjet pritëm, nuk kishte guxim Qeveria Mustafa as ta sjellë deri në Kuvend, e lëre më të punohet në të!

Pra, për një injorancë që iu ka bërë mësimdhënësit në kohën e Qeverisë Mustafa, të gjithë mësimdhënësit e dinë, për rritjen e pagave, sado që nuk janë të mjaftueshme, por duhet bashkarish të punojmë, krahas rritjes, të marrin edhe përgjegjësitë, edhe privilegjet, jemi në përkrahje të mësimdhënësve, sepse kurrkush më mirë se ata që kanë punuar dhe kanë qenë kolegët e tyre nuk e dinë, por ta dinë pra për të gjithë ata që punojnë dy e më shumë vende pune që t'i lirojnë dhe të deklarohen që nuk janë për paga që janë mbi tre mijë euro. Pra, ose këtu le të deklarohen edhe kryetarët e komisioneve që kanë pagën më të madhe se të Kryeministrit, se janë kundër saj. Asnjëherë s'është deklaruar, unë s'e kam dëgjuar këtu në Kuvend. Le të deklarohen kryetarët e komisioneve të cilët e kanë pagën më të madhe se të kryeministrit të vendit, që është një, Kryeministri i vendit është një person, pa marrë parasysh kush është ai, është hierarki, kurse ta ketë pagën...

KRYETARI: Andin Hoti, urdhëro!

ANDIN HOTI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë faktikisht e pata veç një kërkesë, mirëpo kam nisur nuk po mund ta duroj hipokrizinë më edhe demagogjinë këtu.

KRYETARI: S'po dëgjohesh deputet, s'po dëgjohesh...

ANDIN HOTI: Çka t'i bëj? A po dëgjohem tani?

Unë e kisha një kërkesë për kryeministrin, mirëpo tash u bën dy për shkak se parafolësit e mi e përmendën pagat e 122 individëve në Kosovë që mendoj se janë duke bërë moral politik me këto 122 pozita. Unë jam mësuar dhe besoj që duhet të jenë të gjithë njëjtë, që para se të bëjmë akuza të kota të gjejmë zgjidhje. Cila është zgjidhja që e keni dhënë, unë ende nuk e dëgjova. Unë e përgëzoj kryetarin e Kuvendin për zgjidhjen e tij që ka dhënë, që ta ulë pagën e tij nga koeficienti 11, në 9. Prandaj, unë i bashkëngjitem atij propozimi dhe si deputet kërkoj që ju të më bashkëngjiteni mua dhe të propozoj uljen e koeficientit të deputetit nga 8 në 7. Edhe 5 sado që të jetë ajo. Nëse doni zgjidhje, kjo është zgjidhja, e para.

Dhe e dyta, për ata që kanë dyshim në qeverinë aktuale që do të gjeje zgjidhje në të ardhmen për grevistët dhe për pagat e tyre, veç ua rikujtoj një shembull konkret, një shembull timin familjar. Nëna ime me 2006 ka hyrë në punë, e ka pasur pagën 125 euro. Sot e ka 500 euro, 470 e diçka. Kjo është falë Partisë Demokratike të Kosovës, falë udhëheqjes së saj këto dhjetë vjetët e fundit. Kështu që të jeni të sigurt, nuk keni nevojë të bëheni merak, të jeni të sigurt që edhe kësaj here Qeveria aktuale, Partia Demokratike e Kosovës bashkë me koalicionin e saj do ta gjejë zgjidhjen.

Kërkesa e dytë është që gjatë kësaj kohe sa isha në pushim, kam qenë disa herë në Rahovec, në Therandë, Suharekë edhe Prizren dhe kjo është kërkesë për Kryeministrin, por meqenëse ai nuk është këtu, besoj që ia përcjellin dhe jam i bindur që edhe Kryeministri e ka vullnetin e tillë, por nuk është temë aktuale, bujqit atje janë në hall, sepse po kërkojnë që t'u jepen subvencionet që ju takojnë, të cilat ende nuk janë shpërndarë në përgjithësi. E dyta, vitin e kaluar, në maj dhe në qershor kanë ndodhur disa fatkeqësi natyrore, kanë ndodhur disa reshje të shumta në atë pjesë dhe Qeveria ka premtuar një kompensim të dëmeve të këtyre reshjeve dhe jam i sigurt që Komisioni i kaluar, komisioni që është formuar për këtë çështje i ka marrë të gjitha të dhënat e nevojshme, mirëpo ende nuk është kompensuar asnjë bujk për këto dëme që janë bërë atje. Dua t'ju rikujtoj Kryeministër dhe neve që bujqësia nuk pret, tash është koha kur ata do të fillojnë mbjelljen, tash është koha kur ata kanë nevojë më së shumti për ato subvencione dhe për këtë kompensim. Në qershor, në vjeshtë nuk iu nevojiten më ato para. E lus Kryeministrin që sa më shpejt të jetë e mundur dhe të kompensojë këto dëme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë, kemi filluar në 10:55, tani ora është 11:27.

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 35 pyetje parlamentare.

Fillojmë me pyetjet e bartura nga seancat e mëparshme: Nënkryetarja e Kuvendit, Aida Dërguti, pyetje për ministrin Ekrem Mustafa. Zonja nënkryetare, fjala për ju!

AIDA DËRGUTI: Po, faleminderit!

Zoti ministër, pyetja ime ka të bëjë për studentët që kanë qenë të regjistruar në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës në vitet 2011-2012 dhe vitin 2012-2013. Studentët e programit Gjuhë dhe Letërsi Shqipe-Bachelor, Gjuhë dhe Letërsi...

KRYETARI: Zonja deputete, më fal! Zonja nënkryetare, e kemi veç një problem, po e shoh reagimin e ministrit. Se po e shoh reagimin e ministrit, se është për Ekrem Mustafën pyetja, jo për ministrin e arsimit, pastaj mund të jetë më vonë. Ministri nuk është aktualisht këtu.

AIDA DËRGUTI: Po, zoti kryetar, unë po e lexoj megjithatë pyetje, që kjo pyetje po zvarritet që sa kohë e është shumë e rëndësishme që të marrë përgjigje.

KRYETARI: Veç urdhëro, se e pashë reagimin e ministrit të Arsimit.

AIDA DËRGUTI: Pyetja ime ka të bëjë me vonesën e heqjes së dënimeve nga sistemi për menaxhimin e gjobave të komunikacionit. Pra, sistemi për menaxhimin e gjobave të komunikacionit është duke u bërë problem i madh për qytetarët, për arsye se dënimet nuk pasqyrojnë realitetin. Të dhënat nuk përditësohen me të rejat e fundit, dhe njerëzit kanë probleme për shkak të vonesës së shlyerjes nga sistemi. Pres përgjigje nga ministri, së paku me shkrim.

KRYETARI: Vazhdo nënkryetare pyetjen tjetër, për ministrin Shyqiri Bytyqi.

AIDA DËRGUTI: Zoti ministër, pyetja ime ka të bëjë për studentët që kanë qenë të regjistruar në Fakultetin e Edukimit, në Universitetin e Prishtinës në vitet 2011-2012 dhe 2012-2013. Studentët e programeve Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Angleze, Fizikë-Kimi, Biologji-Kimi, Matematikë-Informatikë, Teknologji-Informatikë, Histori-Edukatë Qytetare, Gjeografi-Edukatë Qytetare, të gjitha të nivelit bachelor që nuk janë akredituar. Këto drejtime lëndore në Fakultetin e Edukimit janë rekomanduar nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës që të kalojnë nëpër fakultetet përkatëse, por që nuk ishte marrë asnjë veprim nga fakulteti përkatës. Fakulteti ka shpallur konkurs duke mos e përfill vendimin e agjencisë që këto programe nuk janë akredituar. Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në legjislaturën e katërt pat marrë një vendim me numër 061/01-B të datës 18 prill 2014 me titull 'Për njohjen e diplomave për studime dhe punësim', në të cilën, në pikën 1 të këtij vendimi thuhet: për të gjithë studentët e regjistruar në Fakultetin e Edukimit në universitete publike, në fushën e transformimit të programeve lëndore nga Fakulteti i Edukimit në departamente të tjera përkatëse për vitin akademik 2011-2012, 2012-2013 dhe pika 2: vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Megjithatë, sipas disa informacioneve, studentët të cilët e kanë përfunduar Fakultetin e Edukimit, drejtimi Matematikë-Informatikë, në vitin 2011 e tutje nuk po u vuloset diploma, sepse ky program nuk ka qenë i akredituar në atë kohë. Studentët të cilët janë regjistruar në këtë periudhë, nuk kanë qenë në dijeni që ky program nuk ka qenë i akredituar atë kohë. Pyetja ime për ju ministër është, përse nuk po zbatohet në tërësi për të gjitha programet, sipas vendimit të datës 18 prill 2014, përse këtyre studentëve të këtij drejtimi nuk po u vuloset diploma?

KRYETARI: Ju kisha lutur, zoti ministër merre fjalën të lutem. Po, të lutem! Në të njëjtën kohë, i kisha lutur, sot nuk e di po ka probleme me zërimin, afrojeni më afër, e pash me shumicën e deputetëve. Zërimin keni problem. Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

E nderuar deputete, faleminderit për pyetjen! Realisht kemi disa vendime të cilat janë marrë pa i ndjekur të gjitha procedurat të cilat nuk do të sillnin pastaj edhe pasojat, siç është edhe kjo pasojë që për studentët tanë tashmë e kanë pothuajse të pamundur verifikimin e diplomave. Ne dhe shumë probleme të akumuluar jemi duke i marrë gradualisht për t'i zgjidhur një për një. Këto drejtime të Fakultetit të Edukimit të cilat tashmë studentët i kanë përfunduar dhe kanë diplomuar nuk kanë qenë të akredituara pas marrjes së vendimit të ish-ministrit. Janë bërë disa përpjekje; ka pasur edhe Divizioni për Barasvlerë dhe Verifikim të Diplomave disa hapa që t'i verifikojë këto diploma, por të cilat kanë sjellë pasoja në aspektin ndërkombëtar të njohjes së këtyre diplomave, pasi që në Agjencia e Akreditimit, këto programe nuk figurojnë si të akredituara. Zgjidhja për të cilën ne jemi duke bërë përpjekje, është formimi i një Komisioni të përbashkët mes Agjencia e Akreditimit, rektorateve dhe Ministrisë që ta gjejnë një zgjidhje të përbashkët dhe që zgjidhje të pranohet nga të gjitha këto institucione.

Derisa Agjencia e Akreditimit nuk i validon këto programe, këto diploma mund të jenë vetëm përbrenda territorit të Kosovës, por nuk do të pranohen ndërkombëtarisht, sepse çdo institucion i huaj e shikon ueb-faqen e Agjencisë së Akreditimit dhe nëse programet nuk janë të akredituara, nuk quhen të validuara. Tashmë Departamenti i Arsimit të Lartë ka marrë hapat për formimin e këtij grupit dhe konsideroj që do të dalë me një rekomandim të qartë që të bëhet zgjidhja për këta studentë, sepse studentët nuk janë fajtorë për këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Po zonja nënkryetare, ka pyetje shtesë. Faleminderit, ministër!

AIDA DËRGUTI: Po, kam pyetje shtesë. Zoti ministër, a mund të na thoni publikisht pra se kur mund të pritët një zgjidhje konkrete, me afate përafërsisht të caktuara, sepse njerëzit presin përgjigje, madje ka disa që u janë vulosur diplomat dhe të tjerët janë të diskriminuar. Pra, a mund të na thoni saktësisht, ose përafërsisht kur mund të pritët një zgjidhje e kësaj çështjeje?

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: E nderuar deputete, e theksova që veç tash jemi në fazën e formimit të grupit me këto institucione të përbashkëta, dhe besoj që me një volum të mirë të punës, brenda tremujorëshit mund të zgjidhet si çështje. Megjithatë, nganjëherë po dalin çështje të papritura dhe po i shtyjnë afatet, por unë besoj që brenda tre muajve do të zgjidhet si çështje.

KRYETARI: Faleminderit! Tani radha është, deputetja Shqipe Pantina pyetje për ministrin Pal Lekaj. Urdhëroni, zonja deputete!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryetar!

Pyetja ime ka pasur të bëjë me rregullimin e çështjes së transportit publik për në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari”. Ministri Lekaj më ka telefonuar për të treguar se nuk do të jetë sot këtu, dhe më ka dhënë përgjigjen duke thënë se tashmë është nënshkruar një marrëveshje me Komunën e Prishtinës që kjo çështje do të zgjidhet, kështu që unë e falënderoj ministrin. Megjithatë, kërkesa ime vazhdon të mbetet që kjo marrëveshje të jetësohet sa më shpejtë, që qytetarët të mund të udhëtojnë me transport publik, pra mos të paguajnë çdoherë taksi për të shkuar nga dhe prej Aeroportit Ndërkombëtar ‘Adem Jashari’. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Driton Çausi, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

DRITON ÇAUSHI: Faleminderit!

Pyetja është shtruar më 30 tetor. Sidoqoftë vazhdon, ose është riaktualizuar me gjetjet e fundit të Agjencisë për Akreditim dhe reagimin e rektorëve të universiteteve publike, kryesisht këtyre të hapura pas luftës. Pas marrjes së mandatit tuaj, zoti ministër ju keni formuar një grup këshillëdhënës të caktuar pra nga ministria juaj për hartimin e një koncept-dokumenti për fizibilitetin e universiteteve publike në Kosovë. Ky grup ka përfunduar punën në prill të vitit 2018 me një dokument të cilin ju na e pat prezantuar në Komisionin për Arsim. Siç e dini, edhe ju edhe anëtarë të tjerë të Komisionit, të gjeturat e këtij dokumenti kanë qenë tepër shqetësuese. Problemet me të cilat ballafaqohet arsimi i lartë në Kosovë, e këtu fjala është për universitetet publike të hapura pas luftës, janë tepër serioze dhe nga natyrat më të ndryshme, nga mungesa e strategjisë së përgjithshme në punën e tyre, pra në arsimin e lartë, mungesa e harmonizimit të punës, vështirësitë menaxhuese, ngarkesa e madhe me studentë dhe me staf tepër të ulët.

Pyetja ime në lidhje me këtë pas një kohe kaq të gjatë, kanë kaluar diku nëntë muaj nga ky dokument, është se cilët kanë qenë ose cilët vazhdojnë të jenë hapat e juaj që do të ndërmerri, ose që keni ndërmarrë në lidhje me rekomandimet dhe të gjeturat e këtij grupi punues, e sidomos tash edhe nga konflikti për të gjeturat nga Agjencia e Akreditimit, nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë, reagimi i rektorëve. Por desha të them që ne kemi pasur përfaqësuesit e agjencisë dhe kanë qenë mjaft argumentues, po na intereson qëndrimi juaj në këtë situatë.

KRYETARI: Zoti ministër, fjala për ju!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit kryetar!

Të nderuar deputetë!

I nderuar deputet, faleminderit për pyetjen! Realisht ne e kemi pasur idenë që ta kemi një pasqyrë të saktë në institucionet publike pra të arsimit të lartë, dhe ky ka qenë qëllimi i formimit të këtij grupit punues që ka dalë me një raport, që konsideroj që është një raport mjaft i rëndësishëm dhe na jep shumë informacione.

Përveç që është dalë një raport që ka bërë një vlerësim të situatës së përgjithshme nëpër institucionet e arsimit të lartë, ka dalë me dy rekomandime të cilat janë rekomandime shumë të rëndësishme dhe konsideroj se një ndër rekomandimet më të rëndësishme është paraparë profilizimi i universiteteve. Çështja e profilizimit të universiteteve publike do t'i rregullonte dy çështje të rëndësishme: e para çështjen e kërkesës së tregut të punës, pra që është një mospërputhje aktualisht, programet të cilat i kemi nëpër institucione publike dhe kërkesave në tregun e punës dhe konsideroj që profilizimi do ta rregullonte mjaft mirë këtë çështje, dhe e dyta do t'i ndihmonte mjaft shumë të gjitha universiteteve publike, përjashtoj Universitetin e Prishtinës, që të zhvillohen, pasi që edhe mundësia për të thithur kuadro të mira pas profilizimit do të jetë shumë më i lehtë, dhe konsideroj që do ta eliminonte edhe këtë problematikën e cila na u shfaq ditëve të fundit.

Mirëpo, ajo çka mbetet tutje pas këtyre rekomandimeve që kanë dalë në raport nga ky grup i ekspertëve, i mbetet ose Qeveria e Kosovës ose Parlamenti i Kosovës të marrë vendim, sepse është çështje shumë më e lartë sesa direkt e Ministrisë së Arsimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, pyetje për ministrin Skender Reçica.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Këtë pyetje parlamentare e kam parashtruar në muajin e 11-të të vitit të kaluar. Për shkak të mungesës së ministrit pyetja po përsëritet prapë. Është çështja e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës.

E dimë që pas sa vitesh heshtje e stigmatizimi, Parlamenti i Kosovës në vitin 2014 e miratoi ligjin që u njeh statusin e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, dhe u jep mundësinë për të pasur një pension mujor. E dimë që plagët e tyre nuk do të shërohen asnjëherë.

Në fund të muajit prill, Qeveria themeloi Komisionin për Verifikim dhe Njohje të Statusit të viktimës së dhunës, duke kryer procedurat nënligjore që mundësojnë nisjen e procesit.

Si informatë, kohëve të fundit kemi të njohur që disa kërkesa të aplikantëve janë refuzuar. Ndërsa, gjithashtu kemi të njohur që të drejtën e shqyrtimit të atyre ankesave a ka prapë i njëjti komision.

Po ashtu kemi si informatë edhe shqyrtimin e aplikacioneve që po vonohen kur aplikantët kanë aplikuar në muajin mars dhe nuk janë shqyrtuar ende deri në këtë muaj për arsye se anëtarët e Komisionit për Verifikim kanë edhe obligime të tjera.

Pyetja i nderuar ministër është: A do të mund të bëhet një zgjidhje apo si do ta zgjidhni këtë situatë nëpër të cilën po kalojnë personat e përjetimit të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë?

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

E nderuar deputete Mjaku-Topalli,

Sa i përket procesit të njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, fillimisht dua t'ju informoj se Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, është i përbërë nga profesionistë të fushave përkatëse dhe me përvojë në fushën e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës seksuale, i cili zhvillon procedurën e verifikimit të statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare të Kosovës në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë këtë fushë si dhe në pajtim me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme, komisioni brenda kompetencave të tij shqyrton aplikacionet dhe dokumentet e nevojshme të cilat shërbejnë si prova lidhur me statusin e viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, dhe merr vendimin për njohjen apo refuzimin e statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës.

Në rastet kur prezenca e aplikuesit apo e aplikueses vlerësohet e domosdoshme për të bërë verifikimin dhe konstatimin në rasteve të dhunimit gjatë luftës çlirimtare, vet aplikuesi apo aplikuesja vendos për të qenë prezent fizikisht apo jo gjatë procesit të verifikimit, dhe ka të drejtë të shoqërohet në këto raste nga persona të cilët ajo apo ai i preferon.

Këta persona thirren për intervistë në raste kur dokumentacioni është i mangët dhe nuk kanë dokumente shtesë dhe në mënyrë që të mos refuzohet, komisioni iu mundëson të gjithëve që të dëgjohen para panelit të komisionit me qëllim të bindjes për nxjerrjen e vendimit.

Në zbatim të dispozitave përkatëse në fuqi dhe me qëllim që viktimës t'i sigurohet konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave si dhe mirëmbajtje dhe shfrytëzim të të dhënave personale të këtyre personave në pajtim me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Klasifikimin e Informatave dhe rregullave të sigurisë, dhe Ligjit për Mbrojtjen e të dhënave personale, është përcaktua që shqyrtimi i kërkesave të bëhet nga ana e komisionit si mjet për të rishikuar vendimet e tyre në rastet kur aplikuesi ka prova të reja ose mendon se i është bërë e padrejtë.

Në kuadër të kësaj dhe me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të ligjshëm, si dhe për shkak të kompleksitetit të çështjes, mund të jetë e nevojshme shtyrja e afatit fillestar në pajtim me dispozitat e ligjit për procedurën e përgjithshme administrative për aq kohë sa është e nevojshme për të përfunduar procedura. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë, zonja deputete?

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Atëherë, faleminderit ministër për përgjigjen e dhënë.

Ne e dimë që komisioni qeveritar brenda përgjegjësiave dhe kompetencave që ka, në pajtueshmëri me legjislacionin përkatës në fuqi është duke e kryer punën profesionale me seriozitet dhe përkushtim. Mirëpo, përkundër obligimeve që i ka direkt në punë, ata verifikimin apo shqyrtimin e këtyre kërkesave e bëjnë pas orarit të punës. Pas orës katër.

Kështu që si ministri, a keni menduar që ta nxirrni një rregullore që të lirohen nga puna, komisioni që është në punën bazë dy ditë brenda javës dhe gjatë ditë t'i shqyrtojë këto kërkesa apo aplikacione të qytetarëve? Jo pas orës katër, jo ditëve të vikendit. Çfarë mendoni, si do ta zgjidhni këtë situatë? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e keni fjalën për t'u përgjigjur.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, deputete!

Realisht, komisioni nuk punon vetëm pas orës katër. Komisioni i trajton kërkesat sipas radhës që aplikojnë kandidatët të cilët plotësojnë ato kriteret që kërkojnë që t'i nënshtrohen vlerësimit dhe analizimit nga ana e komisionit.

Për informacionin tuaj, deri më tani 911 aplikacione, 190 rasteve u është njohur statusi. Diku 119 rasteve u është refuzuar dhe pritet rivlerësimi në shkallën e dytë. Të tjerët janë në procedurë.

Nga ajo që ka pranuar deri më tani komisioni, shihet që realisht ata kanë punuar me përkushtim dhe përbërja e komisionit, ne e dimë të gjithë që përbëhet edhe nga zyrtarë të cilët mund të kenë edhe ndonjë detyrë tjetër në institucionet e Republikës së Kosovës, por është e përcaktuar sesi do të jetë ajo përbërje e komisionit.]

Në kuadër të kësaj, organizimin dhe angazhimin e tyre e bëjnë sipas agjendave individuale që i kanë në bashkëpunim me të gjithë ekipin që bën pjesë në komisionin qeveritar.

Unë mendoj, dhe inkurajoj që komisioni është duke punuar mirë në këtë drejtim. Nuk ka vonesa. Realisht procesi si i tillë ka filluar me vonesë. Ne jemi dëshmitarë që vetëm më 5 shkurt të viti të kaluar ka fillua që ky komision t'i pranojë aplikacionet e para, dhe unë mendoj që është një dinamikë e pranueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sali Zyba, pyetje për ministrin Fatmir Matoshi. A është zoti Zyba këtu? Fjalën zoti Zyba!

SALI ZYBA: Faleminderit! Edhe pse pyetjen e kam parashtruar muaj më parë, në mungesë të ministrit jam detyruar që ta përsëris tash, në fakt me bartë deri tash.

Çështja ka të bëjë me ndërtimet e shumta të objekteve që po ndodhin në afërsi të zonës turistike në Brezovicë.

Zoti ministër, a janë mbikëqyrur ose kontrolluar këto ndërtime? A janë të pajisura me leje ndërtimi dhe a i plotësojnë kriteret ligjore?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FATMIR MATOSHI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Zyba,

Në zonën turistike Brezovica, kompetent për dhënien e lejeve ndërtimore është Komuna e Shtërpçës, ngase konsiderohet vendbanim.

Sipas evidencave që i kemi ne në ministri, gjatë vitit 2018 nga Komuna e Shtërpçës janë lëshuar 29 leje ndërtimore. Përgjegjësinë për zbatimin e këtyre lejeve ndërtimore e ka Inspektorati komunal.

Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit, gjatë kontrolleve inspektuese në zonën turistike Brezovica, për të gjitha shkeljet ligjore të konstatuara në terren në procesverbal ka urdhëruar Drejtorinë e Inspektoratit të Shtërpçës që të marrë masa konform dispozitave ligjore për të gjitha tejkalimet e bëra sipas lejes ndërtimore si dhe degradimeve që janë bërë në lum dhe të tjera.

Pas riinspektimit, Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit ka konstatuar se Komuna e Shtërpçës, nëpërmjet Inspektoratit komunal nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në këtë drejtim për të cilën gjë komuna është dërgua në gjykatë me datën 10 dhjetor 2018.

Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit, gjatë inspektimit të fundit në Drejtorinë e Urbanizmit, ka konstatuar shkelje ligjore gjatë lëshimit të lejeve ndërtimore për çka ka lëshuar vendim me të cilin obligohet komuna për lëshim dhe harmonizimin e lejeve ndërtimore në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

Për shkeljet që janë bërë në institucionet e komunës, Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit ka ushtruar kallëzim penal ndaj komunës.

Sa u përket ndërtimeve në zonën e mbrojtur të Parkut Kombëtar Brezovica, ju njoftoj se të gjitha këto ndërtime janë në zonën e tretë, ku lejohen ndërtimet sipas lejeve përkatëse dhe inspektorati në këtë drejtim për shkeljet ligjore ka marrë masa ndaj komunës si u potencua më lartë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Zyba?

SALI ZYBA: Zoti ministër, nga përvoja e qeverisjeve të kaluara ka pasur ministra që kanë aktiv vet edhe kanë marrë masa konform me zonat e interesit nacional që kanë qenë, qoftë malet tjera, qoftë zona të tjera të interesit. Prandaj, edhe në komisionin që kemi pasur diskutime me juve prezent e keni hedhur fajin vetëm te komuna. Jam i vetëdijshëm për përgjegjësitë dhe mundësitë që i ka edhe ministria, prandaj është i dukshëm mohimi ose përjashtimin i vetvetes nga përgjegjësitë dhe kompetencat ligjore që i keni. Prandaj, nevojiten hapa të tjerë konkret.

Thatë se i keni bërë disa inicime për komunën, e sidomos kur thatë e kemi detyruar komunën që të marrë masa, Inspektoratin. Ja që inspektorati i ka këto obligime ligjore, por për mosmarrje të masave të komunave jeni kompetent ju.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, dëshironi përgjigje? Ministri e ka fjalën.

MINISTRI FATMIR MATOSHI: Faleminderit zoti deputet!

Po është e vërtetë, e potencova edhe më herët që komuna tashmë është dërguar në gjykatë. Komunës i është bërë me dije që gjatë lëshimit të lejeve ka bërë shkelje ligjore.

Ne po mundohemi që t'i plotësojmë të gjitha kushtet ligjore në mënyrë që edhe hapat që do t'i ndërmarrim më pastaj të jenë konform ligjeve në fuqi dhe që të mos kemi ndonjë veprim të përshpejtuar i cili mund të na kthejë në një situatë të mëhershme ose të na kthejë në pikën zero.

Sigurisht se do të ndërmarrim masa. Sigurisht se këto tejkalime të kompetencave të komunës po edhe këto lëshime gjatë dhënies së lejeve ndërtimore nuk do të kalojnë ashtu thjesht. Tashmë jemi në procedurë, kemi punuar shumë ditëve të fundit dhe do të vazhdojmë të punojmë edhe më tutje, dhe ju falënderojmë edhe juve për mbështetjen që na e jepni në këtë drejtim në mënyrë që të vendosim rregull në atë pjesë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Ganimete Musliu, nuk qenka këtu. Pyetje për ministrin Bytyqi. Zoti Topalli pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Zoti Topalli a dëshironi ta bëni pyetjen?

FATON TOPALLI: Faleminderit, jo! Kryeministri s'qenka këtu, kështu që e shtroj në seancën a ardhshme.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Andin Hoti, pyetje për ministrin Ekrem Mustafa.

ANDIN HOTI: Faleminderit, kryesues! Ministri nuk qenka këtu, mirëpo unë po e parashtroj pyetjen dhe besoj që riaktualizohet si temë pastaj. Pyetja ime ka qenë para dy muajve mirëpo po besoj që nuk ka problem edhe nëse parashtrohet sot.

Në muajin nëntor, unë së bashku me grupin e të rinjve të Parlamentit të Kosovës, bashkë me zotin Rekalu e kemi vizituar dhe e kemi pasur një takim në Prizren me mbi njëqind nxënës të shkollave të mesme për ta diskutuar problemin e përdorimit të drogës.

Nxënësit atje dhe nxënësit në përgjithësi në Kosovë janë shqetësuar jo vetëm me rritjen e numrit të përdoruesve të drogës dhe qasjen shumë të lehtë, madje edhe në drogat më të rënda, por edhe me faktin se në mesin e përdoruesve të drogës tani ka edhe nxënës të klasave të ulëta.

Këtë fakt e ka konfirmuar edhe raporti i Avokatit të Popullit, ku është theksuar se moshat mesatare e përdoruesve të drogës ka rënë nën moshën 16-vjeçare.

Po ua rikujtoj disa raporte të vitit të kaluar edhe të mediave, që vetëm në vitin 2017 janë 80 raste që kanë gjetur vdekjen si pasojë e drogës, ndërsa në vitin 2018 nuk kam parë ende raport të përfunduar, mirëpo e di që vetëm në një regjion, vetëm në rajonin e Gjilanit kanë gjetur vdekjen pesë persona si pasojë e drogës.

Prandaj, këto të dhëna janë alarmante dhe institucionet e shtetit duhet ta trajtojnë me shumë seriozitet këtë çështje.

Problemi i përdorimit të drogës nga të rinjtë është problem shumë kompleks dhe nuk kufizohet vetëm me parandalimin dhe luftimin e trafikimit të drogës, por edhe me rehabilitimin e të rinjve që tashmë kanë rënë në grackën e drogës.

Sot, këta të rinj kanë vetëm një adresë në institucionet e shtetit e që është Klinika e Psikiatrisë në QKUK, përkatësisht reparti i sëmundjeve të varësisë ku shërimi dhe trajtimi i tyre duhet të zhvendoset në një departament të veçantë të dedikuar vetëm për fëmijë dhe adoleshentë që janë përdorues, duke qenë i vetëdijshëm që adresimi i këtij problemi kërkon angazhim të shumë institucioneve nga sektorët, shëndetësisë....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, Andin! Ministri nuk është këtu. Zoti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi, zoti Kurteshi, e keni fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Zoti ministër, 15 mësimdhënës të shkollës “Mihal Grameno” në Fushë Kosovë, të pranuar në marrëdhënie pune nëpërmjet konkursit të rregullt në verën e vitit 2017, edhe pse punojnë si mësimdhënës të tjerë, nuk janë futur në listën e të ardhurave personale të kësaj shkolle.

Edhe një numër i konsiderueshëm i koordinatorëve të cilësisë, të pranuar nëpër shkollat e Kosovës, nuk janë futur në listën e pagave.

Zoti ministër, rastet e lartpërmendura paraqesin shkelje ligjore, për të cilat ministria është e njoftuar. Çka keni ndërmarrë për zgjidhjen e këtyre problemeve? Po ashtu dëshiroj të them se, edhe pyetja ime është shtruar më 10 dhjetor, kështu që po na bëhen joaktuale pyetjet për shkak të vonesave që po ndodhin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Faleminderit, deputet, për pyetjen tuaj!

Ajo çka duhet të kem parasysh për situatën e krijuar në shkollën “Mihal Grameno” në Fushë Kosovë po edhe në disa shkolla të tjera, ka të bëjë me shtimin e numrave të të punësuarve mësimdhënës, e cila nuk përputhet me Ligjin për buxhet të vitit 2018.

Pra, komuna është përgjegjëse që të punësojë mësimdhënës në përputhje me numrin që është paraparë në Ligjin për buxhet të vitin 2018. Në rast se ka tejkalim të numrit të mësimdhënësve, atëherë komuna duhet t’i drejtohet Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Administratës Publike.

Megjithatë, ne si Ministri e Arsimit kemi diskutuar bashkë me komunën dhe kemi qenë të gatshëm të ndërmjetësojmë dhe të bashkëpunojmë, në mënyrë që të ulemi me Ministrinë e Administratës dhe me Ministrinë e Financave të diskutojmë, pasi që Fushë Kosova ka pasur një specifikë të veten, për shkak të ardhjeve të shumta që kanë ndodhur në këtë qytet.

Ndërsa lidhur me çështjen e koordinatorëve, komunat kanë qenë të obliguara që koordinatorët të emërohen nëpër shkolla me gjysmë orari koordinatorë dhe gjysmën e pjesës tjetër si mësimdhënës. Kjo është e paraparë sipas Udhëzimit 24/2016, e komunat të cilat pastaj nuk e kanë respektuar Udhëzimin administrativ, kanë shkaktuar këso problemesh, ku kanë futur koordinatorë pa qenë fare në listën e pagave. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Kurteshi, dëshironi pyetje shtesë, fjalën e ka zoti Kurteshi

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Me këtë që e tha ministri për angazhimin e ministrisë është krejt e pamjaftueshme, sepse këtu dikush ka pësuar, shumë familje kanë mbetur pa të ardhura personale për dy vjet dhe ata që e kanë shkelur ligjin, siç ka edhe shkelje të tjera të ligjit nëpër komuna, për të cilat është e njoftuar ministria, siç është rasti i pensioneve jubilarë dhe pensioneve përcjellëse të atyre që kanë shkuar dhe u takojnë në bazë të ligjit, komunat këto nuk i zbatojnë, po aty humbës janë, në këtë rastin e fundit pensionistë, në rastin paraprak janë mësuesit, prej të cilëve ne presim punë cilësore, kurse, në anën tjetër, nuk i paguajnë.

Dihet po ashtu se edhe ligjet duhen të ndryshojnë në momentin kur ndryshon situata...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën prapë, në qoftë se doni.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Deputet, unë pajtohem plotësisht me konstatimet tuaja. Megjithatë unë konsideroj që adresa duhet të jetë e saktë. Ministria e Arsimit nuk mund të bëjë këtu zgjidhje, zgjidhja është në Ministri të Administratës dhe te Ministria e Financave.

Gjithsesi për problemin e dytë që kemi edhe pyetje parlamentare, me insistimin tim tash më është zgjidhur problemi i pensioneve jubilarë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Prapë zoti Kurteshi, pyetje për ministrin Kujtim Gashi. Zoti Kurteshi, e keni fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit! Zoti ministër,

Në fillim të dhjetorit Serbia ka arritur ta regjistrojë në UNESCO instrumentin e njohur shqiptar, lahutën, si instrument të trashëgimisë së saj kulturore. Se lahuta është instrument i shqiptarëve, nuk është vështirë të dokumentohet dhe argumente të tilla ka në Institutin Albanologjik, në Shqipëri dhe gjithkund në trojet shqiptare, po megjithatë ne nuk kemi ndërmarrë një hap të tillë me kohë.

Zoti ministër, çfarë ka ndërmarrë ministria që ju e drejtoni që ta demantojë Serbinë dhe lahutën ta regjistrojë si instrument të trashëgimisë sonë kombëtare.

KRYESUESI: Zoti ministër Gashi, e ke fjalën.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,
Zoti Kurteshi,

Sa i përket çështjes së lahutës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit vazhdimisht është përpjekur që të kompletojë inventarin, studimet, hulumtimet dhe interpretimet në fushën e trashëgimisë kulturore, me theks të veçantë të asaj jomateriale dhe promovimit.

Po ashtu kam mbështetur punën e Komisionit ndërqeveritar për eposin e kreshnikëve, me theks të veçantë punimin me filmin dokumentar për Eposin e Kreshnikëve.

Dosja për Eposin e Kreshnikëve është punuar në përputhje me kriteret ndërkombëtare dhe bazuar në dispozitat e Konventës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, kurse është hartuar nga grupi i specialistëve më eminentë edhe të Kosovës, po edhe të Shqipërisë.

Filmi dokumentar është në dy variante, njëri është shfaqur në një nga edicionet e festivalit EtnoFest në Kukaj, kurse varianti tjetër është i punuar dhe i bashkangjitur dosjes kur është përgatitur për aplikim në UNESCO.

Në kuadër të filmit dokumentar për Eposin dhe të folklorit burimor në fokus është instrumenti muzikor lahuta, që përfaqëson arketipin më të lashtë të veglave kordofone me hark të kontinentit evropian dhe që shoqëron këngët e kënduara.

Qëllimi i përfshirjes së Eposit të Kreshnikëve në listën e përfaqësimit të trashëgimisë kulturore shpirtërore të UNESCO-s ka qenë dhe do të mbetet si e tillë.

Pra, përfshirjen e monumentit më të lashtë të etnokulturës si një nga shtyllat kryesore të trashëgimisë jomateriale dhe një nga pikat më të rëndësishme evropiane dhe botërore, i kategorizuar si i tillë ka edhe do të ketë për qëllim respektin e vazhdueshëm ndërmjet komuniteteve, grupeve, individëve si dhe do të promovonte respektin për diversitetin kulturor.

Për shkak të rrethanave të asaj periudhe, parashtrimi për Eposin e Kreshnikëve në UNESCO nuk ka ndodhur, si kundër që është aspiruar fillimisht anëtarësimi i Kosovës, për të ndjekur tutje procedurat e rregullta.

Në këtë relacion Ministria e Kulturës ka dhënë edhe statusin ligjor për Eposin e Kreshnikëve në kuadër të listës së Trashëgimisë Kulturore në kategorinë e pestë të trashëgimisë shpirtërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shtesë, deputet Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Ministër, ju lutem, na informoni cilët janë hapat konkretë të ministrisë që kjo çështje të shkojë në UNESCO dhe lahuta të pranohet si instrument te shqiptarët dhe cili është bashkëpunimi i ministrisë suaj me ministrinë homologe të Republikës së Shqipërisë.

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit edhe një herë, nënkryetar!

I nderuar deputet,

Besoj që e thashë në rezyme, se ne në këto rrethana kemi pasur mundësi të vogla që të veprojmë, ndoshta shteti shqiptar, Ministria e Kulturës e Shqipërisë, ka pasur mundësi më të mëdha të kishte një reagim më konkret, sepse siç dihet, Kosova nuk është anëtare e UNESCO-s dhe, si e tillë, nuk është palë, pra nuk pranohet asnjë ankesë ose shkresë jona, e cila do të mund të adresohet në UNESCO. Në këto momente dhe në këto rrethana ndoshta shteti shqiptar ka mundur të veprojë, ne kemi pasur një komunikim me ministrinë atje, po reagimet kanë qenë të plogështa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Safete Hadërgjonaj, pyetje për ministrin Mustafa. Ministri nuk është, po më duket.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Ministri s' qenka.

Unë e kam një pyetje që ka të bëjë me dukurinë e shpeshtuar të vjedhjeve dhe grabitjeve dhe kam qenë e interesuar të di se çka po bën Qeveria në lidhje me këtë çështje që t'i dalë përballë kësaj dukurie. Prandaj, unë pyetjen do ta lë kur të vijë ministri që t'i drejtohem, sepse këtu nuk di kush mund të japë përgjigje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Mimoza Kusari-Lila, pyetje për kryeministrin Haradinaj. A dëshironi ta bëni pyetjen, kryeministri nuk është këtu.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Vetëm një përmbledhje të shkurtër për kryeministrin. Pyetja është që u bënë një vit prejse kur ky Kuvend ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme për kualitetin e ajrit dhe ka nxjerrë një rezolutë me 18 pika. Pyetja për kryeministrin është: pas një viti cilat janë pikat, të cilat janë realizuar nga ajo rezolutë, duke ditur faktin se prej 18 pikave, një numër i konsiderueshëm i tyre kanë pasur afat gjashtëmujor dhe njëvjeçar, ndërsa cilësia e ajrit në Kosovë, në veçanti në Prishtinë, vazhdon të jetë mos më keq.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kusari-Lila, prapë pyetje për ministrin Ismajli, ministri Ismajli ka kërkuar leje, është në detyrë, në qoftë se dëshironi, mund të bëni pyetjen.

MIMOZA KUSARI-LILA: Po, atëherë kur kthehet ministri, ia bëjmë pyetjen që të përgjigjet.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Naser Rugova, pyetje për kryeministrin Haradinaj, zoti Rugova, në qoftë se dëshironi pyetjen.

NASER RUGOVA: Faleminderit! Pasi kryeministri nuk është prezent në seancë, edhe unë propozoj që pyetja të prolongohet për seancën e ardhshme, kur kryeministri do të jetë prezent. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Arbër Rexhaj, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi, zoti exhaj, e keni fjalën.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Me Ligjin e punës parashihet që mësimdhënësve, ministër, t'u paguhen edhe pagat jubilarë.

Meqenëse nuk ka kod në buxhet për këtë çështje, mësimdhënësit lëndët i fitojnë përmes gjykatave. Kjo është anomali që duhet rregulluar, duke vendosur një kod për këtë çështje në buxhet. Nga komuna nga vijë unë, pra komuna e Prizrenit, kemi qindra raste të mësimdhënësve, të cilët sorollaten gjykatave dhe kthinave të tyre dhe qindra të tjerë po presin një vendim për këtë kod buxhetor.

Kryetari i Komunës sonë, jo që nuk do dhe nuk e ka parashikuar pagesën e tyre, por në mungesë të këtij kodi buxhetor e ka të pamundur pagesën dhe, ju si ministër, si do ta përmirësoni këtë anomali, në fakt a keni vullnet për ta bërë këtë?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bytyqi, e keni fjalën, ministër i Arsimit.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Deputet, faleminderit për pyetjen!

Në fakt, ky ka qenë një problem, i cili ka pasur një vendim pas Kontratës kolektive që të ndahen pensionet jubilarë, por që në fakt shumica e komunave nuk e kanë respektuar, s'kanë pasur ndarje as për buxhet dhe ka shkaktuar shumë probleme, siç e theksuat edhe ju çështjen nëpër gjykata dhe pastaj edhe fitimin e këtyre lëndëve.

Ajo çka kemi bërë ne si Ministri e Arsimit këtë vit kur është miratuar granti specifik për komuna, me propozimin tonë është futur buxheti i veçantë për pensionet jubilarë. Pra, kemi një buxhet për vitet 2019-2021, për secilin vit nga një milion euro, që është në përputhje me gjithë mësimdhënësit të cilët dalin në pension dhe do t'i gëzojnë këto pensione.

Çështjet e tjera administrative po të isha ministër i Financave do t'i kisha rregulluar, ndoshta, nëse më kishte ardhur pyetja ose kërkesa, në fakt. Komunitat duhet t'i drejtohen tashmë Ministrisë së Financave për të ndarë këtë kod të veçantë për këto pensione jubilarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Po zoti Rexha.

ARBËR REXHA: Komuna e Prizrenit ka qenë shumë e përgjegjshme në raport me mësimdhënësit dhe sidomos me pagën jubilarë. Mirëpo, në mungesë të një infrastrukture, qysh është pra kodi buxhetor, ne kemi pasur të mundur, përkundër vullnetit nga Komuna e Prizrenit që e ka pasur për t'i paguar këta mësimdhënës meritore.

Prandaj, meqenëse është edhe ministri i Financave këtu, edhe ministri i Arsimit, mendoj që ju si dy ministri është dashur që të bashkëpunoni dhe ta rregulloni këtë çështje dhe se rasti, siç është i Prizrenit, por sigurisht ka shumë komuna të tjera, në fakt, krejt Kosova e ka këtë problem, ju një herë e përgjithmonë duhet ta rregulloni këtë çështje dhe më pastaj, komunat e përgjegjshme e kryejnë detyrimin e vet.

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër, a e dëshironi fjalën?

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Deputet, konsideroj se tashmë kjo çështje është e thjeshtësuar, vetëm komunat duhet t'i drejtohen me kërkesë Ministrisë së Financave, pasi që buxheti është i ndarë, mjafton që të bëhet kërkesa dhe do të zgjidhet ky problem.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhaj, prapë pyetje për ministrin Rikallo, ministri nuk është këtu. A dëshironi ta bëni pyetjen?

ARBËR REXHA: Po, sepse ministri Rikallo nuk ka qenë një kohë shumë të gjatë këtu dhe unë dua ta bëj një pyetje për Ministrinë e Bujqësisë, në fakt, sepse në komunën e Prizrenit bujqit dhe blegtorët kanë pasur dëme në vlera prej mbi 177 mijë euro, dhe normalisht kjo ka ardhur si pasojë e vërshimeve dhe fatkeqësive natyrore.

Ministria nga Komuna e Prizrenit e ka marrë një raport të dëmtimeve, gjegjësisht nga Drejtoria e Bujqësisë dhe unë kam pasur një takim me këta bujq dhe blegtorë, të cilët janë në pritje të kompensimit të dëmeve.

Meqenëse nuk e di a ka dhe a ekziston kjo ministri, meqenëse nuk është as kryeministri këtu, unë në përgjithësi po ju drejtohem juve si koalicion i PAN-it e që ta keni parasysh këtë segment dhe kjo çështje, dëmi i bujqve nuk është vetëm në rastin e Prizrenit, sigurisht për krejt bujqit e Kosovës, e të cilët duhet t'i ndihmojë pra Qeveria, nëse ka jetë dhe për aq sa ka jetë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi, ka dy pyetje për zotin Haradinaj. Mund t'i bëni të dy pyetjet përnjëherë, mund t'i shtyni për seancën kur është kryeministri.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Këto dy pyetjet janë për kryeministrin, realisht të dyja janë për ministra, po meqenëse këta ministra nganjëherë po na mashtrojnë hapur, po rrejnë, po duhet bërë kryeministrin. Të dyja

pyetjet janë me rëndësi, njëra është për shuarjen e Institutit për Krimet e Luftës dhe tjetra është për aksin rrugor Gjilan-Kumanovë. Unë do t'ia bëj kryeministrit, për arsye se vërtet ministri ka dalë edhe hapur prej kësaj foltore, ka rrejtur për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Fatmire Kollçaku, pyetje për ministrin Ekrem Mustafa, e keni fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Ju falënderoj, edhe pse ministri nuk është këtu, unë do ta parashtoj pyetjen, meqenëse bëhet fjalë për Ligjin për rendin dhe qetësinë publike, në fakt, për nenin 8, për të cilin është përgjegjës Ministria e Punëve të Brendshme, që ka të bëjë me faktin që neni 8.1, kushdo që shkakton zhurmë të panevojshme dhe të padurueshme që dëgjohet nga banorët përreth apo në rrugë dhe i shqetësojnë personat e tjerë nga ora 22:00 e deri në orën 7:00, gjatë ditëve të javës dhe prej orës 23:00 e deri në orën 7:00 të shtunave dhe të dielave dënohet për kundërvajtje.

Vetëm një shembull po e marr në Prishtinë, po edhe në Pejë, në rrugën "Rexhep Luci" në Prishtinë çdo natë ftohen policë, thërrasin qytetarët për prishje të rendit dhe qetësisë publike nga lokalet apo kafenetë, të cilët terrorizojnë qytetarët, është për keqardhje t'i shohësh çdo ditë ata qytetarë që grumbullohen. Këtu ka të bëjë edhe Komuna, shkelja e Rregullores së Komunës, nuk respektohet orari i punës, kur dihet se në sezonin e dimrit lokalet duhet të mbyllen në orën 23:00, ndërsa verës në orën 24:00.

Ndërsa sa i përket prishjes së rendit dhe qetësisë publike, është përgjegjës Ministra e Punëve të Brendshme dhe shtrohet pyetja: a duhet ne t'i respektojmë ata pronarë të lokaleve dhe bizneset e tyre, të cilët u referohen kur shtrohet kjo pyetje që t'i shesin banesat, kjo është përgjigjja arrogante e pronarëve. Ne e mirëkuptojmë bizneset, lokalet që donë të punojnë, por nëse donë t'i çelin lokalet natën, është periferia e qytetit, jo qendra. Pyetja është pse nuk ka bashkëpunim po ashtu të Ministrisë së Punëve të Brendshme me Inspektoratin e komunës dhe çështjen sa i përket Komunës këtë çështje do ta ngre përmes Grupit Parlamentar të Lëvizjes në komunë, sepse edhe Inspektorati nuk bën asgjë në këtë drejtim. Prandaj, ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Prapë, zonja Kollçaku pyetje për ministrin Skender Reçica.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit! Në

Kuvend, zoti ministër, është miratuar rezoluta nr. 06/L-007, ku në njërin nga pikat, ka qenë rezolutë e propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje, mirëpo e përkrahur edhe nga grupet e tjera parlamentare.

Në pikën e pestë të rezolutës kërkohet që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të paraqesë raportin e detajuar mbi gjendjen e zbatimit të drejtave të punës dhe të projektit që ka iniciuar për subvencionimin e pagës dhe atë për punësimin e një anëtari të familjes në familje pa asnjë anëtar të punësuar.

Ne aktualisht po debatojmë për Projektligjin për paga dhe pikërisht nga ju zyrtarë të Qeverisë aktuale jeni ata që po e shtroni çështjen e të papunëve, duke u lutur për mirëkuptim për ata që marrin paga dhe po kërkojnë rritje, ndërsa ne po brengosemi për ata të papunët.

Prandaj, po e shtroj me të drejtë pyetjen: çfarë keni bërë për zbatimin edhe të programit elektorale, ku edhe i keni fituar zgjedhjet duke premtuar që prioritet në punësim do të kenë familjet që nuk kanë asnjë të punësuar, i dispononi listat e familjeve që përfitojnë nga skema për ndihma sociale, mbi 26 mijë familje.

Ju lus konkretisht, mbi një vit e gjysmë keni pasur mundësi, për afërsisht, po prej rezolutës, e cila është miratuar në qershor, çfarë keni bërë me kërkesën për zbatimin e pikës 5, konkretisht për punësimin e këtyre njerëzve që nuk e kanë asnjë familjar të punësuar.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Reçica, e keni fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

E nderuar deputete, faleminderit për pyetjen!

Realisht unë jam përgjigjur sa herë ka qenë nevoja në komisionet parlamentare për të raportuar për të drejtat e punëtorëve për marrëdhëniet në punë dhe bazuar në rezolutën që është miratuar nga Kuvendi në qershorin e vitit të kaluar, obligimet të cilat burojnë dhe jemi në përgjegjësi, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, realisht kemi bërë shumë veprime, të cilat karakterizojnë avancimin e të drejtave të punëtorëve, mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, sigurinë dhe shëndetin në punë, por edhe te projekti të cilin e kemi lansuar punësimin e një anëtari për familje të cilat nuk kanë asnjë të punësuar.

Realisht përgjatë kësaj periudhe është bërë mjaft dhe unë si ministër në ministri kemi përgatitur një raport të cilin shumë shpejt do ta keni në komisionin profesional dhe pasi ta keni atë raport, me kënaqësi do të diskutoj dhe do të jem shumë i hapur për secilin pyetje që ju mund ta parashtroni.

Realisht për sot nuk kam përgatitur ndonjë përgjigje sa i përket asaj çka është kërkuar, sepse ju keni kërkuar pse nuk keni raportuar, një raport të tillë ne e kemi përgatitur dhe shumë shpejt do ta keni në komisionin parlamentar, të cilën unë pres që bashkërisht ta diskutojmë fillimisht në komision parlamentar dhe, pse jo edhe në seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

FATMIRE KOLLÇAKU: Ministër, do të thotë, kjo është shumë pyetje konkrete, prandaj mendoj që raportin të cilin tanimë u zotuat që do ta paraqitni, meqenëse ju e shprehët vullnetin të vini para komisionit, po jeni të obliguar edhe para Kuvendit, sepse rezoluta ju fton të vini edhe të raportoni para gjithë deputetëve, të vini me shifra konkrete: sa familje janë larguar nga skema për ndihmë sociale duke iu falënderuar punësimin, sepse pa kriter po largohen. Ne e dimë që ka keqbërës, keqpërdorues aty, mirëpo shumica janë vërtet nevojtarë, të cilët janë në minimum të ekzistencës dhe ne si qytetarë të Republikës së Kosovës nuk dimë çfarë po bëni, sa familje i keni shpëtuar nga kjo varfëri e skajshme.

Prandaj, kërkoj që zotimi juaj që të vini të raportoni, të vini sa më shpejt me shifra konkrete. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër!

MINISTRI SKENDER REÇICA: Zonja deputete,

Realisht, në raportin të cilin ne e kemi përgatitur, është raport i cili buron nga aktivitetet dhe nga veprimet, të cilat ne i kemi ndërmarrë si ministri gjatë kësaj periudhe para miratimit të kësaj rezolute, por dhe pas miratimit të rezolutës. Realisht për gjatë gjithë vitit ne e kemi biseduar me shumë qytetarë, të cilët janë përfitues të skemave të asistencës për ndihmë sociale dhe dua t'ju informoj juve dhe të gjithë qytetarët se aktualisht kemi mbi 25 mijë familje, të cilat gëzojnë asistencën sociale dhe në këtë grup të familjeve, ne e kemi të klasifikuar dy kategori: kategorinë e parë, ato familje, të cilat nuk e kanë të aftë asnjë anëtar të familjes për t'u punësuar dhe në kategorinë e dytë, ato familje të cilat njëri nga anëtarët e atyre familjeve është i aftë për punë. Ne kemi punuar dhe kemi identifikuar dhe kemi bashkëbiseduar në shumicën e komunave me këta qytetarë për të parë gatishmërinë e tyre nëse u ofrohen ndonjë mundësi e punësimit për t'u punësuar.

Realisht në këtë vit ne kemi në agjendën legislative edhe ligjin që rregullon dhe financon skemat sociale, të cilat financohen nga shteti. Është një shqetësim tek këto kategori për shkak të ligjit aktual, i cili rregullon mbështetjen financiare, mbështetjen në skemat e asistencës sociale që automatikisht këto familje nëse shënohet ndonjë e hyrë tjetër në buxhetin e tyre, në të ardhurat e tyre, skema sociale ndërpritet dhe ideja ka qenë që përgjatë gjithë kësaj periudhe ne kemi bërë hulumtime, kemi biseduar me ta dhe kemi ardhur në një përfundim që duhet ta ndryshojmë, duhet ta iniciojmë plotësim ndryshimin e Ligjit për skemat sociale të financuara nga shteti, ku mëtojmë të rregullojmë këtë çështje që në këto familje, edhe nëse do të shënohen të hyra të tjera, të mos vijë deri te ndërprerja komplet e asistencës sociale. Të gjitha këto i keni të pasqyruara në raport, të cilin unë besoj shumë shpejt do ta përcjell për Komisionin Funkcional dhe natyrisht që do të jem shumë i hapur për secilën çështje të debatohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja Arbërie Nagavci, pyetje për ministrin Kujtim Gashi. Zonja Nagavci, e keni fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër, vitin e kaluar Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ka marrë vendim për ndarjen e 400 mijë eurove për bartjen në Prizren të një pjese të Ministrisë, dhe Komuna e Prizrenit e ka miratuar propozimin për dhënien në shfrytëzim të dy objekteve, në mënyrë që të realizohet ky qëllim.

Ashtu siç e pamë, ceremonia formale e bartjes ka ndodhur javën e kaluar, përderisa në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës që nga qershori i vitit të kaluar, pra gjashtë muaj përpara janë hapur konkurset për pranimin e personelit, gjegjësisht stafit që do të punojë në Prizren në këtë ministri. Dhe, po ashtu janë shpallur edhe emrat e personave që janë përzgjedhur. A mund të na tregoni se sa pozita të lira për punë në kuadër të Ministrisë në Prizren janë hapur? Sa persona janë punësuar tashmë? Dhe, a kanë filluar punën, gjegjësisht a ka filluar realizimi i pagesave? Dhe, mundësisht na tregoni se prej cilës kohë ka filluar realizimi i pagesave për personat e punësuar?

KRYESUESI: Zoti Gashi, e keni fjalën.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Deputetë,

E nderuar deputete Nagavci,

Në fakt, në Projektbuxhet për vitin 2018 kemi pasur të planifikuar 400 mijë euro për restaurimin e objektit, të cilin komuna na ka ofruar për shfrytëzim, po faktikisht në këtë objekt jetojnë disa familje me asistencë sociale dhe komuna gjatë vitit 2018 nuk ka arritur t'u gjejë zgjidhje këtyre familjeve dhe ne nuk kemi pasur mundësi ta shpenzojmë këtë pjesë të buxhetit dhe në të njëjtën kohë me ridestininim të mjeteve e kemi bartur në projekte të tjera, për të cilat ka pasur nevojë Ministria e Kulturës dhe ende jemi duke pritur që Komuna e Prizrenit këto familje, të cilat janë të vendosura në objektin i cili quhet "Objekti i Internatit", t'i bartë në banesat, të cilat po ndërtohen për asistencë sociale dhe ne pastaj të fillojmë restaurimin e këtij objekti, përkatësisht ta adaptojmë për nevojat e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Siç dihet, ashtu siç e thatë edhe ju, një pjesë tashmë e ministrisë ka filluar të bartet në komunë, në një prej objekteve të tjera, sepse siç e dini, kemi marrë dy objekte, ai ka qenë i gatshëm, e kemi rinovuar dhe e kemi bartur një pjesë të stafit, përkatësisht Kabinetit të ministrit, dhe janë gjithsej 12 zyrtarë, të cilët aktualisht po punojnë në këtë objekt, janë kryesisht zyrtarë, të cilët janë angazhuar me kontrata mbi shërbime të veçanta, sepse gjatë vitit 2018 nuk kemi pasur pozita të lira për t'i angazhuar zyrtarët dhe për vitin 2019 i kemi të planifikuara 12 pozita, sipas buxhetit për vitin 2019 dhe besoj që do të fillojmë me procedura të rregullta të konkurseve për

këto 12 vende. Aktualisht janë diku 12 zyrtarë, 3 roje, pastaj zyrtari ligjor, ai financiar, disa nga kabineti i ministrit dhe kështu me radhë.

Pagesat kanë filluar të bëhen diku gjashtë muaj më herët për disa, kurse për disa të tjerë tre muaj, sepse kanë qenë të angazhuar edhe në përgatitjen e infrastrukturës për zhvendosjen e Ministrisë në Prizren. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja Nagavci, dëshironi pyetje shtesë? Zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

Pra, ministër ju thatë se janë punësuar 12 zyrtarë, të cilët edhe pse zyrtarisht puna ka filluar në janar të këtij viti, ata kanë filluar të marrin pagesa që gjashtë muaj, dhe si e arsyetoni këtë fakt, shtuar kësaj edhe faktin që mjaft prej tyre janë persona, të cilët janë shumë të afërt me PDK-në, duke filluar prej vetë kryetarit të Degës së PDK-së aty, dhe të tjerët se nuk po dua t'i përmend kështu me emra. Pra, si e arsyetoni faktin që janë paguar gjashtë muaj, edhe pse nuk kanë punuar?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi e keni fjalën.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Në fakt, zyrat e ministrisë, përkatësisht objekti është marrë diku 7-8 muaj më herët, sepse Kuvendi Komunal i ka dhënë në shfrytëzim këto objekte dhe menjëherë e kemi vendosur një pjesë të stafit, pastaj është dashur të rinovohet dalëngadalë objekti, të përgatitet, por përkundër këtij fakti, zyrtarët kanë filluar punën diku para gjashtë muajve në zyrat e ministrisë, kurse unë nuk e di që kryetari i degës është pjesë e stafit tonë, zyrtarët e tjerë mund të jenë të afërt, mund të jenë, po nuk është kryetari i degës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja Nagavci, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër, ashtu siç e dini, Ligji për arsimin parauniversitar parasheh që të gjithë drejtorët, zëvendës drejtorët e institucioneve edukative-arsimore dhe cilido person tjetër që dëshiron të aplikojë për këtë pozitë, është i obliguar sipas ligjit që të ketë të përfunduar një program për udhëheqje arsimore, i cili është i autorizuar nga ministria, sipas vendimit të rekomandimeve të Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve.

Në kuadër të zhvillimit profesional të mësimdhënësve, ashtu siç ju besoj jeni në njohuri, MASHT-i, në bashkëpunim me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, ka ofruar edhe mbajtjen në organizimin e trajnimeve të mësimdhënësve, prej të cilave ka pasur mundësi të ofrohen edhe trajnime me vetëfinancim dhe në mesin e tyre ka qenë edhe trajnimi për udhëheqje

arsimore. A mund të na tregoni, ju lutem, se a keni marrë ndonjë vendim, me të cilët ndalohet kjo formë e zhvillimit profesional? Nëse po, mundësisht na tregoni numrin e vendimit dhe datën e marrjes së tij, pasi në faqen zyrtare të MASHT-it nuk ka ndonjë vendim të tillë, të paktën unë nuk kam mundur të gjej një vendim të tillë dhe sa jam në njohuri këto trajnime po vazhdojnë në komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës.

Dhe, ju lutem të na njoftoni çfarë keni ndërmarrë në mënyrë që të siguronit mundësinë për të gjithë kandidatët që janë të interesuar të aplikojnë për pozitat udhëheqëse në institucionet edukativo-arsimore që të plotësojnë këtë kriter ligjor, pasi që është evidente fakti se përkundër që janë organizuar mjaft trajnime, jo gjithmonë kanë pasur mundësi t'i ndjekin këto trajnime të gjithë ata që kanë qenë të interesuar për shkak se përcaktimi i vijuesve ka shkuar qoftë nëpërmes drejtorëve të shkollave, qoftë nëpërmes të drejtorive komunale të arsimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Bytyqi, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Faleminderit deputete për pyetjen tuaj!

Ajo çka ne kemi marrë vendim të bëjmë si Ministri e Arsimit dhe unë si ministër për të gjitha llojet e trajnimeve, të cilat janë bërë të financuara nga Ministria e Arsimit dhe me partnerët ndërkombëtarë, në bashkëpunim me organizatat e ndryshme, ne i kemi ndërprerë, pasi që dëshirojmë që të gjitha llojet të ketë trajnime, për mësimdhënës të shkojnë përmes rrugës institucionale dhe të kontrolluara. Ky vendim ka ardhur si pasojë që nuk kemi pasur asnjë kthim mbrapa të informacioneve se çka ka ndodhur me trajnime dhe cilat janë përfitimet që mësimdhënësit tonë i kanë arritur nga këto trajnime. Të gjitha llojet e trajnimeve, përfshirë tashmë edhe këtë trajnimin për udhëheqjen në arsim.

Aktualisht jemi duke shqyrtuar të gjitha licencat që janë lëshuar nga Ministria e Arsimit për të parë se çfarë lloj obligimi kemi ndaj këtyre licencave, mirëpo ajo që është marrë vendim, më nuk do të ketë thirrje publike për licencime të reja. Ndërsa, licencimet që ekzistojnë do t'i shqyrtojmë dhe do të shohim se çfarë lloj obligime kemi. Tash, duhet ta kemi edhe informatën besoj që edhe ju e keni informacionin, që për udhëheqje në arsim kemi edhe tek universitetet dhe te fakultetet e ndryshme dhe të gjithë kandidatët që kanë interesim për të qenë udhëheqës të institucioneve të arsimit mund të drejtohen në mënyrë institucionale nëpër fakultetet tona dhe nuk kemi nevojë më që të kemi vetëm çështje të trajnimeve. Ne tashmë jemi duke rregulluar edhe Udhëzimin administrativ që ka të bëjë me çështjen e udhëheqësve të shkollave, me drejtorët e shkollave dhe konsideroj që Udhëzimi i ri administrativ këtë do ta qartësonte mjaft mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Zoti ministër, ju lutem edhe një herë, thatë se është një vendim i brendshëm, a mund të më tregoni a ka datë ai vendim, a ka numër, a është i publikuar diku? Si mund ta gjejme një vendim të tillë dhe çka decidivisht thuhet në vendim, sepse siç ju thashë, trajnimet janë duke vazhduar dhe nëse keni marrë vendim për ndërprerjen e tij, ju lutem nëse mund të na tregoni, po e përsëris datën apo numrin e vendimit, apo e keni publikuar diku. Jam plotësisht dakord me këtë çështjen e vijimit të programeve në fakultet dhe rregullimit me Udhëzim administrativ.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: E theksova, është vendim i brendshëm për mosthirrje publike për trajnime të reja. Ndërsa, për licencat, të cilat ekzistojnë, jemi në shqyrtim dhe pas shqyrtimeve të obligimeve që na dalin për këto licenca, do të marrim një vendim i cili do të jetë edhe publik. Nëse ne nuk kemi ndonjë obligim ndaj këtyre licencave, do të marrim vendim që të gjitha licencat të anulohen, pasi që thashë se është rruga zyrtare e trajnimeve.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Drita Millaku, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

DRITA MILLAKU: Faleminderit!

Studentët e Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, Drejtimi Gjuhë dhe letërsi shqipe, Gjuhë dhe letërsi angleze, Matematikë, Informatikë dhe atij të Drejtimit kimi-fizikë, të regjistruar në vitin akademik 2011-2012, dhe ata të vitit akademik 2012-2013, nuk është bërë nostrifikimi i diplomave nga Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe MASHT-it. Pyetja pothuaj se është e njëjtë si një pyetje paraprake, por ministër, a jeni në dijeni dhe çfarë do të ndërmerrni në këtë rast, sepse ata studentë tanimë janë të diskriminuar?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

E nderuar deputete, konsideroj që kjo pyetje posa u shter, sepse është e njëjta pyetje që erdhi edhe nga deputetja Aida, është e njëjta përgjigje. Ka qenë një problem i akumuluar, për të cilin tashmë ne jemi në fazën e ndërtimit të këtij grupi punues të tri institucioneve, pra Ministria e Arsimit, Agjencia e Akreditimit dhe rektorët që ta gjejme një zgjidhje për këta studentë.

KRYESUESI: Faleminderit! Koha ka kaluar, por unë mendoj që t’i shfrytëzojmë ministrat që janë këtu, këta që i kanë pyetjet besoj që janë përgatitur edhe për t’i dhënë përgjigjet, kështu që të mos i sjellim dy herë për të njëjtat çështje. Ata që nuk janë këtu, nuk do t’ua thërras emrat, as nuk do t’ua shtrojmë pyetjet.

Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Bedri Hamza.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Në fakt, kam parashtruar dy pyetje për ministrin e Drejtësisë, po ai s'qenka këtu për t'u përgjigjur dhe për ministrin e Financave. Sa i përket pyetjes për ministrin e Financave, pra çështja është te shpenzimet e buxhetit për vitin 2019 dhe pyetja është e thjeshtë: sipas cilës bazë ligjore po vijoni të shpenzoni buxhetin e shtetit në vitin 2019, duke pasur parasysh që Kuvendi i Republikës së Kosovës ende nuk e ka miratuar buxhetin për vitin 2019?

KRYESUESI: Zoti Hamza e ka fjalën, ministri i Financave.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete Haxhiu,

Ligji Nnr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, në nenin 24 ndarjet buxhetore në mungesë të një ligji për ndarjet buxhetore ka përcaktuar bazën ligjore dhe mekanizimin e veprimit, kur Ligji për ndarjet buxhetore nuk është në fuqi.

Po citoj, neni 24 paragrafi 1, pika "b": "Ndarjet buxhetore në mungesë të një Ligji për ndarjet buxhetore. 24.1. varësisht nga paragrafi 2, i këtij neni nëse një ligj për ndarjet buxhetore për një vit të caktuar fiskal nuk miratohet nga Kuvendi dhe nuk shpallet në mënyrë të rregullt nga personi i autorizuar për këtë shpallje, para fillimit të vitit përkatës fiskal, Ligji mbi ndarjet buxhetore, i cili ka qenë në fuqi vitin e mëparshëm do të trajtohet sikur: nëse nuk ka pasur zgjedhje të tilla brenda afatit kohor thuajse është zgjatur për të mbuluar muajin e parë të vitit fiskal. Thuajse siguron një ndarje buxhetore për çdo organizatë që është e barabartë me 8.33% të ndarjes buxhetore, të siguruar për organizatën e tillë buxhetore nga Ligji i ndarjeve buxhetore. Prandaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi për muajin janar 2019, buxheti është dhënë në dispozicion në 1/12 në bazë të ndarjeve buxhetore të Ligjit nr. 06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Haxhiu? Fjalën e ka zonja Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Kur i referoheni Ligjit për menaxhimin e financave publike, është mirë që nenin të mos e lexoni të shkëputur nga paragrafët e tjerë. Në këtë kuptim unë do të doja që të lexoja nenin 24, paragrafi 2 i Ligjit për menaxhimin e financave publike që thotë: "Vetëm Kuvendi me anë të një vendimi mund ta autorizojë zgjatjen e ligjit për ndarjet buxhetore të vitit të kaluar fiskal". Ligji për ndarjet buxhetore i vitit të kaluar fiskal në asnjë rast nuk mund të zgjatet për më shumë se tre muaj të vitit të ardhshëm fiskal, që nënkupton deri në mars. Por, të drejtën për ta zgjatur e ka vetëm Kuvendi i Republikës së Kosovës. Zoti ministër, a e ka bërë këtë Kuvendi i Republikës së Kosovës? Pra, ju jeni duke e shkelur Ligjin për menaxhimin e financave publike, ju po bëni veprë penale dhe na njoftoni sa është vlera që keni shpenzuar në mënyrë joligjore deri tani?

KRYESUESI: Zoti Hamza, ministër i Financave, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Zonja Haxhiu, me sa e di unë, je juriste, edhe të flasësh diçka çka dëgjova tash, sinqerisht është çudi, seriozisht u befasova, lexo, lexo ti sa dush ligjin, se edhe unë e lexova ligjin, edhe nuk je ti më e mirë se shumë juristë që e kanë interpretuar dhe nuk është hera e parë që ndodh në Kosovë. Unë e kam një lutje tjetër për ty, zonja Haxhiu: Mos e blloko komisionin që ta pamundësosh aprovimin e buxhetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, mos i dëmto qindra-mijëra pensionistë që t'i marrin pensionet me rritje, mos u bë destruktive dhe mos shkakto pengesa, se ke obligim ta kryesh punën tënde si deputete. Kryeje punën, unë u përgjigja, përgjigja ime ty mund të të mos pëlqejë. Ligji e thotë kështu, ti s'e ke nxjerrë ligjin, ti je aq juriste e dobët që të gjitha rastet që ti i ke paraqitur dhe i ke prezantua Gjykata t'i ka hedhur poshtë edhe ka për t'i hedhur poshtë se nuk ke lidhje me profesionin që ti konsideron që je një juriste.

Prandaj, të lutem shumë, çka do që ti e vlerëson që s'është në përputhje me ligjin, shfrytëzoi të drejtat tua ligjore. Mirëpo, mos tento të pasaktën, joprofessionalen, jo të ndershmen ta shitsh si të saktë, ligjore dhe profesionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju e keni bërë pyetjen, ministri është përgjigjur. Deputeti Shemsi Syla, pyetje për ministrin Rustem Berisha.

SHEMSI SYLA: Në ministrinë e sapoformuar, sipas ligjit në fuqi, pra Ministrisë së Mbrojtjes, është deklaruar prej jush, zoti ministër, se menjëherë pas miratimit të ligjit jeni gati të filloni nga puna me strukturën e re të parashikuar me Ligjin e ri për Ministrinë e Mbrojtjes dhe dy ligjet e tjera. Aktualisht, institucioni juaj po vijon të ketë 2 apo 3 versione të strukturës zyrtare. Pyetja: a ka mundësi të na saktësoni qartë dhe të na paraqisni në seancë strukturën zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës?

KRYESUESI: Zoti Berisha, e keni fjalën.

MINISTRI RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë ministra,

Deputetë,

I nderuar deputet Syla, faleminderit për pyetjen.

Pas miratimit të tri ligjeve dhe hyrjes në fuqi, realisht Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes, më saktësisht neni 9 i këtij ligji parasheh riorganizimin dhe kalimin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ministri të Mbrojtjes dhe sipas këtij neni parashihen që të gjitha ndryshimet e parapara me këtë ligj të bëhen konform fazave të transformimit të paraparë me rishikimin strategjik të sektorit të sigurisë dhe të detajuar sipas planit gjithëpërfshirës të

transicionit. Dhe, bazuar në planin gjithëpërfshirës të tranzicionit janë paraparë 120 ditë prej hyrjes në fuqi që ne si Ministri e Mbrojtjes të jemi të gatshëm për fillimin e planit të transicionit.

Strukturën e Ministrisë së Mbrojtjes e kemi në finalizim, ende nuk është zyrtare, realisht presim që deri kah mesi i muajit shkurt të finalizohet dhe të dërgojmë në Qeveri për miratim, edhe besoj që në fillim të marsit kjo strukturë do të jetë e finalizuar dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Shemsi?

SHEMSI SYLA: Po, zoti ministër, meqenëse është një vakum, ne, s'po e di, po bëjmë pyetjen mos mund të jetë një paralajmërim se në të njëjtën mënyrë jeni duke e shfrytëzuar kohën ndoshta për përfitime të ndryshme në emër të një interesi të rëndësishëm, gjithnjë duke u shtyrë dhe nuk ishin, vallë, të mjaftueshme 4 vjet apo 5 që ishin në konsultim me DIER-in dhe gjithnjë deklarimi juaj ka qenë se ajo është gatshme vetëm në momentin kur të krijohet, kur të bëhet ligji, ajo veç do të jetë aktuale.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI RRUSTEM BERISHA: I nderuar deputet Sylja, nuk bëhet fjalë për asnjë lloj përfitimi, realisht ne kemi deklaruar se jemi të gatshëm për fillimin e planit të transicionit të paraparë dhe në kuadër të kësaj, janë të parapara edhe dinamika, aktivitetet me kohë të caktuar kur, në cilën periudhë duhet të miratohet edhe çka, janë të parapara edhe struktura e Ministrisë së Mbrojtjes, edhe Shtabit të Përgjithshëm, edhe 3-4 komandave, po në të njëjtën kohë, edhe rregulloret, dokumentet strategjike që janë paraparë me afate të caktuar deri kur do të miratohen.

Ne jemi në kuadër të atij plani, jemi në rregull me data dhe me afate të caktuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shemsi Sylja, pyetje për ministrin Reçica.

SHEMSI SYLA: Udhëzimi administrativ për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontribut-pagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve stazh pensional nr. 09/2015, në paragrafin 5, neni 5, për kualifikimin e shfrytëzuesve të pensionit kontribut-pagues thotë se të gjitha dëshmitë për kualifikim duhet të jenë para vitit 1.01.1999. Pyetja, zoti ministër: a jeni në dijeni për këtë shkelje, diskriminim dhe mohim që po i bëhet arsimit shqip të periudhës 1991-1999 në Kosovë, kur mijëra studentë janë diplomuar në institucionet shkollore shqip në Kosovë. Nëse po, cilat masa i keni ndërmarrë?

KRYESUESI: Zoti Reçica, e keni fjalën!

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Faleminderit deputet për pyetjen! Së pari, dua t'ju informoj se në bazë të pyetjes tuaj në nenin 5, paragrafi 5 i Udhëzimit Administrativ 09/2015, nuk thotë se të gjitha dëshmitë për kualifikim duhet të jenë para vitit 1. 1. 1999, por para vitit 1. 1. 1991, e para.

Sa i përket pensioneve kontributive, janë dy kriteret kryesore për njohjen e pensionit kontributpagues të moshës, janë përvoja e punës apo e stazhit të punës dhe kualifikimi apo njohja e diplomave. Një qytetar kosovar, apo edhe i huaj për të përfituar këtë pension pra duhet të kenë minimumi 15 vite stazh vit pune dhe të kenë një kualifikim. Struktura kualifikuese ndahet në arsim themelor, të mesëm, të lartë dhe superior. Në rastin konkret, sipas ligjit dhe këtij udhëzimi administrativ, periudha e njohjes së kualifikimit, apo dëshmime për kualifikim lidhet me plotësimin e dy kriterëve të ndërlidhura njëra me tjetrën. Pra, sa për sqarim, një pensionist mund të kualifikohet për këtë pension nëse për këto 15 vjet i ka dëshmuar edhe kualifikimin e arsimuar, ndërsa në këtë rast, kur një person diplomon në vitin 1999, ndërsa ka punuar 15 vjet pa diplomë, atëherë personi nuk mund të thuhet se për ato 15 vjet punë ka punuar dhe ka paguar kontribute si i diplomuar. Arsyeja pse është bërë kjo ndarje, nuk ndërlidhet me punëtorët e arsimit gjatë viteve '90-'99, kjo ndërlidhet vetëm kur dy elementët e lartpërmendura janë të plota. Pra, nuk mund të përfitosh një pension kontributpagues nëse për ato vite të punës nuk ke qenë edhe i kualifikuar.

Ne e kemi analizuar këtë çështje dhe kjo çështje është propozuar që të jetë subjekt i rregullimit në reformën e sistemit pensional, koncepti i të cilit tashmë është hartuar dhe dërguar për miratim në Qeveri në fund të vitit 2018. Udhëzimi administrativ në fjalë po ashtu është vendosur në planin tonë legjislativ, të cilin ne do ta shqyrtojmë me kujdes të gjitha çështjet që ndërlidhen me pensionet kontributpaguese dhe njohja e diplomave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti...

SHEMSI SYLA: Zoti ministër, sikur ky nen, gjegjësisht paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ numër 9, 215 është sikurse me porosi nga Serbia, po legjitimohet periudha më diskriminuese e aparteidit serb të regjimit të Milosheviqit kundër arsimit shqip, sepse paragrafi 5, neni 5 të Udhëzimit Administrativ 09/2015 i hartuar nga Ministria e juaj është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligji nr. 4/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, konkretisht me nenin 8 të Ligjit 04/L-131, i cili nen periudhën 1989-1999 të arsimit shqip në Kosovë e pranon si stazh të sigurimit pensional.

KRYESUESI: Zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit deputet për pyetjen shtesë!

Realisht, ne kemi trashëguar një situatë sa i përket të gjithë të punësuarve në periudhat e paraluftës, posaçërisht në ato vitet '90-'99, kur pothuajse të gjithë punëtorët shqiptarë të asaj kohe u dëbuan me dhunë nga puna. Me këtë rast edhe u përjashtuan nga e drejta që sot ata ta gëzojnë një pension më dinjitoz. Dhe mu për këtë, në koncept-dokumentin të cilin tashmë e kemi hartuar dhe është në pritje për miratim në Qeveri, është menduar që këta qytetarë tanë të cilët padrejtësisht u dëbuan nga puna në atë kohë dhe përkundër që ndoshta një numër fare i vogël i asaj kohe iu nënshtrua atij regjimi dhe sot ata mund të kenë një pension tjetër në krahasim me ata të cilët nuk pranuan dhe u dëbuan. Kjo është një çështje që është trajtuar me shumë kujdes në koncept-dokumentet sa i përket reformës pensionale dhe po, ne kemi marrë vendim dhe kemi pasqyruar në konceptdokument nga i cili do të bëhen edhe Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti, ku do t'u njihet stazhi të gjithë atyre që u dëbuan, në këtë rast edhe punëtorëve të arsimit. Sa i përket kualifikimit, ne kemi trashëguar po ashtu këtë udhëzim administrativ të cilin e cituat ju dhe unë gjithashtu, dhe ky udhëzim administrativ është pjesë e agjendës legjislative nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ku do të trajtohet me shumë kujdes çështja e të diplomuarve dhe trajtimi apo më mirë të them pensionimi i tyre mbi bazën e kualifikimit.

Ne duhet ta kemi të qartë, nuk mund të gëzojë dikush pension për një periudhë kohore, nëse edhe përkundër asaj që ka paguar kontribute për një pozicion i cili është kërkuar diploma dhe ku personi nuk ka pasur diplomë në atë periudhë kohore. Realisht është çështje kjo që ne e kemi planifikuar në agjendën legjislative të këtij viti, që të punojmë në këtë udhëzim administrativ dhe nëse me të vërtetë shihet që është bërë...

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Xhelal Sveçla, pyetje për ministrin Bedri Hamza.

XHELAL SVEÇLA: Zoti ministër, edhe pse prej 21 nëntorit është në fuqi taksa ndaj Serbisë, ende në tregun e Kosovës ka tepër shumë produkte me këtë origjinë. Nga Doganat raportohet për ulje drastike të importit prej Serbisë, por nuk ka rritje të ndjeshme të importeve nga ndonjë vend tjetër. Pyetja ime është: çfarë masash konkrete janë marrë kundër kontrabandës së produkteve të Serbisë në Kosovë dhe sa raste keni raportuar për kontrabandë gjatë dhjetorit 2018 dhe janarit 2019 për mallrat me origjinë nga Serbia.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Sveçla, faleminderit për pyetjen!

Dogana e Kosovës që nga marrja e vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 01/74 më 6. 11. 2018, si dhe vendimit nr. 01/76 më 21. 11. 2018 për masat mbrojtëse kundër produkteve me origjinë nga

Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina ka marrë të gjitha masat për implementimin e plotë të vendimeve.

Dogana e Kosovës me të gjitha kapacitetet dhe njësitë e veta, përveç kontrolleve, në pikëkalimet kufitare ka ndërmarrë veprime që parandalon kontrabandën e produkteve serbe dhe atyre të Bosnjës dhe në kontrolle në brendi të territorit dhe më gjerë.

Është rritur bashkëpunimi dhe koordinimi me Policinë e Kosovës, Inspektoratin e Tregut të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Administratës Tatimore, Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës me qëllim të luftimit të kontrabandës.

Që nga hyrja në fuqi e vendimit, ekipet e anti-kontrabandës kanë operuar 24 orë me aktivitete të shtuara në pjesë dhe zonat dhe rrugët potenciale për kontrabandë. Janë kryer 204 patrullime, 4080 kontrolle dhe ndalës rrugore. Me Policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera janë zhvilluar nëntë plane operative. Në bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës janë duke u kryer kontrolle të përbashkëta. Janë zbuluar 91 raste të kundërvajtjeve doganore, janë proceduar disa raste penale, ku janë kryer edhe bastisje në objekte ku është dyshuar për kontrabandë të mallrave, ndërsa janë arrestuar edhe persona të dyshuar për kontrabandë.

Sa i përket vlerës së mallrave të importit për periudhën 21. 11. 2018 deri më 28. 1. 2019, dhe është krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak 21. 11. 2017 deri 21. 1. 2018 vërehet se importi i produkteve nga Serbia dhe Bosnja pas vendosjes së masave mbrojtëse është zëvendësuar kryesisht me mallra të importit nga vendet fqinje dhe nga disa vende të tjera.

Statistikat: Serbia, vlera e mallrave të importuara periudha 21. 11. 2017 - 28. 1. 2018, 87 milionë, 161 mijë, 898 presje 27 euro. Vlera e mallrave të importuara pas vendosjes së taksës 7 milion, 407 mijë e 915 euro. Diferenca minus 79 milionë, 753 mijë, 982 euro. Bosnjë-Hercegovina. Periudha e vitit 27. 11. 2017 - 28. 1. 2018, 14 milionë, 405 mijë, 466 pikë 15. Periudha 21. 11. 2018 deri 21. 1. 2019, një milion e 40...

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

XHELAL SVEÇLA: Zoti ministër, faktet e ndryshme, disa i keni parë edhe nëpër media, dëshmojnë se në treg ka prodhime serbe me datë prodhimi pas 21 nëntorit, d.m.th. pas vendosjes së taksës me çmime të njëjta, nëse jo edhe më të ulëta si pjesë të aksioneve promovionale. Nëse për taksë 10 për qind do të mund të mendohej për subvencionim nga shteti serb, për taksën 100 për qind nuk është aspak e besueshme. Nëse Kryeministri dhe të tjerët lavdërohen për këtë masë, kurse ne jemi në thumb të kritikës nga shtetet mike, a nuk do të ishte dështim katastrofal që ne të paguajmë çmim politik, kurse ekonomikisht mos të kemi kurrfarë përfitimi?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Zoti Sfeçla, Doganat janë duke e bërë maksimumin. Unë nuk mund të them që për shkak të situatës që ndodhet në veri, kontrabanda është ndalë 100 për qind. Këtë nuk mund ta them që ka ndodhur edhe para se të vendoset taksa. Një çështje që ka qenë, ka pasur stok të produkteve me origjinë nga Serbia dhe Bosnja në depot e bizneseve të Kosovës dhe sigurisht se ato stoqe ende nuk besoj që janë shitur të gjitha. Nëse ka pasur importe me datë të prodhimit pas vendosjes së taksave dhe ka informacione të tilla, unë i lus të gjithë ata që mund të kontribuojnë në këtë drejtim, të kontribuojnë, dhe i mirëpres dhe jam shumë i hapur për të biseduar dhe për të kryer punën në këtë drejtim. Prandaj, nëse ka informacione të tilla, përveç atyre që edhe paguhen për ta luftuar kontrabandën, edhe ne jemi të obliguar që rastet e tilla t'i paraqesim dhe t'i përkrahim Doganat dhe institucionet e tjera.

KRYESUESI: Pyetja e fundit është e zonjës Bogujevci për ministrin Kujtim Gashi. Zonja Bogujevci, e keni fjalën.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit kryesues!

Pyetja shkon për ministrin e Kulturës, Rinisë e Sportin, zotin Kujtim Gashi. Ka të bëjë me kodin buxhetor për institucionet e kulturës. A është bërë diçka në këtë drejtim deri më tani. Nëse jo, cilat janë planet? Është tejet e rëndësishme, d.m.th. ka kaluar një kohë shumë e gjatë dhe institucionet e kulturës ende nuk e kanë kodin buxhetor që është shumë me rëndësi.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuat deputetë,

E nderuara deputete,

Sa i përket nënkodeve buxhetore, se kodet buxhetore për institucionet e trashëgimisë kulturore dhe ato të kulturës tashmë në Projekt-buxhetin e vitit 2019 janë të parapara të gjitha. Siç dihet, të gjitha këto institucione kanë pasur xhirollogari të hapura në bankat komerciale dhe në bazë të një raportit të auditorit, përkatësisht raportit të vitit 2017, është konstatuar se të gjitha këto xhirollogari në bankat komerciale bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe ne menjëherë kemi ndërmarrë veprimet, bashkë me Ministrinë e Financave, të gjitha institucioneve edhe të trashëgimisë kulturore, edhe atyre të kulturës iu kemi hapur nënkode buxhetore dhe nga ky vit të gjithë funksionojnë me kode të veçanta buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

SARANDA BOGUJEVCI: Zoti ministër, mendoj që është shumë me rëndësi që këto institucione duhet të pavarësohen. A e sheh të nevojshme që të bëhet plotësim-ndryshimi i ligjeve përkatëse që këto institucione ta kenë kodin buxhetor të tyre, dhe jo vetëm si nënkode buxhetore dhe të mbahen brenda Ministrisë?

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit! Ashtu siç dihet të gjitha institucionet funksionojnë në bazë të ligjeve të veçanta për pothuajse secilën nga këto institucione. Veprimet tona si ministri sa i përket krijimit të kodeve të reja buxhetore, në njëfarë forme në aspektin financiar i pavarësojnë institucionet, sepse vetë do të menaxhojnë me mjetet, pavarësisht se ato janë në kuadër të buxhetit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Por, mënyra se si kanë për të funksionuar përafërsisht mund të konstatojmë se janë të pavarura në kuptimin menaxherial. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konsideroj se pika, pyetjet e deputetëve për Qeverinë është shteruar. Pyetjet që s'kanë marrë përgjigje, dihet cili është rrugëtimi. Ato që duhet të përsëriten, me siguri që seancën e ardhshme do të jenë në rend të ditës. Tani para se të hyjmë në rend të ditës, ne i kemi disa çështje për të cilat është kërkuar nga grupet parlamentare që t'i fusin si pika shtesë të rendit të ditës, por paraprakisht unë do ta qes si njoftim dhe të miratuar besoj për shkak se është çështje e grupit parlamentar. Pra, në bazë të nenit 71 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Grup Parlamentar i PDK-së në Komisionin për Legjislacion e mandaton Xhevahire Izmakun në vend të deputetit të mëparshëm që ka qenë zoti Çoçaj. Kjo është një çështje që është e grupit parlamentar, besoj që është e miratuar. Ndërsa, çështja tjetër është që në bazë të nenit 63 dhe 71 të Rregullores së Republikës së Kosovës, Grupi Parlamentar i PDK-së propozon për anëtarë të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion, Ndërmarrësi, zonjën. Luljeta Veselaj-Guta në vend të deputetit Nezir Çoçaj. Edhe kjo është e drejtë e grupit parlamentar. Konsideroj të miratuar dhe t'i zënë vendet në komisionet që janë propozuar.

Kemi një propozim tjetër për plotësimin e rendit të ditës më 30.01.2019. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka propozuar plotësimin e rendit të ditës me këtë pikë të rendit të ditës: Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.03/83 të dt. 11 janar 2019 për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin shkurt të vitit 2019, të përcaktuar me Ligjin nr.06/L-20 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, me shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 15, paragrafin 7 të Rregullores së Kuvendit.

Ftoj nënkryetaren e Komisionit për Buxhet dhe Financa, znj. Hadërgjonaj që të paraqesë dhe arsyetojë propozimin.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa në bazë të nenit 69, pika 5 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 21. 1. 2019 shqyrtoi propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/83 të datës 11 janar 2019 për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin shkurt të vitit 2019, të përcaktuar me Ligjin nr. 06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 dhe Kuvendin i paraqet këtë rekomandim: I rekomandohet Kuvendit të autorizojë zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin shkurt të vitit 2019, të përcaktuar me Ligjin nr. 06/L-020 për

Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, në pajtim me nenin 24, paragrafi 1, pika B dhe 24, paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-049 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-07.

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa lut deputetët e Kuvendit të Kosovës që ta bëjnë miratimin e këtij propozim-vendimi të Qeverisë për arsye se i vetmi autoritet i cili mund të bëjë zgjatjen e buxhetit të vitit paraprak për muajin shkurt, është Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe nëse kjo nuk ndodhë, atëherë në muajin shkurt nuk mund të bëhet asnjë pagesë përveç pagesës së borxhit të jashtëm.

Zgjatja e buxhetit është e nevojshme për faktin se miratimi i Ligjit të buxhetit për vitin 2019 është në procedurë që zgjatë disa ditë derisa të dekretohet dhe të publikohet në Gazetën Zyrtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Siç e dini për shqyrtimin e këtij propozimi kërkohet deklarimi me votim për shmangie nga afatet procedurale, të parapara me Rregulloren e Kuvendit, për t'iu shmangur, Kuvendi vendos me dy të tretat e deputetëve të pranishëm në seancën plenare, neni 84 i Rregullores së Kuvendit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim për ta votuar propozimin. Ju lus që t'i zini vendet!

Votojmë tani!

Nuk ka votuar kuromi i duhur. Kanë votuar vetëm 48 deputetë, 48 janë për, në sallë janë 78 deputetë. Kështu që mbetet gjendja çfarë është, e pezulluar.

Propozimi i dytë është i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, që ka propozuar plotësimin e rendit të ditës me këtë pikë: shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, në shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 15, paragrafi 7 të Rregullores së Kuvendit.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional, zotin Haxhi Shala që të paraqesë dhe arsyetojë propozimin.

HAXHI SHALA: Faleminderit kryetar!

Me kërkesën edhe të Apostolovës, edhe Komisioni ka vendosur që...

KRYESUESI: Rregulloje pak mikrofonin, Haxhi!

HAXHI SHALA: Me kërkesë të zonjës Apostolova, me të cilën kemi pasur një takim profesional lidhur me këtë çështje të këtij ligjit, që ky ligj të bartet nga seanca e radhës në këtë seancë, për shkak se i humbim afro 2 milionë euro donacion lidhur me zbatimin e këtij ligji.

Kështu që kërkoj nga të gjitha grupet parlamentare, besoj që të gjitha grupet parlamentare kanë pasur nga një përfaqësues në Komision, dhe jemi pajtuar që këtë ligj ta bartim në këtë seancë. Kështu që kërkoj nga të gjithë deputetët të votohet bartja e këtij ligji nga seanca e radhës që vjen në këtë seancë, për shkak se në muajin janar nevojitet votimi i këtij ligji në lexim të dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë është edhe për këtë propozim është e njëjta procedurë, dy të tretat e deputetëve që janë në sallë. Në sallë janë 78 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 64 deputetë, 63 janë për. Atëherë e renditim në rendin e ditës sipas radhës që e ka rendi i ditës sot.

Atëherë kemi edhe një propozim tjetër nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, kërkesë për amendamentimin e rendit të ditës, shqyrtimi i vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asocimit në organizata joqeveritare. Më 7 nëntor 2018, Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi Projektligjin, nejtë këto histori. Vlen e njëjta procedurë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Atëherë, zonja Pantina e ka kërkuar fjalën për të sqaruar rëndësinë pse po kërkohet futja në rend të ditës. Zonja Pantina, e keni fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Ne, po ashtu kërkojmë që kjo pikë të renditet e 12-ta me radhë, pra menjëherë pasi të votohen marrëveshjet ndërkombëtare. Dhe pas kësaj, nëse është e mundur kemi edhe një kërkesë tjetër po ashtu për rend të ditës. A mund ta bëj tani, a po pasi të votohet kjo?

KRYESUESI: Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

73 deputetë kanë votuar, 721 vota janë për, 2 abstenime. Konstatohet propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, e përfaqësuar nga zonja Pantina. Zonja Pantina e ka edhe një propozim shtesë.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Ne po ashtu kërkojmë që të hiqet nga rendi i ditës për sot pika 23 dhe ajo të renditet në seancën e radhës nga Kryesia.

KRYESUESI: Na jep arsyetimin!

SHQIPE PANTINA: Sepse, deputetët të cilët do të prezantojnë dhe gjegjësisht do ta arsyetojnë ligjin nuk do të mund të jenë në seancë në kohën kur do të shqyrtohet rendi i ditës dhe po ashtu mund të mos ketë kuorum për t'u votuar ai.

KRYESUESI: Atëherë, zoti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Kërkesës së komisionit i shkon edhe lutja edhe kërkesa që të radhitet e para në rendin e pikave të ditës së sotme, ose së paku e 12-ta.

Duke e marrë parasysh numrin e madh të pikave, ekziston mundësia që të mos votohet sot, ndërkaq është e rëndësishme që të votohet ky ligj sot në lexim të dytë, për arsye se kjo agjenci mund të mbetet deficit për 2-3 milionë që janë donacion nga Bashkimi Evropian.

KRYESUESI: Në rregull, më duket kështu edhe u miratua sipas propozimit të mëparshëm. Tani, Memli a pate diçka tjetër? Ashtu është miratuar ajo nuk ka ndonjë ndryshim.

Sa i përket propozimit për pikën e 23-të. E hedh në votim mocionin e zonjës Pantina. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim, votojmë tash.

Atëherë, mbetet në rend të ditës siç ka qenë, për faktin që kanë votuar 59 deputetë. Po, zoti Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Një lutje zoti kryesues, duke u nisur edhe prej praktikave të mëhershme në këtë Kuvend. Kisha kërkuar nëse ka mundësi të vendoset edhe njëherë në votimin edhe kjo pikë që ka mundësi që për pak nuk kaloi dhe po ashtu ju kisha lutur edhe për pikën, kërkesën e Qeverisë për buxhet për muajin shkurt.

T'ju them të drejtën, pavarësisht qëndrimeve politike, një gjë që e kanë bërë të qartë Qeveria dhe ministri i Financave është që nëse nuk kalon buxheti deri më datën 1 shkurt, institucionet e Kosovës nuk mund ta shpenzojnë asnjë cent. Nuk do të ketë mundësi që të bëhet asgjë.

Mua ma merr mendja që ne do ta kalojmë buxhetin, por megjithatë për të qenë të sigurve kërkoj nëse mundet që të vendoset në votim edhe njëherë edhe ajo pikë edhe kjo pikë që patëm në fund. Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe ministri kërkon sqarim shtesë.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, nënkryetar! Faleminderit deputet, Memli Krasniqi!

Është ligji i cili e përcakton, muajin janar ka pasur mundësi që buxheti të shpenzohet me 1/12-tën.

Edhe në supozimin që buxheti kalon këtë javë apo në ditët në vijim deri sa të hip në fuqi, një pjesë e muajit shkurt mbetet e pambuluar. Dhe asnjë pagesë nuk mund të kryhet përveç pagesës së borxhit.

ALBULENA HAXHIU: ...prej 1 janarit!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Sipas teje, gjithmonë!

ALBULENA HAXHIU: Sipas ligjit!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Sipas ligjit të tregova unë. Kur të duash të tregoj prapë, po në këtë pjesën tjetër nuk jam duke folur për atë. Shko dhe pyeti ti?

Po unë po ju lus që të njëjtën ta vendosni në rend të ditës dhe ta votoni me qëllim që shtetit të ketë mundësi t'i kryej pagesat sipas ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, ju lus për vëmendje. Armend, a po dëshiron fjalën? Ke të drejtë se... Armend Zemaj e ka kërkuar fjalën në emër të grupit parlamentar. Meqenëse ia dhashë Memlit, edhe ju keni të drejtë të flisni.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti ministër, para se të na lutësh për votim, është dashur që t'ju shpjegoni deputetëve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës, pse për herë të parë e keni vendosur një standard i cili është i keq, që nuk e keni miratuar ligjin për vitin 2018, sipas viti kalendarik.

Kjo tregon gjendjen aktuale në vend, papërgjegjësinë e kësaj Qeverie dhe papërgjegjësinë e kësaj mazhorance duke imponuar edhe kushte të cilat nuk shkojnë në favor të interesave të qytetarëve të vendit. Andaj, lutja e juaj nuk është e arsyeshme.

Arsyeshmëria do të ishte nëse ju do të tregoni qartë, neve qytetarëve të vendit, pse Kosova nuk e ka të miratuar ligjin për buxhetin në fund të viti 2018?

KRYESUESI: Kërkoj që të ma pranoni këtë variant që nga një përfaqësues i grupeve parlamentare mund ta marrë fjalën në emër të grupit, dhe në fund ministri mund të përgjigjet për çështjet që i ngisni ju. Albulena ju dëshironi? Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Unë, jo rastësisht e përmenda në pyetjen time parlamentare çështjen e shfrytëzimit të Buxhetit për vitin 2019.

Jo vetëm që e kemi thënë ne, edhe organizatat e shoqërisë civile siç është KDI-jam ka bërë raport, hulumtim për këtë. Ka konsideruar që janë duke u shkelur procedurat, që është duke u shkelur Ligji për Menaxhimin e Financave Publike.

Neni 24, paragrafi 2 flet se vetëm Kuvendi e ka të drejtën që t'i zgjasë ndarjet buxhetore. Domethënë, ju zoti ministër jeni duke bërë shkelje. Fakti që deputetët e Kuvendit nuk e miratuan kërkesën e Komisionit për Buxhet dhe Financa, që u adresua nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, që në fakt është kërkesë e juaja, ky është debakël për ju.

Ju duhet të jepni dorëheqje, sepse nuk e keni legjitimitetin. Nuk i keni numrat. Pra, duhet të largoheni nga pozicionet që mbani. Vendi duhet të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme.

Prandaj, ne nuk do të përkrahim as buxhetin që është buxhet i asfaltit, e nuk do ta përkrahim as këtë propozim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kush e deshi tjetër fjalën? Zoti Sherfi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e mora fjalën që të jem i shkurtër. Pra, nuk mund të bëhet asnjë pagesë. Keni parasysh. Bëhet për pensionistët. Bëhet fjalë për ndihma sociale. Bëhet fjalë për pagat dhe bëhet fjalë për njerëzit të cilët kanë nevoja të ndryshme shëndetësore.

Pra, nuk po e bllokoni Qeverinë, po i bllokoni njerëzit të cilët kanë nevojë që t'i marrin këto pak mjete për muajin shkurt. Tash vendosni ju nëse dëshironi që t'i bllokoni edhe atë 75 euro të pensionistëve, apo edhe ato 50 apo 60 euro ndihma sociale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj, ju në emër të komisionit besoj se e keni? Zonja Hadërgjonaj, në emër të komisionit.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Unë desha vetëm sqaroj se shfrytëzimi i buxhetit për këtë muaj është tërësisht brenda dispozitive ligjore, sepse në rast se nuk miratohet buxheti në muajin dhjetor, Qeveria mund ta shfrytëzoj buxhetin për muajin e parë të viti fiskal. Ligji për Ndarjet Buxhetore i cili ka qenë në fuqi në vitin paraprak zgjatet për të mbuluar muajin e parë të vitit të ri fiskal dhe siguron një ndarje buxhetore për çdo organizatë buxhetore që është e barabartë me 8,33% të ndarjeve buxhetore.

Nëse ne miratojmë buxhetin nesër, se sot nuk e kemi në rend dite, kërkon kohë derisa të hyjë në fuqi. Domethënë i kërkon edhe dy javë, eventualisht tri derisa të hyjë në fuqi.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, unanimisht e ka përkrahur një kërkesë të tillë të cilën një propozim-vendim të tillë të cilin e ka sjellë Qeveria, nisur nga fakti se me datën 1 shkurt nuk ka mundësi që të bëhet asnjë pagesë. Nuk kam mundësi të paguhen as pensionistët, asnjë gjë.

Unë e sqarova në emër të komisionit për buxhet kur thashë që vetëm pagesa e borxhit të jashtëm mund të bëhet me ligj, asnjë pagesë tjetër. Prandaj, nuk është e ndërgjegjshme. Nuk është serioze dhe nuk është logjike për deputetët e këtij Kuvendi që të mos e miratojnë propozim-vendimin për zgjatjen e afatit të shfrytëzimit të buxhetit derisa buxheti të hyjë në fuqi.

Prandaj, i kisha lutur të gjithë deputetët të reflektojnë pozitivisht dhe ta japin votën pro propozimit të cilin e ka bërë Qeveria dhe e ka miratuar komisioni unanimisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tashmë janë paraqitur edhe shumë të tjerë. Ne u morëm vesh... Ne e bëmë për ligjin dhe replikat e hapin debatin. Ti s'ke grup zoti Islam. Jo, jo unë nuk po flas në emër të grupit po ta jap fjalën ty fol dhe pastaj ia jap Armendit. Por, është paraqitur tash edhe Glauku, edhe ti replika apo çfarë? Ju në emër të kujt folët? Në rregull.

Unë mendoj që ka vend për kritika, por mirë është që diskutohet edhe të votohet sepse është interes publik dhe jo interes yni fare. Zoti Memli Krasniqi e ka fjalën. Ose merreni Armend ju dhe kryejeni replikën që e pate. E kryejmë edhe kundër-replikën, pastaj shohim.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Siç duket po ka nevojë ndonjëherë edhe për sqarim për kolegët e pozitës. Është shumë e thjeshtë, ju jeni mazhorancë. Mazhorancë plus, votojeni.

Nuk e di pse akuzohet opozita, pse ligji i buxhetit nuk ka kaluar në vitin 2018, ashtu siç është e paraparë edhe me ligj. Tash, po na akuzoni neve, pse neve nuk po votojmë prapë. Ju nuk i keni kryer detyrat tuaja me nder dhe përgjegjësi ashtu siç po kërkonit dhe na drejtoni neve akuza që po i bllokojmë pensionistë etj., gjë që nuk është e vërtetë, nuk është e qëndrueshme.

Andaj, i keni votat. E keni mazhornacën, votojeni, urdhëroni. Ne e mbajmë pozicionin tonë opozitarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Memli Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju thatë në fillim që do ia jepni fjalën secilit përfaqësues, besoj që mbeta veç edhe unë prej grupeve parlamentare. Sidoqoftë, në kuptimin procedural neve na duhet të votojmë. Të dyja propozimet që dhashë mbeti që të hidhen edhe njëherë, atë që e ka bërë komisioni dhe po ashtu ajo që ishte në fund në rend të ditës.

Këta kanë të drejtë si opozitë që të mbajnë qëndrime çfarëdo qofshin politike. E drejtë e tyre është edhe tentojnë që ta çojnë vendin në kolaps, pavarësisht arsyetimeve që ata mund të japin.

Populli ynë e ka një fjalë të urtë shumë të mirë, kjo sjellje për “inati të resë më vdektë djali”, këtyre mund t’ju duket që u jep ndonjë shërbim politik ditë sot, por e vërteta është që në disa javë të ardhshme dhe pa paragjykim gjatë gjithë muajit, mos votimi nga ana e opozitës, qoftë pro e do duhej të ishte pro përkundër luftës politike, po qoftë kundër, është tentim i drejtpërdrejtë i hapur pa asnjë fije turpi që të vendoset Kosova në kolaps.

Nëse opozita dëshiron që ta shohë Kosovën në kolaps, siç edhe e thanë realisht, sepse unë i dëgjova që thanë, neve nuk na intereson, ne nuk do të marrim pjesë në votim. Atëherë, kjo është e drejtë e tyre, por le ta dinë qytetarët, le ta dinë të gjithë që qëndrimi i opozitës është që ky vend duhet të kolapsohet, sepse këta dëshirojnë që t’i japin një mesazh Qeverisë së koalicionit.

Në rregull, është e drejtë e tyre. Ka parti politike që janë në gjendje të bëjnë edhe më zi. Ka parti që janë në këtë Kuvend që janë përpjekur që ta shkatërrojnë këtë shtet totalisht, nuk e di a e njohin sot e kësaj dite që është shtet i pavarur.

Mund të mos i lejojnë institucionet, sepse nuk po flasim veç për Qeverinë, është tek e fundit kërkesë e komisionit të Kuvendit, por të paktën le të dihet kush në çfarë pozicioni është, edhe kush çfarë shërbimeve është duke i bërë këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Nëse për një gjë jam i sigurt se çka është duke e shkatërruar Kosovën është korrupsioni edhe hajnia. Keqqeverisja që po vazhdon edhe kësaj dite, duke shkuar deri te projektet për copëtimin e Kosovës.

Askund në botë nuk kam parë që një Qeveri të thotë: “Nëse opozita nuk na e voton vendimet, atëherë jeni kundër qetarëve të vendit”. Askund në botë nuk ka.

Çdo kund në botë Qeveria e ka një moral minimal, nuk mund ta paguaj popullin, ecë prej qeverisjes. Ditën e mirë! Nuk po mund ta paguash popullin, është Qeveri e cila nuk e ka kapacitetin elementar që t’ia japë rrogat njerëzve. Kjo Qeveri shkon në shtëpi kur nuk e ka kapacitetin që t’i paguaj njerëzit. Mos kërko ndihmë nga të tjerët.

Domethënë, unë po qëndroj në kolltukun e nxehtë, po e vazhdoj hajninë e keqqeverisjen, po ti ama votën për buxhetin. Ku ke dëgjuar kështu? Askund në botë nuk ka kesi Qeverie.

Pesë gram sikur t’i kishte moral, kjo Qeveri do duhej të thoshte se nuk po mund ta paguaj popullin, e provojmë një Qeveri tjetër e cila mund ta paguajë popullin. Po ti, edhe ma jep votën edhe më qëndro gatitu, edhe unë po e vazhdoj këtë avazin që e kam nisur me këtë buxhetin e asfaltit. Askund në botë nuk ka kështu.

Nuk ka vota për këtë buxhet. Ministër, nuk po funksionon kuleta, ecë në shtëpi. Kështu shkon gjithkund.

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit nga grupet parlamentare është Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Është interes i qytetarëve që të votohet, për, kundër, nuk ka problem, por të votohet dhe njëkohësisht me tregu që edhe ne kemi qenë në opozitë, por kur ka qenë interes i qytetarëve kemi votuar.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën sqaruese e ka ministri Hamza dhe vazhdojmë pastaj e votojmë ose s’e votojmë është çështje e juaja.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Ka edhe një situatë jo identike, por e ngjashme në vitin 2010 dhe 2011.

Vendi e ka filluar vitin 2011 pa buxhet të aprovuar në vitin 2010, sepse ka pasur zgjedhje. Në rast të tilla, dy muaj ditë ligji e lejon që buxheti të shfrytëzohet me automatizëm, ndërsa muajin e tretë kemi marrë vendin nga Kuvendi derisa është aprovuar buxheti.

Tash situata është ndryshe, nuk ka pasur zgjedhje dhe ligji e thotë që muajin e parë mund ta shfrytëzosh buxhetin, ndërkaq për muajin vijues duhet të merret vendimi prej Kuvendit, dhe

vendimi është proceduar në kohë nga Qeveria dhe është aprovuar në Komision për Buxhet dhe Financa.

Është obligim imi si ministër që t'i lus deputetët që ta votojnë. Është në autoritetin dhe në të drejtën e deputetëve a e votojnë apo nuk e votojnë.

A shkojmë prej shtëpisë a nuk shkojmë, edhe kur të vjen vakti që të shkojmë nami nuk bëhet. Kur të vjen akti shkojmë. Kanë shkuar deputetë dhe legjislatura edhe përpara, e do të shkojnë edhe prapa.

Por, edhe një çështje; në rast se është hipotetike nuk pres edhe nuk dëshiroj që të ndodh, por vjen situata që të shkojmë në zgjedhje pa buxhet të aprovuar, unë sot po them që as për organizimin e zgjedhjeve nuk ka para.

Mund të kesh bilanc bankar sa të duash, por të ndahen paratë për organizimin e zgjedhjeve pa vendim ose pa ligj nuk mundesh. Prandaj, unë po ju lus që të votohet edhe të ketë mundësi që vendi të vazhdojë me pagesa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka diskutime tjera. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim për ta kaluar ose jo propozimin për plotësimin e rendit të ditës së seancës plenare që është propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Përgatitemi për votim, votojmë tash. Kanë votuar 56 deputetë, në sallë janë 85. Është e njëjta situatë. Unë mund ta përsëris edhe njëherë edhe dy herë. E votojmë edhe atë edhe njëherë s'ka problem.

23. Shqyrtimi i parë i Projektligjet për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për financimin e subjekteve politike

E kemi votuar njëherë nuk pasur vota të mjaftueshme, votojmë edhe njëherë[nëse janë bërë votat, votojmë tash.

Konstatoj që me 60 vota që është votuar në mënyrë elektronike dhe 3 vota me dorë, janë 63 vota. 59 kanë votuar për në mënyrë elektronike, plus 3 vota me dorë bëjnë 62 vota, me 1 abstenim, kalon ky propozim dhe hiqet nga rendi i ditës Shqyrtimi i parë i Projektligjet për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03L-174 për financimin e subjekteve politike. Faleminderit!

Tani po hyjmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave të mbajtura më 14 dhe 15 dhjetor 2018? Nëse nuk ka vërejtje, konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave të mbajtura më 14 dhe 15 dhjetor 2018.

Dua të marr mendimin tuaj a doni të vazhdojmë me votime, është mirë që ta vazhdojmë punën me votime, pastaj të marrim pauzën.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark të Holandës (SPARK) mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica

Të nderuar deputetë,

Për këtë projektligj për ratifikim të marrëveshjes mungon raporti i Komisionit FunkSIONAL për Arsim.

Atëherë, shkojmë në votim.

Po, kryetari i komisionit, urdhëroni zoti Kurteshi!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Ky ligj duhet të tërhiqet, sepse nuk ka ardhur fare në komision, d.m.th. ka ardhur jashtë rendit, nuk ka mundësi sot të votohet, po ministri është këtu dhe ai e sqaron pse nuk e kanë sjellë në komision, po kjo nuk bën të votohet sot.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Atëherë, për shkak të rrethanave të reja të cilat janë krijuar në sigurimin e financimit të këtij institucioni të rëndësishëm, Qeveria e tërheq këtë ligj dhe nuk ka nevojë të futet në votim.

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj që Qeveria e ka tërhequr projektligjin.

5. Shqyrtimi i Projektligjit numër 06/L-136 për ratifikimin e Marrëveshjes për kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria Ag për projektin e sistemit për largimin e ujërave të zeza për komunën e Podujevës

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe ratifikimin e Marrëveshjes për kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria Ag për projektin e

sistemit për largimin e ujërave të zeza për komunën e Podujevës dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Financave, Bedri Hamza, që të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BEDRI HAMAZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministria e Financave, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës e ka nënshkruar më 24 shtator 2018 Marrëveshjen për kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria në vlerë prej 5 milionë e 349 mijë euro për financimin e projektit të trajtimit të ujërave të zeza në komunën e Podujevës.

Si jeni të njoftuar, në vitin 2012 Qeveria e Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave ka nënshkruar Marrëveshjen e parë për bashkëpunim financiar me Qeverinë e Republikës së Austrisë, të përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave.

Pasi që kjo Marrëveshje ka pasur afatin e shfrytëzimit të fondeve deri më 31 dhjetor 2016, kemi negociuar me Qeverinë e Austrisë zgjatjen e afatit dhe për dy vjet të tjera dhe kemi arritur që të negociojmë rritjen e shumës së kredisë.

Pas nënshkrimit në mënyrë që Marrëveshja e kredisë të jetë efektive, kërkohet ratifikim nga ana e Kuvendit të Kosovës, për çka po diskutojmë edhe sot.

Marrëveshja financiare, të cilën e kemi nënshkruar për projektin për komunën, ka një periudhë shlyerje prej 15,5 vjetësh, katër vjet mospagim, një normë e interesit zero dhe një përqindje si dhe reduktim i tarifave të garancisë dhe kosto të tjera të financimit.

Këto tarifa në total arrijnë vlerën prej 1,6, që do të thotë paguhet në baza vjetore të huazimit.

Prandaj, bazuar në rëndësinë e kësaj Marrëveshjeje, i lus deputetët e Kuvendit të Kosovës që të njëjtën ta përkrahin. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë jam i mendimit që këto formalitetet që i kemi t'i lexojë ai a ky, t'i lëmë krejt e t'i votojmë, sepse të gjithë e dimë a duhet t'i votojmë a jo, deputetët janë për këtë punë.

Përveç nëse dikush paraqitet dhe kundërshton diçka, atëherë mund ta marrë fjalën, siç është rasti tash i zonjës Nagavci. Zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Ne besojmë se është e rëndësishme të diskutohet për marrëveshje të tilla, sepse përkundër rëndësisë që këto kanë për qytetarët, e shpërfaqin edhe joseriozitetin e vetë qeverisjes, e cila derisa ka dërguar qindra miliona euro në asfaltim, nuk i ka pasur parasysh projektet shumë të rëndësishme për jetën e qytetarëve, sikurse që janë disa prej tyre që do t'i trajtojmë sot. Nuk ka asnjë planifikim të mirëfilltë dhe në këtë rast Lëvizja Vetëvendosje do t'i përkrahë këto marrëveshje, por duke ju bën me dije se do t'i monitorojmë nga afër për shkak të parregullsive të shumta dhe për shkak se kjo është hera e fundit që do të keni përkrahje për marrëveshje të tilla të paplanifikuara mirë dhe të cilat fatkeqësisht e shkelin edhe ligjin.

U përmend këtu që kostoja për kredi është 0,5% në vit, tarifë zotimi, që paguhet prej shumës së patërhequr të kredisë dhe 1,1% në vit për shumën e tërhequr të kredisë, por janë dy probleme thelbësore, të cilat duhet t'i përmendim.

E para, është baza ligjore. E kemi rastin ku kredia po merret nga Qeveria qendrore, ndërsa Qeveria lokale duhet të bëjë prokurimin. Dhe, të kemi parasysh se janë dy pushtete të ndara dhe nuk ka aspak logjikë që të organizohet në këtë mënyrë, sepse do të mund të ndodhte që, për shembull, Qeveria që e merr kredinë në këtë rast të kryente edhe procedurat e prokurimit ose anasjelltas, të dyja të bëhen nga niveli lokal, sepse edhe niveli lokal ka të drejtë të marrë kredi sipas ligjit

Dhe po ashtu është çështja e prokurimit, gjegjësisht e kostos së projektit, sepse prokurimi për këto projekte bëhet në kushte të veçanta, meqenëse sikurse që u përmend është marrëveshje ku parashihet që shumica e punimeve të kryhen nga kompani të huaja.

Dhe, si rezultat i këtij kufizimi kostoja e projektit është shumë më e lartë se sa ajo që duket dhe çfarëdo përfitimi që të ketë nga norma e ulët e interesit, humbjet nga kostoja e fryrë janë shumëfish më të mëdha.

Nëse shtojmë këtu edhe korrupsionin që është e zakonshme në secilin prej projekteve që po qeverisin nga kjo Qeveri, atëherë realisht kostoja është shumëfish më e lartë se sa kostoja reale.

Duhet përmendur edhe faktin se sa do që të jenë të mira kushtet e kredisë, ato mbeten kredi dhe bëhen për kompani, që edhe ashtu janë shumë të dobëta, siç janë kompanitë e ujësjellësit, kanalizimeve për t'i shlyer.

Edhe një fakt tjetër i rëndësishëm është se aktualisht nga shumë partnerë të Kosovës dhe donatorë ka mundësi për grante në këtë fushë, pra për mosmarrje të kredive, po për grate, madje plot nga partnerët e Kosovës aktualisht janë duke dhënë grante.

Dhe, unë dua të përmend këtu edhe rastin e Podujevës, ku për shembull, projekti i trajtimit e ujërave të zeza ka pasur stërzgjatje. Sigurisht e dini se puna në këtë projekt pikërisht për ujërat e zeza në komunë të Podujevës ka filluar në kohë të zgjedhjeve lokale, në tetor të vitit 2017, për të vazhduar puna vetëm një muaj dhe pastaj ka rifilluar prapë vetëm pas një viti, për t'u ndërprerë prapë pas një muaji në vitin 2018.

Përveç kësaj, pra stërzgjatje së punës, edhe cilësia e punëve aty është shumë e ulët dhe paraqet edhe rrezikshmëri, për shkak se fëmijët për të shkuar në shkollë në atë pjesë detyrohen të ecin në rrugë ku ka shembje të dheut.

Duhet përmendur edhe faktin që në Projektbuxhetin e vitit 2019 dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, po e përsëris edhe një herë, janë planifikuar qindra miliona euro për autostrada dhe, për më shumë, nëse kujtojmë vetëm pagesën e vlerës prej 53 milionë eurosh për Behtel&Enka-n, është shumë e qartë se ky buxhet nuk ka punuar për të përmirësuar të drejtat bazike të qytetarëve dhe për përmirësimin e sistemit të ujësjellësit, po merren nga 5 milionë euro kredi për këto marrëveshje.

Këto janë disa çështje që i konsiderojmë të rëndësishme, pra janë vërejtje tona dhe vetëm duke pasur parasysh se bëhet fjalë për të drejta bazike të qytetarëve, të cilat tashmë ishin dashur të plotësoheshin nga qeveritë gjatë gjithë këtyre mandateve. Ne do të votojmë kësaj radhe këto marrëveshje, me vërejtje që i thamë dhe me premtimin se do t'i monitorojmë me shumë kujdes realizimin e tyre.

KRYESUESI: Faleminderit! Sa deputetë i kemi në sallë? Ju lus që t'i zini vendet, sepse na duhet kuorumi.

Ju lus që t'i zëni vendet, po shpresoj që të gjithë jeni për t'i votuar marrëveshjet ndërkombëtare, kështu të paktën të gjithë jemi deklaruar. Zoti Ismajli, a do të ulesh të votosh. Në sallë janë 85 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani!

Faleminderit! Konstatoj që kanë votuar 87 deputetë, 87 vota janë për. Kuvendi miratoi Ligjin 06/L-136 për ratifikimin e Marrëveshjes për kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria Ag për projektin e sistemit për largimin e ujërave të zeza për komunën e Podujevës.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për protokollin shtesë 5 të Marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Unë nuk po kuptoj se këtu paska amendamente. Amendamente Parlamenti në Marrëveshje ndërkombëtare unë nuk e di se është praktikë, mendoj që nuk ka nevojë ato të votohen. Ne e votojmë marrëveshjen ose e hedhim si marrëveshje. Amendamentet Qeveria i ka shqyrtuar 100% të gjitha pikat dhe ne nuk mund ta përmirësojmë marrëveshjen tash të nënshkruar në mes të dy palëve.

Po mirë, këto dy amendamente a jeni t' i miratoni a jo?

A ka dikush kundër këtyre projekt-amendamenteve? Nuk ka. Konstatoj që miratohet.

Hyjmë në votim elektronik për marrëveshjen.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Nuk kanë votuar, e përsëris votimin edhe një herë. Votojmë tash!

Regjia, e përsërisim votimin. Votojmë tash!

Nuk kalon. I kemi 75 vota.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëfinancimin e bursave në nivel të studimeve master ndërmjet Ambasadës së Francës në Prishtinë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Konstatoj që me 87 vota për Kuvendi e miratoi Ligjin numër 06/L-139 për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëfinancimin e bursave në nivel të studimeve master ndërmjet Ambasadës së Francës në Prishtinë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Raiffeisen Bank International AG për projektin e ndërtimit të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm për komunën e Ferizajt

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Atëherë, a ka dikush kundër amendamentit apo e votojmë? Nuk ka kundër. Miratohet.

E votojmë ligjin në tërësi. Votojmë tani!

E përsëris edhe një herë votimin, për shkak se nuk kanë arritur të gjithë të votojnë. Ju lus për vëmendje, të nderuar deputetë, të gjithë jemi deklaruar se marrëveshjet ndërkombëtare do t'i votojmë, mos harroni të votoni, e di që keni qëndrim. Votojmë tani!

Faleminderit! 89 deputetë kanë votuar, 89 vota janë për. Konstatohet që Kuvendi e miratoi Ligjin numër 06/L-141 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Raiffeisen Bank International AG.

9. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG në lidhje me financimin e projektit për ndërtimin e sistemit të kanalizimit për komunën e Shtimes

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 91 deputetë, 91 deputetë janë për. Konstatohet që Kuvendi miratoi Ligjin numër 06/L-142 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG në lidhje me financimin e projektit për ndërtimin e sistemit të kanalizimit për komunën e Shtimes.

10. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG si huadhënës lidhur me financimin e projektit për ndërtimin e sistemit të furnizimit me ujë për komunën e Graçanicës

Kemi një amendament. A është dikush kundër? Nuk është! Miratohet!

Shkojmë në votim të ligjit në tërësi, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Faleminderit! Kanë votuar 89 deputetë, 86 për, 3 abstenime.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-143 për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë në mes të Republikës së Kosovës si huamarrës dhe UniCredit Bank Austria AG si huadhënës, lidhur me financimin e projektit për ndërtimin e sistemit të furnizimit të ujës në komunën e Graçanicës.

11. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG në lidhje me financimin e projektit për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit për komunën e Istogut

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin Nr. 06/L-144 për financimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG në lidhje me financimin e projektit për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit për komunën e Istogut dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 87 deputetë. 87 vota janë për. Konstatohet që Kuvendi e miratoi Ligjin Nr. 06/L-144 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria në lidhje me financimin e projektit për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit për komunën e Istogut.

Kemi votuar që të futet pikë e gjashtë, unë kaloj me kërkesë tuajën. Edhe një herë me kërkesë tuaj, kaloj në pikën e gjashtë në votim.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për protokollin shtesë 5 të Marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore

Janë dy amendamente, a ka kundër amendamenteve dikush. Zonja Sala Berisha ka diçka lidhur me amendamentet.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Shumë shkurt, amendamentet kanë të bëjnë me projektligjin, jo me ratifikimin e Marrëveshjes. Kemi pasur raste edhe më herët të tilla, janë të natyrës teknike dy amendamente. Nuk po i lexoj më tutje, veç kërkoj t'i votojë Kuvendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A ka kundër këtyre amendamenteve? Nuk është askush! Konstatohet që janë miratuar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani! Ju lus për vëmendje!

Kanë votuar 75 deputetë. 66 janë për. 9 abstenime. Asnjë kundër. Nuk kalon!

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale

Në qoftë se ju e shihni të arsyeshme, i kemi 40 amendamente, mund t'i votojmë të gjitha njëherazi. Asnjë s'është kundër, s'ka alternativë, në qoftë se e shihni të arsyeshme, në qoftë se jo, shkojmë.

Atëherë, komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin. Kemi 40 amendamente, i procedojmë në votim nga amendamenti 1 deri në amendamentin 40. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani!

Atëherë, kanë votuar 65 deputetë. 63 janë për. 2 abstenime. Konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale.

Atëherë, po kalojmë në pikën 12a:

12a. Shqyrtimi i vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare

Komisioni FunkSIONAL për Administratën Publike, Qeverisje Lokale dhe Media në bazë të nenit 61 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare dhe Kuvendit i ka rekomanduar të mos miratohet vendimi i Presidentit të Republikës.

Për nenet e datës 23. 11. 2018, për nenet 1.3, 15 pika 2, 16 pika 2, 17 pika 2, 18 pika 2, 37, 38 pika 3.4 dhe 5.4, 41 pika 1 dhe 1.2, 2 dhe 3, 47 pika 2 të Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputetin Nait Hasani, që të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandim. Zoti Hasani e keni fjalën!

NAIT HASANI: Përshëndetje!

Ne e kemi marrë një kërkesë ose një kthim të Ligjit të OJQ-ve nga Presidenti, që është në kundërshtim me vendimet e Kuvendit që i ka miratuar në Kuvendin e Kosovës. Ne kemi miratuar këtë projektligj me 60 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime. Organizatat joqeveritare kanë lobuar mjaft mirë për të mbrojtur bizneset kriminale të tyre dhe kanë kërkuar që Presidenti ta kthejë këtë ligj. Unë mund të filloj nga nenet, të cilat kanë kërkuar OJQ-të të prishet ky ligj, ata kanë kërkuar që të mos përgjigjen te noteri, të mos regjistrohen te noteri, sepse regjistrimi te noteri ata do t'i ndalojë nga keqpërdorimet. Kanë kërkuar te përkufizimet, të nenet që të trajtohen çka është organizatë joqeveritare vendore dhe çka nuk është organizatë.

Te neni tjetër, i 15-i, te neni 16 kanë kërkuar që shoqatat të jenë me nga 3 anëtarë, siç kanë qenë. Komisioni ynë kur e ka marrë si model projektligjin, e ka marrë modelin e ligjit gjerman. Ligji gjerman e përcakton sa do të jenë anëtarët e shoqatës për t'u regjistruar në ligjin gjerman, Gjermania po ashtu në Bashkimin Evropian është qendra e Evropës. Shoqatat tona duhet të jenë në Bashkimin Evropian, përkundrazi duan përfitimet t'i kenë në Kosovë, kështu që ato kërkojnë që të mos jenë pjesë e kësaj. Do të thotë që lobimet janë bërë për të mbrojtur bizneset e pista dhe këto e kanë arritur ta bindin administratën e Presidentit dhe administrata e Presidentit ka rënë në kurthin e këtyre organizatave joqeveritare, të cilat kanë bërë biznese dhe kanë arritur një biznes të shumëfishtë, rreth 70 milionë euro janë pjesë e konservuar aty, pjesë e pashfrytëzueshme që kanë mbërritur me kamata të ndryshme. Kamatat e shoqatave, të cilat thirren në bamirësi dhe ndihma humanitare kanë dhënë për zhvillim ekonomik kinse dhe ato zhvillimin ekonomik e kanë arritur duke krijuar biznese, duke krijuar profite të tyre dhe ky profit ka arritur në këtë shumën që sot është i bllokuar nga banka.

Prandaj, ata kanë kërkuar që të mos i përgjigjen as auditorit, do të thotë, të mos kenë asnjë llogaridhënie. Të gjitha këto janë pjesë e këtij ligji, që për mua është e padrejtë, Presidenti nuk ka treguar një gjendje të favorshme për këtë, kthimi i Presidentit është jo i arsyeshëm, jo i drejtë, prandaj unë po kërkoj që ky propozim i Presidentit të mos miratohet. Këtë e ka kërkuar edhe komisioni. Unë vlerësoj Presidentin në aktivitetin e tij politik, të mbrojtjes së interesave të qytetarëve, mbrojtjes së shtetit, të të gjitha vendimeve që janë në mbrojtje të zhvillimit ekonomik të vendit, por me këtë formën e mbrojtës të këtyre shoqatave, ai ka treguar ose e kanë nxjerrë në kurth administrata e tij. Unë mendoj që ky ligj nuk duhet të miratohet. Duhet të miratohet vendimi i Kuvendit që ka qenë me 60 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime.

Do të thotë që nuk kemi pasur vërejtje nga Komisioni për Buxhet, nga Komisioni për Ligje, nga Komisioni për Integritet Evropian, as nga Komisioni për Komunitete, kështu do të thotë që ligji është miratuar në mënyrë unanime në Kuvendin e Kosovës, prandaj Presidenti e ka kthyer në mënyrë të padrejtë. Por, padrejtësi edhe më e madhe është ku në këtë ligj administrata e Presidentit propozon si duhet të jetë ligji dhe kjo është shkelja e Kushtetutës, prandaj Presidenti ose administrata e tij e ka shkelur Kushtetutën, ku thotë se ky ligj e propozon, propozim për shqyrtim thotë, do të thotë ai ka mundur të kthejë nene të caktuara, por formën që e ka kthyer është e padrejtë, prandaj Presidenti ka bërë shkelje të Kushtetutës kur e ka kthyer në këtë formën për rishqyrtim.

Unë kërkoj që Kuvendi i Kosovës të mos e miratojë dhe ta lërë në fuqi Ligjin për OJQ-të që e ka miratuar komisioni që është i barasvlershëm dhe është në harmoni me Ligjin e Gjermanisë për Organizatat Joqeveritare, të cilët janë pjesë e shoqërisë dhe e zhvillimit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë kërkoj për vëmendje, nganjëherë po lodhemi e po bëjmë lëshime, unë harrova më herët, në fakt, u habita, nuk e nxora në votim në tërësi ligjin pasi i

votuam amendamentet, ju kisha lutur që ta votojmë vetëm formalisht në tërësi Projektligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash, dhe vazhdojmë me diskutimet e tjera.

Faleminderit! Me 75 vota për, 2 kundër, 2 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/ L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa i përket propozimit të Presidentit dhe ekspozesë që dha kryetari i komisionit, zoti Nait Hasani, e hap diskutimin. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, nënkryetar!

Fillimisht, dua të tërheq votën për votimin paraprak, sepse nuk e përmendët për cilin ligj, kërkoj falje, por nuk e dita për cilin ligj, kështu që po e tërheq. E dyta, ajo çka i mungoi zotit Nait Hasani dhe u mundua ta justifikojë e la përshtypjen, të paktën te ne, që zoti Hasani është marrë vesh me Presidentin, që Presidenti ta kthejë ligjin, por në fakt, të mos votohet kërkesa e Presidentit për kthimin e ligjit.

Çështja thelbësore e këtij ligji dhe kundërshtimit që po e bën shoqëria civile është për shkak të Organizatave Joqeveritare në fushën e mikrofinancave, ky është kundërshtimi dhe kjo nuk u përmend asnjëherë. Ju e dini shumë mirë që edhe në mandatin 2010 - 2013 është munduar të bëhet diçka e tillë që këtyre organizatave mikrofinanca t'u mundësohet shndërrimi në shoqëri aksionare. Pyetja që nga atëherë është që kush të jetë pronar i këtyre aksioneve? Asnjëherë Banka Qendrore as e atëherë e as sot nuk ka pasur mundësi të japë përgjigje se kush do të bëhet pronar i aksioneve dhe kapitalit që llogaritet të jetë rreth 160 milionë euro, të shoqatave mikrofinanciare.

Nëse është marrë për model Ligji i Gjermanisë për lirinë e asocimit, po mund të merret për model për krejt shoqërinë civile, por jo për organizatat mikrofinanciare, sepse nuk ka institucione në Gjermani që kanë afaruar që 20 vjet si mikrofinanca, me kamatë 28% dhe sot duan të shndërrohen në shoqëri aksionare. Unë u bëj thirrje krejt deputetëve që ta votojmë kërkesën e Presidentit, se siç po duket, këtu është një marrëveshje në mes të Presidentit dhe PDK-së që kjo të mos votohet. Është çuar vetëm sa për të ruajtur fytyrën e Presidentit përballë donatorëve dhe përballë shoqërisë civile.

Ju lutem shumë, nëse ne votojmë kundër kërkesës së Presidentit, ne po e mbysim sektorin e shoqërisë civile, i cili sot komplet varet prej donatorëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nait Hasani, replikë! Zoti Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Për herë të parë po e shoh që LDK-ja e mbështet Presidentin, që për mua është sinjifikative, sigurisht që këta do ta realizojnë ndoshta ndonjë koalicion të ardhshëm, por megjithatë e them që me Presidentin asnjëherë nuk është diskutuar për këtë çështje. Prandaj, çështja e mikrofinancave është diskutuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa, është trajtuar përmes Guvernatorit, të Ministrisë të Financave dhe të Komisioneve që kanë qenë aty, të financave dhe për administratë, është kërkuar pikërisht ajo shumë e cila nuk është shumë. Ato janë diku 70 milionë pjesë e kredive, ndërsa 70 milionë pjesa e mbetur aty e trajtimit. Ne nuk i kemi trajtuar mikrofinancat.

Ne i kemi trajtuar me Ligjin për OJQ-të, organizatat joqeveritare të cilat janë joprofitabile dhe të cilat janë të regjistruara profitabile. Prandaj, me këtë ligj ne po kërkojmë që t'i mbrojmë OJQ-të, të cilat në formën e regjistrimit do t'i përgjigjen noterit, do t'i përgjigjen auditorit, do t'i përgjigjen ligjit i cili do t'i mbrojë formën e tyre joaktive ose joqeverisëse. Prandaj, si ligji ose edhe Kushtetuta e thotë, neni 41 që ato janë të lira të veprojnë, të lira të regjistrohen, prandaj po kërkoj që Ligji që e ka kthyer Presidenti mos të votohet se ai është pikërisht në kundërshtim me natyrën e Kushtetutës, me natyrën e ligjit dhe formën ose modelin gjerman të OJQ-ve.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju lus për qetësi! Zonja dhe zotërinj deputetë, ju lus për qetësi!

MEMLI KRASNIQI: Njëfarë entuziazmi, s'di çka i gjet tash deputetët. A u krye seanca, a shpalle pauzë, a çka u bë? Se po shoh diçka njëfarë sëkëlldie. A po ktheheni a po shkoni ju Komisioni, çka e keni në mend shkoni kryeni punë. Na lini neve të vazhdojmë seancën. Hajdar, shko vazhdojeni ju.

Faleminderit! Unë po shpreh qëndrimin zyrtar të GP të Partisë Demokratike të Kosovës, i cili është marrë pas konsultimeve me palët e interesit dhe ne i mbështesim rekomandimet e Presidentit. Nuk besoj që habitet ndokush pse po i mbështesim ne. Sot do të duhej të ishte një moment festimi që edhe partitë e opozitës do ta mbështesin rekomandimin e Presidentit. Dhe arsyeja kryesore pse e mbështesim këtë nuk ka të bëjë me arsyetimet apo që i ka dhënë Komisioni apo edhe zoti Hasani, i cili është koleg yni, por ka pikërisht të bëjë me rrezikun tashmë të konfirmuar nëse nuk ndryshohen dispozitat përkatëse të ligjit për keqpërdorimet që mund të ndodhin në sektorin mikrofinanciar. Kjo është temë të cilën e kemi trajtuar edhe në Qeverinë e kaluar. Fatkeqësisht ky Kuvend as në mandatin e kaluar, e deri tash as në këtë legjislaturë, nuk ka arritur të miratojë një legjislacion që i rregullon ashtu si duhet institucionet mikrofinanciare, kapitali që u përmend nga deputetja Bajrami ndoshta edhe i ka tejkaluar atë shumë, por edhe nëse jo, edhe sikur të ishte më pak, është shumë tejet e madhe dhe rreziku është

që nëpërmjet interpretimeve të ligjit siç është aktualisht, ky kapital mund të tjetërsohet në mënyrë kriminale dhe të kalojë në duar të atyre që s'iu takon.

Për aq kohë sa nuk rregullohet çështja e institucioneve mikrofinanciare, të cilat funksionojnë në Kosovë si organizata joqeveritare, e që në të vërtetë nuk janë të tilla, rreziku për atë që e thashë është evident, dhe kjo është arsyeja që ne si grup parlamentar do të votojmë pro rekomandimeve të Presidentit që nënkupton inkorporimin e tyre dhe përmirësimin pikërisht në ato pika që janë specifikuar në dokument. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca, në emër të GP Vetëvendosje.

GLAUK KONJUFCA: Desha të them që së pari është e papranueshme gjuha e deputetëve gjeneralizuese për inkriminimin e shoqërisë civile, sektorit të shoqërisë civile. Për gjithçka që kemi fakte, duhet t'i prezantojmë ato. Për rast të veçanta, ku edhe mund të ndodhë krimi në ndonjë organizatë të shoqërisë civile, ama gjeneralizimi i gjuhës, të thuhet sektori i kriminalizuar i shoqërisë civile, pa ofruar argumente kush, qysh, cili emër, kush ka keqpërdorur, mendoj se është shumë i dëmshëm për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kështu që ftoj për një gjuhë më të kujdesshme kur flasim për shoqërinë civile në Kosovë.

E dyta, pse Presidenti? Presidenti për shkak që shoqëria civile edhe ato organizatat të cilat janë bashkuar për të prezantuar problemin, nuk kanë shkuar për qejf të Presidenti. Kanë shkuar për arsye që ne si Kuvend i kemi huq të gjitha rastet, edhe në lexim të dytë, për t'i sjellë këto ndryshime dhe ka mbetur versioni të cilin po e prezanton Kryetari i Komisionit. Ky version ashtu siç u argumentua, për institucionet mikrofinanciare përmban formulime të cilat mund të qojnë në keqpërdorimin e fondeve të institucioneve mikrofinanciare, thjesht ato mund të tjetërsohen dhe të bëhen fonde private. Ju e dini që ato janë dhënë si fonde prej organizatave të ndryshme për zhvillimin e Kosovës, për qëllime publike dhe shoqërore dhe formulimet të cilat i ka bërë Komisioni, e që po i prezanton Naiti, këto lejojnë, në njëfarë mënyre e lënë të hapur derën për keqpërdorim të këtyre dhjetëra milionave, disa po thonë edhe 150 milionë apo 160 milionë.

Kështu sot, organizatat e shoqërisë civile të cilat e kanë identifikuar këtë problem, nuk kanë pasur rrugë tjetër pos të shkojnë përmes instrumentit të fundit që është t'ia paraqesë versionet dhe formulimet Presidenti, e Presidenti ato formulime të gatshme t'i kthejë në Kuvend. Këto nuk janë formulime të Presidentit qysh po mendoni ju që i ka shkruar Hashim Thaçi. Këto i ka shkruar shoqëria civile dhe ia ka dërguar këto amendamente si mekanizëm i fundit Presidentit, që Presidenti t'i sjellë në Kuvend, e ne t'i votojmë.

Tash, është e vërtetë që ekziston një debat sa i përket dilemave a është kjo njëfarë procedure e rregullt, edhe mos po e shkelim ne vetë ligjin dhe Kushtetutën si Kuvend, duke votuar në këto

mënyra. Ne i kemi konsultuar ekspertët dhe ekspertët na kanë thënë që ekziston precedenti, që paska qenë edhe me zonjën Jahjaga kur ka sjellë rekomandime në Kuvend dhe janë votuar ato.

Tjetra, ekziston edhe një vendim i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2014, i cili e sqaron shumë mirë këtë punën e institucioneve mikrofinanciare dhe çfarëdo përpjekje si të paligjshme dhe antikushtetuese siç është kjo e cila e propozoi Naiti. E keni opinionin e Gjykatës Kushtetuese. Ne nuk ka nevojë fort të diskutojmë se a po bëjmë shkelje, a nuk po bëjmë shkelje. Është ai vendim i Gjykatës Kushtetuese, i cili në një përpjekje të mëhershme bash si kjo që po e prezanton Naiti. Gjykata Kushtetuese ka thënë që është shkelje. Kështu që shpresoj t'i referohemi edhe atij, edhe ne po e kuptojmë që kemi ardhur në këtë gjendje për shkak se jemi vonuar në disa procedura të mëhershme, që këto ndryshime t'i bëjmë në Kuvend. Meqenëse kanë dështuar të gjitha këto, është ky mekanizmi i fundit që shoqëria civile i ka dërguar te Presidenti, Presidenti i ka kthyer në Kuvend dhe shpresoj që këto të votohen, për t'i mbyllur rrugët atyre keqpërdorimeve për të cilat folëm.

KRYEUESI: Faleminderit! Zonja Shqipe Pantina. A do replikë Nait, në rregull. Naiti, replikë!

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

E falënderoj edhe një herë Galukun, por nëse është shkelje që një OJQ të regjistrohet te noteri, nuk besoj që gjermanët kanë gabuar në këtë drejtim. Nëse është shkelje e ligjit gjerman që një shoqatë ose një OJQ t'i ketë shtatë anëtarë, nuk besoj që është një shkelje, se sigurisht se ata e kanë tejkaluar. Ligji i Gjermanisë për OJQ-të është mbi 100 vjet i pandryshuar, sepse atje funksionojnë, por atë që po kërkon Glauku, po kërkon ta lë në Kosovë pastrimin e parave. Prandaj, OJQ-të kërkojnë të lejohet ende pastrimi i parave dhe bujqit dhe ata fermerët të cilët iu kanë dhënë disa OJQ; jo krejt s'po themi, se në Kosovë janë dhjetë mijë OJQ. Në komision, i kemi thirrur 60 dhe i janë përgjigjur vetëm gjashtë, të cilët janë përfaqësuar ose kanë thënë që jemi përfaqësues të të gjitha OJQ-ve.

Për mua është e paqartë prezantimi i të gjithë amendamenteve që i ka bërë Zyra e Presidentit dhe i ka kthyer në Kuvend. Kjo është shkelje, shkelja e Kushtetutës. Ky ligj nëse nuk pajtoheni, doni ta lini këtë gjendje që e kemi pasur deri më tash, lëreni. Lëreni mikrofinancat. Komisioni për Buxhet, Banka, Ministria e Financave, ato janë marrë me këtë çështjen e mikrofinancave. Ne nuk jemi marrë me çështjen e mikrofinancave. Ne nuk kemi kërkuar mikrofinanca, askujt t'ia falim apo t'ia tjetërsojmë, por ne kemi kërkuar që ky ligj t'i regjistrojë OJQ-të që nga fillimi, ose janë profitabile, ose joprofitabile. Pasuria e tyre e bartur e mbetur ku do të bartet. Kemi thënë edhe bashkë në Komision, të bartet te organizatat humanitare që mund të ndërtohen spitale, çerdhe, shkolla etj., të cilat janë në shërbim të interesit të publikut.

KRYEUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Konjufca!

GLAUK KONJUFCA: Naiti po i përzien qëllimisht po mendoj, jo pahiri, dy çështje. Unë nuk kam problem me këtë pjesën a regjistrohen te noteri a nuk regjistrohen te noteri. Unë nuk kam problem me atë pjesën a janë tre, a janë katër, a janë pesë a shtatë, a qysh e ka Gjermania e qysh e kanë të tjerët. Unë po i shkoj ligjit në thelb, edhe për çka shoqëria civile ka kundërshtuar. Ajo ka kundërshtuar për shkak që e ke lënë derën çel që fondet e mikrofinancave të privatizohen. Aty në ligj shkruan: mund të përdoren dhe të transformohen edhe nga institucionet e tjera. Qysh janë institucionet e tjera, a mund të jenë edhe private institucionet e tjera nëse nuk ua jep mbiemrin? Natyrisht që mundet. Edhe për 24 orë, ato 150 milionë euro njerëzit i qesin në konto të vetat.

Në momentin që votohet versioni që e ka propozuar Nait Hasani, menjëherë këtu do të ketë milionerë të rinj që kanë për të lindur.

KRYEUESI: Faleminderit! Zonja Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Ne debate të tilla kemi pasur edhe në Komision. Sa për ta sqaruar vota në Komision ka qenë 5 për propozimin e kryetarit dhe 4 kundër dhe unë nuk dua të gjykoj kolegët e mi që kanë votuar për propozimin e kryetarit, por përshtypja ime është se nuk i kanë pasur informatat e mjaftueshme. Prandaj mua më vjen mirë që deputetët sot po diskutojnë. Tashmë nuk jam zëri i vetëm që lloboj. Unë krejt çka ju kisha lutur, është t'i hidhni në votim propozimin, rekomandimin që ka ardhur nga Zyra e Presidentit. Ai edhe ligjërisht, edhe proceduralisht është krejt në rregull dhe ne të gjithë duhet të votojmë për atë rekomandim nëse nuk duam ta shkelim qëllimisht Kushtetutën.

Pra unë ju ftoj që ta hedhim në votim dhe t'i votojmë rekomandimet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Z. Gani Dreshaj e ka fjalën. Replikë edhe një herë z. Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit edhe prej Shqipes që është zëri i OJQ-ve brenda Kuvendit. Ka qenë pjesë aty kur është votuar në Komision modeli gjerman i ligjit, dhe e kanë kundërshtuar ku iu ka konvencuar se e kanë llogaritur se pastaj mund të jenë pjesë e OJQ-ve papë.

Kështu që të njëjtën gjë e ka bërë atëherë dhe të njëjtën e bën tash edhe për Ligjin e pagave. Kjo është çështje e politikës së tyre, prandaj një politikë e tillë që e bëjnë sot Shqipja dhe Glauku në këtë rast për mikrofinancat është çështje absurde. Këta duan të lejojnë pastrimin e parave, prandaj le t'u mbetet në ndërgjegjen e tyre.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dreshaj e ka fjalën.

GANI DRESHAJ: Faleminderit!

Unë vetëm di t'iu tregoj prej përvojave që edhe në shtetet ku funksionojnë ligji, OJQ-të janë mjet i pastrimit të parave. Në Kosovë, e kanë gërryer Kosovën. Si ka mundësi një OJQ që është për bamirësi, të ketë para rezervë në konto. Si patën ata mundësi t'i bëjnë 150 milionë? Po e shoh që paskan lobuar shumë, qoftë nga opozita, qoftë edhe pak nga pozita, por është e detyrueshme çdo OJQ të ketë përgjegjës, si një organizatë SHPK, edhe lekët si po thotë Glauku, jepen e bëhen milionerë, aty s'është në livadh të babës, se ka shtet, ato duhet të shihen. Nëse paratë e OJQ-së tërhiqen, duhet dikush të shkojë në burg. Po edhe këto mikrofinancat që janë bërë si kërpudhat, s'di ku keni parë ju mikrofinanca. Bëni dikush pastaj 200 milionë, 100 milionë çeleni një bankë. Të futen në ligj, duhet kapur ligjin, duhet të arsyetohet, të bëjë bilancin përfundimtar të fundit të vitit, ku i ka çuar ai ato para, ku i ka marrë, se dikush mbaroi duke punuar, dikush po bëhet brenda natës milionerë, edhe kur po vijjnë këtu në Parlament, po i flladitim.

D.m.th. ka dikush interes të mbrojtë atë hajni. Faleminderit! Faleminderit kryetar i Komisionit që po reagon gjithmonë kah e drejta. S'ma merr mendja që Presidenti e ka kuptuar kush e ka merituar këtu.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Së pari kisha propozuar të bëhet një komision hetimor parlamentar dhe të shikohet libri protokollar i Presidentit Thaçi kush shkon në ora 8 te ai, kush në ora 10, kush takohet ditën e kush takohet natën, e tani vijjnë këtu në këmbë të para e të mbrama e duan ta shajnë Presidentin, duan përmes Presidentit Thaçi të fitojnë vota edhe të Kuvendit, edhe vota të votuesve.

Besoj që i ka vdekur nëna këtij vendi, me një brez të internetit që janë 18 breza, 18 gjenerata të pasluftës, që dikush ka për të na dhënë vota duke e sharë Presidentin, ose duke u thirre në përralla patriotike, duke treguar hipokrizi politike. Kjo qe e para. Shkoni shkoni kush pret në rend për të hyrë te Presidenti. Unë shkoj ndonjëherë të pi kafe e duke dalë i shikoj deputetët e shumicës së partive parlamentare që presin aty duke u cacitur para Presidentit të hyjnë të pinë kafe te ai. Një ditë kam për të folur me emra.

E dyta, për mua është krenari që Parlamenti i Kosovës të ketë deputetë të kalibrit të Nait Hasanit i cili nuk mendon te vota e OJQ-ve, po mendon te ardhmëria e fëmijëve tanë. Këto OJQ, jo të gjitha, po këto institucionet mikrofinanciare janë fajdexhi. Shkon prokurorja e arreston policin për 200 gramë djathë, shkon prokurorja e arreston një njeri që ia jep dikujt 5 euro, e prokurori e prokurorët e shtetit, e politikanët deputetë që janë të përzier në institucione mikrofinanciare e dinë që këta janë fajdexhinj kriminelë që ia kanë dhënë bujkut 3 mijë euro hua e ia kanë marrë 28 për qind fajde kamatë.

Hajde le të qohet një deputet e të thotë a ka organizatë joqeveritare në botë që jep para me fajde pos në Kosovë. Kush e ka bërë një gjë të tillë. Njëherë na kanë thënë disa ndërkombëtarë pse po i lejoni këto, pastaj ngadalë se po na hyjnë paratë e terrorizmit këtu. Jo ngadalë se paratë e terrorizmit janë bërë këto OJQ. Prandaj, mbi bazën e kësaj, ne fort mirë në Komision e kemi diskutuar, e kemi analizuar, e kemi shqyrtuar edhe me Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe i kemi marrë rekomandimet e tyre, po edhe me ministrin Bedri Hamza, po edhe me Guvernatorin e Bankës Qendrore dhe të gjithë kemi ardhur në përfundim që vetëm një habi duhet shprehur çdo qytetar dhe çdo deputet, si ka mundësi që prokurorët e këtij vendi nuk i kanë arrestuar këta fajdexhinj dhe këta matrapazë.

Kush ka këtu biznese me këto kompani dhe me kompani të tjera, atëherë i ngelet prapë prokurori të dalë dhe ta bëjë të ditur këtë. Unë personalisht po flas si deputet, jo si Nismë, se kolegët e mi do ta kenë në mënyrë absolute të drejtën e tyre për votë. Unë e mbështes vetëm ligjin i cili ka kaluar ligj që është bazuar kryekëput në ligjin gjerman. Unë nuk flas këtu për vota. Kurrë në jetë mos e pafsha votën e fajdexhiut shqiptar, kurrë mos pafsha votë të mësuesi që e ka rrogën 600 euro e i lë fëmijët të terrorizohen nëpër shtëpi, kurrë mos pafsha votë të profesorit universitar që i merr deri 8 mijë euro rrogë mujore nga buxheti i shtetit edhe del e flet për greva, mos pafsha votë të atij mjeku që i lë pacientët nëpër klinika e punon 7-8 klinika e merr rrogën 10 mijë euro. Unë nuk flas këtu për vota, sikur Parlament ta shohë vetëm përmes ekranit televiziv. Unë kam çka bëj edhe në rast se nuk jam deputet, prandaj nuk votoj këtu fajdexhinj, nuk votoj kriminelë që ia kanë ngrënë palcën kurrizore bujkut të Kosovës me 28 deri 35% fajde. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami e ka fjalën. E keni pasur ju fjalën...

HYKMETE BAJRAMI: E kam pasur po desha për replikë e kam dashur...Të lutem shumë zoti nënkryetar, të lutem shumë!

KRYESUESI: Në rregull, dy minuta!

HYKMETE BAJRAMI: Kështu është fjala, e para, organizatat joqeveritare të cilat janë kundër, zoti Zeka nuk janë mirkofinancat, janë të gjitha OJQ-të të cilat nuk janë në kategorinë e mirkofinacave ato që po e kundërshtojnë ligjin.

Parimi kryesor i ekzistimit të shoqërisë civile, organizatave joqeveritare është që me rastin e shuarjes së një organizate joqeveritare të mos tjetërsohet kapitali, të mos shfrytëzohet ai për ndonjë qëllim tjetër.

Ky ligj ka lënë derën hapur që mirkofinancat të shndërrohen në shoqëri aksionare.

LDK-ja e përkrah kërkesën e Presidentit, sepse është kërkesë e shoqërisë civile dhe jo pse ka ardhur prej Hashim Thaçit. Ta ndajmë këtu shapin prej sheqerit dhe të mos bëjmë dezinformata të tilla tek opinioni.

Jemi në përkrahje të shoqërisë civile dhe dëshirojmë që çështja e mikrofinancave të zgjidhet me një ligj të veçantë ose me Ligjin për Bankën Qendrore të Kosovës, ligjin për bankat, dhe jo të kontrabandohen ata përmes Ligjit për Lirinë e Asociimit. Kjo është çështja.

KRYESUESI: Nuk ka të tjerë të paraqitur. Replikë, s'ta ka përmendur emrin! Po, në rregull, replikë. Milaim Zeka, replikë!

MILAIM ZEKA: Nënkryetar, unë kam qenë edhe jam mbrojtës i shoqërisë civile, po këtu nuk kemi të bëjmë me shoqëri civile, po me mafi e cila ngjyroset me emrin e shoqërisë civile.

Deputetja parafolëse vetë tha se organizatat mikrofinanciare e kanë kundërshtuar këtë ligj.

E kanë kundërshtuar. 9 800 OJQ i kemi në Kosovë, të cilat janë bërë me halla me teze me kushërira, me dada me dadushe. Krejt i kanë ngrënë paratë në emër të shoqërisë civile dhe shumica prej këtyre janë njerëz të korrumpuar.

Ne e kemi bërë ligjin që t'i fusim brenda ligjit, në mënyrë që të kenë të drejtë regjistrimi, të shkojnë te noteri. Kush e ka lexuar ligjin, e di që pikërisht krejt OJQ-të të cilat janë brenda kornizave ligjore, nuk dëmtohem me këtë ligj.

Me këtë ligj dëmtohen vetëm keqpërdoruesit të cilët marrin para për ndërtimin e një kishe ose të një xhamia dhe i blejnë vetës vilë. Ne e dimë që shumë organizata joqeveritare në emrin e zhvillimit të medimeve janë bërë milionerë në këtë vend, ndërsa gazetarët e Kosovës rrugën minimale e kanë 150-200 euro.

KRYESUESI: Zoti Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Ne e që e njohim më sipërfaqësisht sistemin ekonomin dhe sistemin bankar dhe mikrofinanciar, ne jemi të hetuar tash prej dy qëndrimeve krejt të kundërta. Dhe që të mos mbetet vota jonë vetëm në intuitën e asaj që mënyrë hipotetike të konstatojmë që kemi të drejtë apo nuk kemi të drejtë, duhet ta votojmë apo nuk duhet ta votojmë, unë besoj që Kuvendi ka financa po ka edhe arsye për një ekspertizë shtesë për këtë ligj nga ekspertët. Ekspertëve që janë jo vetëm të kësaj fushe, po edhe të fushës juridike edhe të fushës financiare dhe të shtyhet votimi i këtij ligji, sepse përndryshe po i bie që ne po votojmë me një hamendje të lirë tash.

Ne nuk mund të përcaktohem i ose disa prej nesh nuk mund të përcaktohen se a kemi të drejtë apo nuk kemi të drejtë edhe apo i ndërpreme vijat e keqpërdorimeve në Kosovë në këtë drejtim apo po e mundësojmë zhvillimin e keqpërdorimeve me këto organizata ose me disa organizata joqeveritare, më mirë të themi apo mikrofinanciare.

Unë propozoj edhe i kisha lutur deputetët që të na përkrahin në këtë drejtim.

KRYESUESI: Ne nuk kemi kuorum për të votuar. Duke e pasur parasysh... Muharrem, a dëshironi edhe ju që të flitni? Zoti Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Është një fjali, nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, po duket që argumentimi pro dhe kundër vendimit të presidentit është bukur i ngatërruar, shumë i paqartë.

Argumentet janë të njëjta, por sulmet janë të kundërta dhe unë e mbështesë plotësisht propozimin e zotirt Xhelili. Na jepni mundësinë që ta krijojmë një ide se çka është kjo punë mos detyroni për shembull që të votojmë si macen në thes, nuk e kemi idenë.

Ajo që e thotë zoti Hasani është bindëse. E kam përshtypjen që zoti Zeka i ka ngatërruar pak a shumë argumentimet e veta. Është bukur problem. Kështu që ta shtymë në mënyrë që ta marrim një vendim që na ka hije si deputetë të Kuvendit të Kosovës. Faleminderit! Dhe propozoj që të shkojmë në pauzë tashti, sepse edhe ashtu shumica e deputetëve tashmë kanë dalë.

KRYESUESI: Zonja Hadërgjonaj edhe ju jeni paraqitur.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Më shtyri ta marrë fjalën diskutimi i Fatmir Xhelilit. Edhe unë pajtohem që të shtyhet dhe të kërkojmë edhe një ekspertizë shtesë.

Ne jemi dëshmitar të një realiteti që sa herë që diskutohet për mikrofinancat në Kuvend, Kuvendi elektrizohet, deputetët reagojnë, janë tepër të elektrizuar. Shoqëria civile reagon. Mikrofinancat heshtin nuk bëjnë zë. Mirëpo, është një problem të cilit duhet gjetur zgjidhja.

Zonja Bajrami, diskuton tash e shtatë vite në lidhje me mikrofinancat. Ka qenë reaguese e madhe edhe në vitin 2012, dhe sot prapë reagon dhe asnjëherë gjatë këtyre viteve nuk e kam paraqitur një alternativë sesi ta gjemë një zgjidhje të funksionimit të mikrofinancave.

Ne e kemi në Kuvend Ligjin për Mikrofinancat, e rregullon problematikën e mikrofinancave që regjistrohen tani e tutje. Po a ka logjikë që ët njëjtat mikrofinanca të funksionojnë si mikrofinanca OJQ me status të beneficuar, të mos paguajnë tatim dhe asgjë tjetër. Të krijojnë profit. Të grumbullojnë profit dhe të funksionojnë mikrofinancat të rregulluar në formë të ligjit në një formë tjetër.

Prandaj, ne jemi të kolapsuar në Kuvend, sepse nuk mund të gjemë zgjidhe. Ngase deputetët elektrizohen, kanë interesa. Mikrofinancat kanë mjete, kanë financa. OJQ-të reagojnë, nuk e di pse reagojnë se ato nuk janë mikrofinanca ato që reagojnë, po i kanë sigurisht interesat e tyre. Prandaj, edhe unë pajtohem që ta shtyjme këtë pikë të rendit të ditës. Ta analizojmë pak me më kujdes, sepse nuk është çështje e lehtë për t'u zgjidhur, dhe është një problem jashtëzakonisht i madh i cili kërkon zgjidhje., nëse ne mendojmë ta kemi një shtet funksional, shtet të parakuptuar dhe shtet i cili bazohet në rregullat e ligjit. Mirëpo, ligji duhet të bëhet ligj dhe ligj që nuk lejon korrupsion dhe veprime të liga brenda këtij vendi.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë nuk e di që ka ligj në Kosovë që e lejon korrupsionin. Ata që merren me korrupsion e janë të korruptuar kanë krijuar ligje të përshtatshme për t'u korruptuar. Vetëm një sekondë! Problemi është, unë nuk e besoj që këto çka janë këto mikrofinanca, këto fare bankave që u japin para me sa përqindje nuk e di.

Këto janë regjistruar në bazë të një ligji dhe janë në bazë të një buxheti a të huazuar apo të sjellë nga jashtë dhe janë degë me sa e di unë, për dy e di, njëra është e Suedisë tjetra është nga SHBA.

Këtu bazohemi në mundësinë e atyre që ta godasin Kosovën.

Nëse ato janë të regjistruara në bazë të rregullave qoftë të UNMIK-ut, qoftë të legjislacionit të Kosovës, ne nuk mund t'ua marrim të hollat si po deklarohen disa që të dërgohen disa andej disa këndeje, ngase nuk jemi ne pronarë të atyre.

Ata janë lejuar me rregullat dhe ligjet e Kosovës. Tani ne duhet t'i përpunojmë ligjet, po ato që i kanë bërë deri tash, ata nuk mund të japin llogari, sepse nuk ua kemi ndaluar asnjëherë.

Ta shqyrtojmë. Mirë e ka Fatmiri që të shqyrtohet edhe njëherë dhe të shohim mundësitë si t'i shqyrtojmë dhe kush është kompetent. Cilët ekspertë na qenkan ata kompetentë që mund të na njoftojnë ose mund të na thonë që kjo është e drejta dhe e mira për të ardhmen e OJQ-ve. Të gjithave që po i quajmë shoqëri civile, qofshin ato profitabile, qofshin joprofitabe.

Unë e di që shoqëri civile dhe OJQ profitabile nuk ka askund dhe nuk duhet të ketë, sipas rregullave jo.

Po këtu ka ndodhur pikërisht në Kosovë në bazë të rregullave të UNMIK-ut dhe rregullave që ka përcaktuar pastaj Qeveria, Kuvendi apo nuk e di kush i ka përcaktuar këto rregulla. Ose që i ka mundësuar këtyre që t'i mbajnë të hapura, qoftë mikrofinancat, qoftë OJQ-të profitabile.

Sidoqoftë, e ka propozimin Fatmiri. E ka propozimin Naiti. Është propozimi i deputetëve të tjerë për t'u votuar propozimi i presidentit. Deputetë s'kemi të mjaftueshëm për të votuar. Por, edhe mua po më pëlqen propozimi i Fatmirit thënë të drejtën.

Zonja Bajrami ka replikë, s'e di me kë...

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

Zonja Hadërgjonaj ma përmendi emrin dhe tha ka shtatë vjet që jam kundër institucioneve mikrofinanciare.

Është shumë e vërtetë, edhe kur ka qenë kryetare në mandatin 2010-2013 ka provuar që t'ju japë mundësi institucioneve mikrofinanciare që shndërrohen në shoqëri aksionare.

Që këto 160 milionë që janë edhe më tepër, që po flasim që janë fituar me kamata 28% të bujqve anembanë Kosovës të përfundojnë në xhepa të individëve.

Unë jam shumë krenare që flas që shtatë vite dhe kam arritur që ta kem sadopak një ndikim edhe ta ndaloj këtë dukuri. Propozime ka sa të doni. E marrim këtë fond, bëjmë bankë zhvillimore. E marrim këtë fond e shfrytëzojmë për qëllime bamirësie. I shndërrojmë në shoqëri aksionare, po aksionar të bëhet secili bujk i cili ka kontribuar në profitin e këtyre institucioneve mikrofinanciare.

Ka pasur propozime, po nuk keni dashur që t'i merrni parasysht, sepse ata janë të lidhur me juve. Ju keni provuar prej vitit 2011 që t'i shndërroni në aksionar. Unë s'kam provuar. Jam kundër edhe sot e kësaj dite që donacionet e Bashkësisë Evropiane, Suedisë, të gjitha vendeve, ndërkaq sot fitimi i bujqve të përfundojë në xhepa të individëve të cilët pagat mujore i kanë pasur 10 mijë euro në muaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Është mirë që të mos përgjithësoheni ju dhe ata, sepse unë mund ta drejtoj gishtin gjithkrah edhe me individë të caktuar se kush është i korruptuar. Prandaj, mos e përgjithësoni ashtu krejt ju andej, sepse këtu ka shumë. Ju andej me dorë.

Nëse është dikush i korruptuar, ju lus që ta thoni edhe këtu, po edhe në prokurori është mirë të thuhet. Zonja Hadërgjonaj e ka për kundër-replikë. E ka një minutë, pastaj zoti Xhelili e ka fjalën dhe nuk ka të tjerë.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Zonja në fjalë që nuk po dua që tash t'ia përmend që të shkojmë në replika të vazhdueshme. Kush ka qenë i involvuar në rregullim e ligjit në vitin 2011 e në 2012 e di kjo më mirë se

gjithkush tjetër, sepse ka qenë pjesë e komisionit. Prandaj, nuk po dua që ta zgjasë këtë çështje më shumë.

Askush sot nuk është duke thënë që këto mikrofinanca të shndërrohen në shoqëri aksionare. Ne kemi bërë debat të gjatë në komisionin për buxhet, ku ka qenë edhe kryetari i komisionit zoti Lumir Abdixhiku. Ka qenë edhe Naser Osamni. Kam qenë edhe unë. Ka qenë edhe Blerim Kuqi edhe të tjerët që e kemi bërë grupin punës që ta gjejmë një mënyrë të zgjidhjes së problemit që ka të bëjë me mikrofinancat në mënyrë që të mos dëmtohet mikrofinancat dhe të zgjidhet dhe të vazhdohet tutje.

Nuk kemi gjetur alternative ende. Ende nuk ka përfunduar grupi punues...

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Xhelili e keni fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Unë e kam një propozim konkret, propozoj që Nait Hasani të jetë udhëheqës i grupit punues, po edhe si kryetar i komisionit i cili është që ta organizojë ekspertizën në këtë drejtim me njohës të kësaj lëmie edhe ta caktojë një afat kohor 30 ditë apo 60 ditë si të dakordohet Kuvendi, që të vijmë me propozimin konkret.

KRYESUESI: Zoti Haxhiu e ke emrin, s'e di a deshe edhe ti të flasësh?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Nuk e pata në plan që të diskutojë për këtë çështje, por në fakt më nxiti kolegja nga LDK-ja. Ajo ka qenë ministre dhe sigurisht që në kohën sa ishte ministre, sa herë është drejtuar toni i saj ka qenë disi më u butë më i ulët. Prej se është bërë deputet edhe po di që ta çojë tonin lartë, por edhe po di që ta adresojë gishtin tek të tjerët që s'janë fajtorë në fakt.

Ne e dimë, këtu jemi. Ne kemi pasur edhe deputetë të LDK-së që kanë udhëheqë me mikrofinancat me këto organizata. Të partisë suaj janë dhe pse e drejton gishtin diku tjetër.

E dini ju, në parti i keni, s'keni nevojë...I dini ju, se i ke edhe në këshill drejtues të partisë edhe i ke pasur deputetë, prandaj i ke me kaq ngut. Të lutem...Jo unë nuk kam kurrfarë mikrofinancave, unë jam deputet i Partisë Demokratike, as me ekonomi nuk merrem. Bile edhe ligjet e ekonomisë, shumë pak i lexoj.

Prandaj, mirë e kujt e dini ju se i ke në këshill drejtues. I njihni shumë mirë edhe ju Kujtim, edhe çdonjëri prej jush. Harrojeni këtë logjikë që ta etiketoni të tjerët për bizneset tuaja. Faleminderit!

KRYESUESI: Po replikë, ke të drejtë.

HYKMETE BAJRAMI: Zoti Haxhiu tha që nuk merret me ekonomi edhe kur nuk merret me ekonomi është shumë mirë të mos merret me ekonomi, sepse unë as nuk merrem me mjekësi, as me kësi fusha të sportit se ky merret shumë me ato edhe e di krejt çfarë bënë.

Deputeti, zyrtari i LDK-së i cili ka institucion mikrofinanciar është Hashim Deshishku, po nuk e ka organizatë joqeveritare. E ka institucion mikrofinanciar bankar. Andaj, mos dil aty dhe të bësh dezinformata dhe shpifje të tilla. Nuk jemi prapa askujt. Kështu që kur të dali të flas të flas me emra, e mos të thotë njerëzit e këshillit drejtues, eksponentë e tjera.

Dil dhe thoni emrat, mos t'ju vjen turp. Pse po frikësoheni që të thoni emra?

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Unë emra nuk përmenda, i thatë vetë, i dini, prandaj edhe ju e dini se për kë bëhet fjalë.

Vërtetë, po. Unë jam krenar që kam qenë pjesë e sportit edhe rezultat i keni parë. Pranimi në FIFA dhe në UEFA, krenar me atë. Besoj që edhe ju do duhej të ndiqni rrugën aty ku jeni. Edhe prandaj po më pëlqen tash kjo fare forma jote sesi po nervozohesh tani kur jeni deputete. Si ministre ke qenë pak ma e qetë.

KRYESUESI: Faleminderit! Kujtim Shala e ka fjalën. Nënkryetari i Kuvendit.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë e kam një deklaratë të shkurtër dhe të thjeshtë meqë ma përmend emrin. Unë s'e njoh këtë problem fare dhe as nuk e kam idenë çka janë organizatat mikrofinanciare. As nuk e kam pasur ndonjëherë.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë marrim pauzë deri në orën 16:15 dhe vazhdojmë pastaj.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Kemi një situatë, ta quaj gjysmëbllokues, sepse diskutimet që i kemi bërë për vendimin e presidentit sa i përket Ligjit për liritë dhe asocimin në organizata joqeveritare nuk kemi as kuorum për ta votua. Kemi 57 deputetë në sallë, ky ligj duhet t'i ketë të paktën 61 vota për, kur të bëhen kuorumi, vazhdojmë me të.

Andaj po fillojmë me pikën e 21-të:

21. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Hamza, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Draftligji për tatimin mbi vlerën e shtuar është pjesë e objektivit tonë për reforma fiskale, zhvillim të sektorit privat si dhe zhvillim ekonomik të vendit. Çështja e tatimit mbi vlerën e shtuar deri më sot është rregulluar me Ligjin numër 05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Gjatë analizave tona kemi konstatuar se zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm për tatimin mbi vlerën e shtuar ka nevojë për ndryshime, si rrjedhojë e zhvillimeve të fundit në direktivat e BE-së si dhe nevojave të vendit tonë për zhvillim ekonomik.

Për këto arsye Ministria e Financave ka draftuar Projektligjin për tatim mbi vlerën e shtuar në përputhje me objektivat e Ministrisë së Financave.

Arsyeja e hartimit të këtij projektligji i referohet avancimit të mëtutjeshëm të reformës fiskale përmes kornizës ligjore si dhe eliminimit të zbrazëtirave aktuale ligjore.

Andaj, përmes këtij projektligji synojmë që ta fusim në fuqi reformën më të madhe të ndodhur ndonjëherë në Kosovë, ku me hyrjen në fuqi të këtij projektligji bizneset do të kenë mundësi ta paguajnë tatimin e vlerës së shtuar në brendi të vendit, një mundësi të tillë që nuk ishte deri më sot.

Ky sistem i ri i mbledhjes së pagesës së tatimit në vlerën e shtuar në brendi të vendit pa dyshim do të ndihmojë shumë zhvillimin e bizneseve, për arsye se biznesi do të ketë likuiditet më të madh për ta zhvilluar biznesin.

Nuk do të ketë nevojë për kredi apo mënyra të tjera të ndryshme të financimit për ta paguar TVSH-në me rastin e importimit të mallit. Do të jetë i kursyer apo, më mirë të thuhet, do të jetë i liruar nga të gjitha interesat e ndryshme që i ka paguar deri më sot. Do të jetë i liruar nga garancitë bankare për TVSH-në e brendshme. Do të ketë thjeshtësim të procedurës së pagesës së TVSH-së dhe shumë përfitime të tjera.

Çka është me rëndësi, e gjithë kjo reformë do të implementohet pa ndonjë procedurë shtesë administrative, e cila automatikisht do të kishte kosto shtesë për biznesin. Më pas, me këtë projektligj, ndër të tjera, kemi rregulluar edhe çështjet e mëposhtme:

Është liruar lënda e parë, e cila prodhohet në Kosovë, e cila më pas përdoret në procesin e prodhimit për produktin final.

Shërbimet e bluarjes së grurit janë vendosur në normën e ulët nga 18 në 8%, librat janë liruar nga TVSH-ja.

Transporti ndërkombëtar është liruar nga TVSH-ja në përputhje me direktivat e BE-së.

Shuma e kreditimit, e cila mund të kërkohet të rimbursohet, është ulur nga 3000 në 1000 euro, me qëllim që bizneseve të vogla që janë në kreditim t'u mundësohet rimbursimi dhe ta kenë më të lehtë të ushtruarit e biznesit.

Ndërsa te zbritjet me pasuri të paluajtshme është shkurtuar afati prej 20 në 10 vjet, në mënyrë që të kthehet TVSH-ja e zbritshme në afat më të shkurtër.

Është rregulluar ngarkesa e kundërt e TVSH-së, e cila e cila ka qenë problem për disa sektorë, sidomos për atë të ndërtimitarisë.

Janë thjeshtësuar shumë procedura të deklarimit dhe kontrollit të tatimit të vlerës së shtuar, me qëllimin e vetëm për t'i ulur shpenzimet e biznesit.

Gjatë hartimit të këtij projektligji Ministria e Financave ka marrë parasysh dokumentet relevante të Këshillit të Evropës, siç janë direktivat dhe rregulloret që rregullojnë këtë fushë si dhe praktikatat më të mira evropiane dhe rajonale.

Gjithashtu të gjitha institucionet, të cilat do të merren me zbatimin e këtij projektligji, kanë qenë të përfshira gjatë hartimit.

Ministria e Financave është konsultuar me të gjithë aktorët që kanë të bëjnë me këtë fushë dhe ka përfshirë komentet relevante të tyre në këtë projektligj.

Bazuar në këto vlerësime dhe në nevojë për miratimin e këtij projektligji, në mënyrë që të avancojmë sistemin tatimor në Kosovë, por edhe të përmbushim nevojat e vendit për zhvillim ekonomik dhe përmirësim të ambientit të bërë biznes në Kosovë, kërkoj që pas diskutimeve në Kuvend dhe punës në komisione ky ligj të aprovohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Komisionit FunkSIONAL, zonja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Me Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar është paraparë rishikimi i legjislacionit tatimor me qëllim të thjeshtësimit të tij dhe mbështetjes së zhvillimit të sektorit privat përmes lehtësive tatimore.

Përveç përmirësimeve të dispozitave të paqarta dhe që krijohen dykuptimësi, ndër ndryshimet kryesore në këtë projektligj është rregullimi i pagesës së tatimit mbi vlerën e shtuar në brendi të vendit për mallra të importuara.

Projektligji është harmonizuar edhe më tutje me direktivat e Bashkimit Evropian.

Për dallim nga ligji aktual, në këtë projektligj janë shtuar përkufizime të reja si dhe një pjesë e përkufizimeve janë përditësuar, me qëllim të eliminimit të dykuptimësisë dhe janë harmonizuar me legjislacionin përkatës dhe legjislacion tjetër në fuqi.

Po ashtu është bërë riformulimi i definimit të personit të tatueshëm, është fshirë afati dymujor i hyrjes në fuqi të çregjistrimit për kërkesa për çregjistrim, vendi i furnizimit të shërbimit është riformuluar, me qëllim të harmonizimit me direktivat e Bashkimit Evropian.

Për dallim nga ligji aktual, me këtë projektligj shërbimet e bluarjes së drithërave do të taten me norma të reduktuara, ndryshim ky që synon të ndryshojë industrinë e miellit dhe mullisëve në Kosovë.

Librat shkollorë dhe publikimet serike do të jenë të liruara nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Gjithashtu furnizimi i shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve dhe bagazhit të tyre me çmimet e rregulluara nga autoriteti kompetent shtetëror është bartur me normë të reduktuar, në mënyrë që të ketë të drejtë të zbritjes së TVSH-së.

Te rregullimet e zbritjeve për pasuritë e paluajtshme është ndryshuar periudha nga 20 vjet në 10 vjet, përveç këtyre, te kërkesat për rimbursim të tatimit mbi vlerën e shtuar, shuma e kreditimit, e cila mund të kërkohej të rimbursohet, është ndryshuar nga 3000 euro në 1000 euro, në mënyrë që bizneset e vogla, të cilat janë në kreditim, të kenë mundësi të rimbursohen.

Gjithashtu është shtuar nënparagrafi i ri, në të cilën rregullohet që personi i tatueshëm, i cili është në balancë kreditore të vazhdueshme që nga periudha tatimore e parë e vitit paraprak, ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e TVSH-së, pavarësisht vlerës së kreditimit të mbetur, me kusht që të ketë dorëzuar të gjitha deklaratat e TVSH-së dhe deklaratat e tjera tatimore për të gjitha periudhat e kaluara.

Është bërë harmonizimi i trajtimit të borxhit të keq në Ligjin mbi tatimin në të ardhurat e korporatave si dhe në Ligjin për tatimin në të ardhurat personale.

Po ashtu është shtuar nen i ri që rregullon pagesën e TVSH-së në brendi të vendit për importet e bëra nga importuesi, i cili është regjistruar me qëllim të TVSH-së në Kosovë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 5.12.2018 ka shqyrtuar në parim Projektligjin numër 06/L-134 për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe ka vlerësuar se projektligji i plotëson të gjitha kërkesat formale-juridike të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit dhe i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë në lexim të parë, kurse vërejtjet dhe rekomandimet e deputetëve të bëra gjatë këtij leximi të parë, do të analizohen me kujdes nga ana e komisionit gjatë shqyrtimit dhe amendamentimit të këtij projektligji.

Rekomandojmë që të votohet ky projektligj, në mënyrë që të jepet mundësia komisionit të bëjë punën më të mirë të mundshme në këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Zoti Lushtaku, në emër të PDK-së.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë të pranishëm,

Draftligji për tatimin mbi vlerën e shtuar është pjesë e objektivit tonë për reforma fiskale, zhvillimin e sektorit privat dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Çështja e tatimit mbi vlerën e shtuar deri më sot është rregulluar me Ligjin numër 05/L-037 për tatimin e vlerës së shtuar. Gjatë analizës time kam konstatuar se zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm për tatimin mbi vlerën e shtuar ka pasur nevojë për ndryshim si rrjedhojë e zhvillimeve të fundit të direktivave të BE-së si dhe nevojat e vendit tonë për zhvillim ekonomik.

Për këto arsye, ne si Grup Parlamentar i PDK-së dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa kemi analizuar, shqyrtuar dhe aprovuar më tutje projektligjin për lexim të parë në këtë seancë.

Arsyeshmëria e hartimit të këtij projektligji i referohet avancimit të mëtejshëm të kornizës ligjore si dhe eliminimit të zbrazëtive aktuale ligjore.

Me Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar ndër të tjera mund të konstatoj nga vështrimi im se janë rregulluar edhe çështjet e mëposhtme në lidhe me kontratat afatgjata dhe kontratat afatshkurtra të instalimit, specifike për fushën e ndërtimitarisë. Neni që rregullohet këtu që ishte, është riformuluar dhe ato kontrata konsiderohen si të përfunduara, pa pasur nevojë të bëhet pranimi teknik i punëve të kryera, por në periudhën tatimore me lëshimet e situacioneve.

Shërbimet e bluarjes së grurit janë vendosur në normën e uljes nga 18 në 8%. Librat janë liruar nga TVSH-ja, transporti ndërkombëtar është liruar nga TVSH-ja në përputhje me direktivat e BE-së, shuma e kreditimit, e cila mund të kërkohet të rimbursohet është ulur nga 3 000 euro në 1 000 euro, me qëllim që bizneset e vogla që janë në kreditim t'u mundësohet rimbursimi dhe të kenë më të lehtë të ushtruarit e biznesit.

Ndërsa te zbritjet në pasuri të paluajtshme është shkurtuar afati prej 20 në 10 vjet në mënyrë që të kthehet TVSH-ja e zbritshme me afat më të shkurtër. Është rregulluar ngarkesa e kundërt të TVSH-së, e cila ka qenë problem në disa sektorë, sidomos për atë të ndërtimitarisë.

Si dhe një nga ndryshimet kryesore në këtë projektligj do të jetë mbledhja e TVSH-së në brendi të vendit, e jo në kufij, siç mblidhet sot, kjo besohet që do të ndihmojë bizneset sa i përket likuiditetit dhe do të lirohen bizneset nga barra.

Gjithashtu ne besojmë që gjatë dy leximeve të këtij projektligji do të japim kontributin tonë në sugjerimet dhe plotësimet e këtij ligji. Andaj, i ftoj kolegët deputetë të mbështesin dhe të votojnë projektligjin në lexim të parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vetëvendosje, nuk është paraqitur askush. Zoti Kuçi apo zonja Nagavci, nga Vetëvendosja.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Rregullimet që janë bërë me ligjin e ri janë të pakta dhe lënë akoma interpretim të dyfishtë. Ndonëse që disa herë po tentohet që të silllet kjo pako e ligjeve, Ligji për TVSH-në, tatimi në të ardhurat e korporatave dhe tatimi në të ardhurat personale janë sjellë disa herë radhazi në Kuvend, si pjesë e reformës së përmendur fiskale. Megjithatë, edhe në këtë vizionin e fundit nuk përbën ndonjë bazë për të realizuar synimet kryesore, të cilave do të duhej t'u shërbenin, gjegjësisht politikat fiskale, e që janë rritja ekonomike dhe krijimi i një barazie sociale.

Mbledhja e TVSH-së, ndonëse mbetet garantuesi kryesor i qëndrueshmërisë financiare të shtetit të Kosovës, barra akoma bartet te konsumatorët dhe, edhe me ligjin e ri nuk adresohet lehtësimi i barrës tatimore për shtresën më të varfër, duke larguar tatimet në konsum të prodhimeve bazë ushqimore, për shembull, të kemi TVSH zero për produktet bazike, për bukën, vajin, miellin, kripën, qumështin e kështu me radhë dhe synimin që produktet që konsiderohen si më luksoze dhe më të panevojshme të kenë një shkallë më të lartë të tatimit, ashtu si veprohet edhe në vende të tjera të BE-së.

Pra, me Ligjin për TVSH-në janë bërë disa ndryshime, si për shembull, është rregulluar pagesa e TVSH-së në brendi të vendit për mallra të importuara, por ligji nuk e saktëson se cilat biznese mund të përfitojë nga kjo masë, që në dukje është në rregull dhe ka për qëllim lehtësimin e bërjes së biznesit.

Pa u ndalur te specifikat e secilës prej neneve, pra është e rëndësishme të theksohet ndonëse këto ligje po na sillen vit pas viti me korrigjime, asnjëherë nuk po arrin t'i adresojnë deri në fund që heqja e barrës së takimeve të shkojë për favorin e shtresave të varfra, por as lehtësimi i bërjes së biznesit për prodhuesit apo për kompani, të cilat hapin vende të reja të punës, gjë që do të ndikonte edhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të PSD-së, zonja Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Në parim ne e mbështesim Ligjin mbi tatimin e vlerës të shtuar dhe vlen të përmendet se disa nga ndryshimet janë edhe kualitative dhe do të ndihmojnë në mbledhjen më të mirë të taksës, sidoqoftë ndonëse ne propozimet tona do t'i japim edhe në komision. Propozimi ynë thelbësor mbetet që megjithatë me kushtet ekonomike çfarë ne jetojmë sot dhe me nivelin e varfërisë, mallrat që i përkasin shportës familjare duhet të lirohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Gjegjesisht, propozimi në nenin 26, i cili flet për përshkallëzimin e tatimit, gjegjesisht për vlerën 8% të mallrave, për disa prej këtyre, siç janë, për shembull, furnizimi me ujë, furnizimi dhe drithëra, ku futen elbi, misri dhe variacione të ndryshme, vajrat për gatim, qumështi, vezët, kripa e kështu me radhë, pra të cilat janë pjesë e shportës, nga norma 8 të zbriten në normën 0%. Ndërsa përshkallëzimi të rritet për disa prej mallrave, të cilat konsiderohen si mallra luksi.

Kjo do të jetë edhe kërkesa jonë, të cilën do ta shtrojmë edhe në mes të dy leximeve.

Ne shpresojmë se do të marrim mbështetjen edhe të deputetëve dhe sado pak të ndikojmë që të lirohen sidomos ato familje, të cilat e kanë të vështirë që t'i sigurojnë mallrat bazë apo ato që quhen shporta kryesore familjare.

Përndryshe, në parim ne e mbështesim projektligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Qeveria e ka shpallur vitin 2019 viti i ekonomisë, apo viti i zhvillimit ekonomik.

Ministri Hamza i shpjegoi në vija të trasha përparësitë edhe elementet kryesore të këtij ligji, po ajo që unë mund të them është një ndër ligjet më të guximshme që Qeveria ka mund ta ndërmarrë ndonjëherë lidhur me politikat fiskale.

Kjo është përkrahje e madhe e bizneseve të Kosovës. Pra, është ky një guxim i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ju përgëzoj, zoti ministër, e përgëzoj Qeverinë Haradinaj që më në fund u dha ajo përkrahja e madhe që është pritur shumë prej biznese.

Edhe ky ligj, bashkë me njëzet kapitujt e vetë dhe me katër shtojcat e veta, është instrumenti kryesor që shkon paralel me programin e zotit Haradinaj si kryeministër, edhe i Qeverisë Haradinaj.

Ne si grup parlamentar do të jemi të përkushtuar dhe të fokusuar që ta japim përkrahjen tonë mes dy leximeve, e sidomos brenda Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe grupeve që caktohen në këtë komision.

Edhe një herë, e përgëzoj Qeverinë Haradinaj, e përgëzoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, për guximin e vet dhe për përkrahjen e bizneseve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe e mbështesim tani në leximin e parë. Do të japim kontributin tonë mes dy leximeve, e veçmas në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe mendojmë se ky i plotëson disa zbrazëti, të cilat e kanë përcjellë deri më tani këtë ligj dhe do të japim një mbështetje të plotë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Për të votuar nuk ka kuorum.

22. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës

Komisioni Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj ministrin e Arsimit, zotin Bytyqi, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Bytyqi, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQERI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Miratimi i Ligjit të arsimit të lartë në Kuvendin e Kosovës ka rëndësi të madhe për arsimin e lartë në Kosovë, pasi që ky ligj do të mësojë vazhdimin në reforma në arsimin e lartë si dhe krijimin e sistemit të arsimit të lartë, i cili do të jetë kompatibil me sistemin evropian të arsimit të lartë.

Qëllimi i hartimit të Ligjit të arsimit të lartë të Republikës së Kosovës është krijimi i bazës ligjore për rregullimin, funksionalizimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë.

Parimet e Ligjit të arsimit të lartë kanë për qëllim që të ofrojnë një arsim të lartë në Republikën e Kosovës, bazuar në parimet si në vijim:

Lirinë akademike, të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës,

Barazinë para ligjit për të gjithë bartësit e arsimit të lartë,

Mundësinë e barabartë për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit të lartë,

Shumëllojshmërinë dhe cilësinë në programe të studimit dhe në mbështetje të mësimdhënies, kreativitetin, inovacionin dhe ndërmarrësin si objektiva kyçe për bartësit e arsimit të lartë dhe të programeve të studimit.

Fokusimin evropian dhe ndërkombëtar i të gjitha fushave të arsimit të lartë që të sigurojë studentët dhe personelin, lëvizshmërinë dhe krahasueshmërinë e standardeve për dhënien e diplomave dhe të kualifikimeve.

Përkushtimin në punën kërkimore dhe akademike për të mbështetur mësimdhënien dhe nxënien, si dhe për të zgjeruar kufijtë e njohurive brenda Kosovës dhe jashtë saj.

Angazhim aktiv të studentëve si në aspektin individual, ashtu edhe në atë kolektiv në jetën e institucioneve dhe mësimnxënies së tyre.

Qasja në arsimin e lartë sipas këtij ligji do të jetë i barabartë për të gjithë bartësit e licencuar të arsimit të lartë në Kosovë, do të kenë qasje të gjithë qytetarët brenda dhe jashtë territorit të Kosovës, pa asnjë lloj diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Nuk do të ketë kufizim moshe për t'u regjistruar apo për të fituar kualifikimin në arsimin e lartë në Kosovë.

Kompetenca dhe përgjegjësitë e institucioneve në ligjin e përcaktuar paraqet qartë, përfshirë kompetencën e përgjithshme të Ministrisë së Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, Agjencinë e Akreditimit të Kosovës, bartësve publikë dhe bartësve të tjerë të arsimit të lartë, duke krijuar një koordinim funksional dhe gjithë aktiviteteteve në arsimin e lartë në Kosovë.

Ligji përcakton themelimin akreditimin, licencimin, strukturën qeverisësve, funksionimin, financimin, kontrollin financiar dhe autonominë e bartësve publikë dhe bartësve të tjerë të arsimit të lartë.

Po ashtu ligji përcakton qartë marrjen e titujve, gradave, diplomave dhe lirinë akademike.

Ligji parasheh edhe nxjerrjen e statuteve të bartësve të arsimit të lartë.

Me ligj po ashtu përcaktohet edhe e drejta dhe përgjegjësia e studentëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj kryetarin e Komisionit Funksional për Arsim dhe Teknologji, zotin Kurteshi, që të arsyetojë raportin e komisionit.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Arsim, për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 10 dhjetor 2018 shqyrtoi në parim Projektligjin numër 06/L-135 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim:

Të miratohet në parim Projektligji numër 06/L-135 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Ndonëse edhe Komisioni ka shumë vërejtje në projektligj, ne e konsiderojmë se në mes të dy leximeve do të ketë shumë punë dhe mundësi që ky ligj të rregullohet dhe më në fund Kosova të bëhet me Ligj për arsimin e lartë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, nuk është paraqitur askush. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, është paraqitur Abdyl Salihu.

ABDYL SALIHU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për ju, të nderuar deputetë,

Dhe ju ministra,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Ky ligj përcakton parimet, objektivat kryesore dhe organizimin e arsimit të lartë si dhe rregullat për krijimin, organizimin, funksionimin, mbylljen, financimin, akreditimin dhe licencimin e institucioneve të arsimit të lartë, me qëllim që të sigurojë të sigurt të transparencës, ngritjes së cilësisë dhe zhvillimit të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, në përputhje me standardet më të mira evropiane dhe ndërkombëtare, siç mund të jenë standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do të votojë për miratimin në parim të këtij projektligji dhe ne do të japim kontributin tonë mes dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, zonja Arbërie Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Ligji për arsimin e lartë, edhe pse është e sata herë që po vjen në shqyrtim në Kuvend edhe në legjislaturat e kaluara, duket se edhe ky projektligj nuk ka arritur të ketë cilësinë e dëshiruar dhe të jetë një projektligj, i cili do të mundësonte përmirësimin e cilësisë së arsimit në Republikën e Kosovës në këtë nivel kaq të rëndësishëm për zhvillimin e vendit.

Ajo që bie në sy, në shikim të parë, është se Ligji për arsimin e lartë synon vendosjen e kontrollit politik dhe jo një mbikëqyrje publike. Është një ligj që fare nuk i kushton kujdes punës shkencore, e cila është shumë e rëndësishme dhe nuk mundëson përparimin e hulumtimit shkencor. E dimë se Ligji për hulumtime shkencore edhe ashtu ndan një buxhet shumë të vogël, e edhe ai nuk përfillet aq sa duhet, nuk zbatohet.

Ky projektligj për arsimin e lartë edhe një herë nuk e adreson këtë çështje që është kaq e rëndësishme për përparimin e shkencës dhe për zhvillimin në përgjithësi të arsimit të lartë.

Nëse analizojmë nenet e projektligjit, bie në sy se nenet e tij të caktuara bie ndesh me nenet e tjera të legjislativit që janë në fuqi, për më tepër ka raste që bien ndesh edhe me parimet bazike të Kushtetutës, duke cenuar parimin e mosdiskriminimit dhe në mjaft raste bien ndesh edhe në raport me kodet dhe praktikën e tjera ndërkombëtare.

Ligji ka mangësi dhe një tendencë që t'i vendosë universitetet nën pushtetin e Ministrisë së Arsimit, në mjaft raste jepet kompetencë ekskluzive ministrit për emërimin apo shkarkimin e personave të caktuar apo për vendosje për vendime shumë të rëndësishme në raport me arsimin e lartë dhe kjo nuk duhet të lejohet në asnjë mënyrë.

Është e qartë se situata politike në Kosovë nuk e ka nivelin e duhur demokratik që e karakterizon një vend me një demokraci të konsoliduar, ku do të kishim edhe një ndërgjegje të qartë akademike dhe një përgjegjësi të plotë, ashtu që zgjedhjet e bordeve të jenë të pandikuara politikisht, ashtu sikurse po ndodh në vendin tonë. Ajo që tash shihet, pra me këtë projektligj është që tendenca dhe ndikimi i vazhdueshëm në politizimin e bordeve dhe të agjencive të caktuara tashmë po synohet që të vendoset edhe mbi baza ligjore.

Zgjedhja e Këshillit Drejtues të UP-së në këtë formë se si është paraqitur e tregon qartë tendencën për të vënë nën kontroll universitetet nga Ministria e Arsimit.

Në projektligj po ashtu është e dukshme në mënyrën si është propozuar se Këshilli Drejtues qëndron mbi Senatin, gjë që po ashtu ia humb autonominë universiteteve dhe në këtë mënyrë ka një ndikim të shtuar nga ana e ministrisë, pra jo nga ana e stafit akademik, të cilët do të ishin personat që janë përgjegjës për përmirësimin e cilësisë.

Këshilli Drejtues e zgjedh edhe rektorin që propozohet nga Senati me një ose dy emra dhe në këtë mënyrë vërehet se gati 50% ndikimi është nga Ministria e Arsimit.

Ministri e përmendi në fjalën e tij se projektligji i përcakton edhe të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve dhe në këtë pjesë unë do të doja të përmend një pikë nga neni që iu referua ministri, ku përmendet edhe pagesa që duhet të bëhet nga studentët dhe, për më keq, është që kjo pagesë duhet të bëhet, d.m.th. studentëve të cilët nuk arrijnë që të pranohen në mënyrë të rregullt, atëherë atyre u lejohet mundësia që të regjistrohen me pagesë, gjë që e cenon përsëri edhe planifikimin, por edhe cilësinë e universitetit.

Është e qartë se ka mjaft hapësirë edhe në çështjet të cilat kanë të bëjnë me avancimin e stafit dhe me kujdesin që duhet të kemi në përmirësimin e cilësisë në universitetet tona dhe në institucione e tjera të arsimit të lartë, të cilat edhe ashtu në gjendje në të cilën janë, lënë mjaft për të dëshiruar, andaj ne si Lëvizje Vetëvendosje do të kemi amendamente të shumta dhe do të mundohemi që të kontribuojmë, edhe pse duket që cilësia e ligjit nuk është ajo që lë hapësirë për një punë që do të japë rezultate të mëdha. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Driton Çausi, në emër të PSD-së.

DRITON ÇAUSHI: Faleminderit, kryesues!

Ky projektligj është sjellë në Komisionin për Arsim dhe unë do të përpiqem që po ato vërejtje që i kam dhënë atje, t'i përsëris këtu. Në parim ne e kemi kaluar këtë ligj, por hapësira për të dhënë propozime dhe për të sjellë ndryshime është e madhe dhe këto ndryshime besoj që janë të domosdoshme. Disa probleme u thanë nga kolegët parafolës, unë do të përmend disa prej tyre, por shumica prej atyre që nuk mund t'i shqyrtojmë sot, do t'i trajtojmë në komision.

Neni 8, po e marr si shembull, përcakton kushtet sipas të cilave definohet një status i një universiteti. Pra, përveç të tjerave, nënkupton 5 programe të PHD-së dhe kjo duhet të jetë një bazë minimale. Natyrisht, statutet e universiteteve kanë lirinë të përcaktojnë kushte të tjera sipas kritereve të tyre.

Pra, në nenin 2.2 sqarohet statusi i universitetit, në pikën 2.3 të të njëjtit nen thuhet që universiteteve publike të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës u njihet ky emërtim pa pasur nevojë t'u nënshtrohen kritereve të paragrafit 2.2. Pra, në dukje kjo është qartë një tendencë për të shmangur aktualisht gjashtë universitetet publike që janë themeluar gjatë periudhës së pasluftës nga kriteret që përcaktohen në një nen më herët, besoj që edhe opinionioni publik tashmë e ka të qartë një problem që është shpërfaqur me vlerësimin e Agjencisë për Akreditim, pra me mungesën e kushteve dhe problemet e mëdha që ata kanë hasur duke mosakredituar rreth 40% të programeve të këtyre universiteteve. Bindja ime është që të gjitha këto 6 universitete, të paktën kur janë themeluar, kanë qenë pjesë e një fushate partiake, nuk kanë qenë të bazuara në çfarëdo strategjie për zhvillimin e arsimit të lartë, rrjedhimisht gjetja nga Agjencia, edhe pse ky është një proces i hapur, ku mund të ketë hapësirë për ankesa, nuk duhet të jetë befasi dhe mendoj që përveç vlerësimit aktual, duhet që ky nen të hiqet si universitetet që mund të hapen në të ardhmen, si këto aktuale, duhet t'u nënshtrohen të njëjtave kushteve për ta miratuar statusin e universitetit. Unë do të ndalem shumë pak në këtë pikë, edhe për pak kohë, ta kemi të qartë që situata në Universitetin Publik "Hasan Prishtina" nuk është e mirë, ky universitet ballafaqohet me shumë probleme dhe mendoj që gabimi më i madh që mund të jetë në periudhën e pasluftës ka qenë humbja e fokusit në zhvillimin e këtij universiteti, ndërkohë u hapën gjashtë universitete të tjera publike.

Për ta ilustruar këtë gjendje, janë 20 vjet të pasluftës që Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore vepron dhe funksionon në kushte të mjerueshme. Sot ata mbajnë mësimin në Fakultetin e Filologjikut, pra është fjala për shkencë bazike: fizikë, kimi, biologji, gjeografi, matematikë, përderisa në ndërkohë kemi hapur gjashtë universitete të tjera, me dilema të mëdha që po dalin si të vërteta për ditë e më tepër, ku ofrohen katër fakultete juridike, katër fakultete të edukimit, në ndërkohë që të vetmin Fakultet të Shkencave Natyrore e kemi lënë totalisht të pazhvilluar dhe në kushte as të përafërta të hulumtimit dhe të studimit. Po rikujtoj që buxheti vjetor i këtyre universiteteve është 27 milionë euro. Pra, nuk dua ta paragjykoj si do të shkojë procesi i akreditimit të tyre, mirëpo është e qartë dhe evidente që është shkaktuar një dëm i madh me këto vendime që janë marrë fatkeqësisht nga deputetët pa asnjë analizë, asnjë vlerësim për nevojën dhe kapacitetet për të hapur universitete të tjera. Dëmi më i madh është shkaktuar për UP-në, por dëmi i madh është shkaktuar komplet funksionimin e këtyre universiteteve, e studentëve që kanë dalë, që kanë diplomuar nga këto universitete, e të cilët sot mund të bartin role të rëndësishme dhe funksione të rëndësishme, ndoshta pa e pasur kualifikimin e duhur.

Një çështje tjetër, të cilën e kam ngritur edhe në komision, e që konsideroj që duhet ndryshuar dhe nuk është trajtuar mirë në këtë ligj është te neni 6, “Qasja në arsimin e lartë”, ku thuhet “të gjithë personat që plotësojnë kriteret dhe kualifikohen për pranim kanë qasje në programe studimore pa asnjë lloj diskriminimi”, kurse neni 42 thotë që ministri përcakton me akt nënligjore pagesën maksimale të shkollimit që duhen paguar nga studentët që pranohen në institucionin publik të arsimit të lartë të financuar nga Qeveria. Kur themi që studentëve u garantohet një e drejtë pa asnjë lloj diskriminimi, ne besojmë fuqishëm që kjo duhet të jetë një e drejtë e garantuar dhe që nënkupton për një institucion të arsimit publik, e drejta dhe mundësia për të studiuar falas. Unë e kam të qartë që në studimet bazike tarifat nuk janë të larta, por mendoj që është e padrejtë që, të paktën në nivelin master studentët të paguajnë 150 euro për semestër. Kjo për shumë studentë nuk është barrë e lehtë dhe është në kundërshtim me këtë që pretendon ky nen në këtë ligj.

U përmend autonomia e institucioneve të arsimit të lartë, në nenin 18 që flet për autonominë, thuhet në pikën 2: “Të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Kosovës gëzojnë autonomi institucionale, liri akademike, autonomi financiare, organizative rreth përzgjedhjes së personelit në përputhje me legjislacionin në fuqi”. Megjithatë, në nenin 22, te Këshilli Drejtues si organ i universiteteve thuhet që ministri emëron anëtarët e jashtëm të Këshillit Drejtues, numri i të cilëve duhet të jetë për një më i vogël se sa numri i anëtarëve të zgjedhur nga institucioni. Për më shumë, pika 9 e këtij neni thotë se Këshilli Drejtues zgjedh kryesuesin nga radhët e anëtarëve të emëruar nga ministri.

Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm për ndikimin negativ që ka pasur politika në sistemin e arsimit të lartë dhe do të ishte koha ideale tani që me këtë ligj të bëjmë të pamundurën që këtë lloj ndikimi ta parandalojmë, e që qartë nuk ndodh sipas këtij projektligji. Pra, nuk mund të respektojmë autonominë organizative funksionale të këtyre universiteteve, përderisa përcaktojmë gati gjysmën e përbërjes së Këshillit Drejtues dhe udhëheqësin e këtij organi. Ka dhe shumë, siç thashë, çështje të tjera, por besoj që vendi i duhur do të jetë komisioni, ku duhet të marrim mendime edhe nga ekspertët e tjerë jashtë këtij institucioni, pra jashtë Kuvendit dhe të bëjmë të pamundurën për të nxjerrë një projektligj më të drejtë dhe më në përputhje me kërkesat e studentëve, e një nivel cilësor të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari përshëndes ardhjen e Projektligjit për arsimin e lartë, i cili që nga 2014-a është kërkuar që të silllet në Kuvend dhe në një kohë është tërhequr në një periudhë kohore në legjislaturën e kaluar, pa një arsyeshmëri të plotë.

E dimë që të gjitha ligjet fatkeqësisht dhe padrejtësisht kërkojnë edhe kuotë, edhe një numër pra të votave nga pakicat, që është e padrejtë, pra, të imponohet shumë herë edhe kalueshmëria e tyre, po flas për pjesën e Listës serbe, ose të pakicave serbe. Ngase po na imponojnë, përkundër asaj që punojnë në Republikën e Kosovës, po nuk përfillin kurrë ligjet e Republikës së Kosovës, kurse ligjet kërkojnë pra për t'u votuar, për t'u aprovuar edhe votat e pakicave serbe. Prandaj, ky projektligj i ardhur, edhe pse me vonesë, megjithatë, pra, ne si deputetë, angazhimi ynë do të duhej të ishte që ditën e parë, pra që të angazhohemi që të kemi debate e dëgjime publike me aktorët kryesorë, me ata që janë përgjegjës, në mënyrë që ne si deputetë të japim maksimumin, mirëpo t'ju krijojmë jo vetëm për t'i dhënë mendimet profesionale, për gjithë ata që më së shumti i atakon ligji në fjalë.

Kur e kemi miratuar Projektligjin në vitin 2011, ka ardhur edhe miratimi i statuseve në Komisionin e Arsimit, ne kemi pasur disa probleme të vazhdueshme, me të cilat janë ballafaquar fatkeqësisht universitetet, të cilat i ka hapur ky Kuvend. E kam thënë disa herë, e them edhe tash, kam qenë dhe jam për universitetet publike, ngase është me interes për studentët, të cilët mund të jenë studentë të familjeve që mund të mos kenë paga, apo mund ta kenë një pagë shumë minimale, përkundër pagave të deputetëve, ministrave, zëvendësministrave apo kujtdo qoftë tjetër, që mund t'i çojnë në cilindo kolegji të Evropës, sepse pikërisht këtu në Kuvend ne mund të shohim se kush ku i ka fëmijët duke i shkolluar. Dhe, kjo është arsyeja pse e mbroj që të kenë pavarësi dhe të jenë institucione jo vetëm sa për të thënë, por ne t'ju ndihmojmë që ata të kenë një pavarësi jo vetëm, pra në lirinë akademike, por edhe financiare, me të cilën ata janë ballafaquar shumë herë.

Pra, tani me situatën të cilën e kemi dhe e kemi parë si komision, me krijimin e të mos them, sugjerimeve, se vendime ende nuk ka nga Agjencia për Akreditim, për suspendimin apo tërheqjen e akreditimit të disa programeve, ajo që më ka shqetësuar dhe më shqetëson edhe sot e kësaj dite është që në arsimin e të gjitha universiteteve të krijuara në Republikën e Kosovës asnjë program fillor nuk ka mbetur i akredituar. Kemi pasur në një periudhë një vendim që po e përmend, ngase do të jem shumë të vëmendshëm që të mos lejojmë të dalin gabime, të cilat do të sjellin vendime që bien në kundërshtim me ligjin, siç ka ndodhur një vendim i marrë në Qeverinë e Republikës së Kosovës jashtëligjshëm dhe ka sjellë edhe kuadro, mësimdhënës, të cilët nuk kanë dalë si produkt i institucioneve publike, nga ministri Bajrami, por që është një numër bukur i madh i dalë nga institucionet private, ku neni 16, pika 5, i Ligjit për arsimin e lartë thotë: "Asnjë nga bartësit e arsimit të lartë privat nuk nxjerrin mësimdhënës", kurse sot në Republikën e Kosovës në të gjitha universitetet e themeluara nga ky Kuvend nuk është asnjë program i arsimit fillor, pra thjesht, dilema është kush do të nxjerrë mësimdhënës?

Dhe, unë mendoj dhe uroj që institucionet, përgjegjësit, rektorët, por njëkohësisht edhe shkalla e dytë në kuadër të Agjencisë, edhe ne si komision, pse jo edhe Ministria dhe Qeveria, të bëjnë hapin e duhur, në mënyrë që të shihen mundësitë jo për të bërë presion te asnjëri institucion, jo

për të ndikuar absolutisht, mirëpo të shihen mundësitë që të mos dëmtohen studentët, ngase po ballafaqohemi me vite të tëra me shumë probleme të tjera, të moslicencimit të diplomave të marra, edhe pse me dhjetëra herë janë potencuar pikërisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës që këto janë probleme që po dalin, ngase kemi pasur vendime të nxjerra nga njerëz me emër që kanë qenë në një periudhë në Ministrinë e Arsimit, që kanë akredituar programe dhe ballafaqimi i atyre problemeve me vite po zgjat deri sot, ku janë edhe 8 vjet prapa. Pra, do të jemi shumë të vëmendshëm që të mos ndikojnë individët e caktuar përmes gjoja ekspertëve të na përvidhen gabimet që, fatkeqësisht na kanë dalë nganjëherë dhe na kanë ikur, ngase dikush di të jetë shumë i djallëzuar. Pra, do të jemi shumë të vëmendshëm përmes ekspertëve që vërtet të punojmë në Ligjin e arsimit të lartë, në interes të institucioneve të arsimit të lartë, jo në interes të individëve a të subjekteve politike.

Prandaj, Aleanca jo vetëm se e përkrah në parim, por është shumë e përkushtuar edhe me ekspertët që i ka brenda si subjekt politik, për të punuar në një periudhë kohore që do të kemi mjaft kohë për ta bërë një ligj të zbatueshëm dhe në interes të institucioneve e të mos kemi probleme, siç kanë ndodhur në universitete, që shumë herë na u kanë drejtuar, siç është Universiteti i Prizrenit, ngase kanë pasur probleme shumë të mëdha dhe ne fare nuk kemi mundur t'u dalim në ndihmë. Pra, edhe një herë, do të ulemi bashkarish, por jo për interesa të askujt e të punojmë vërtet në këtë ligj me të gjithë aktorët, jo si subjekte politike, por si deputetë të Parlamentit të Kosovës që ta bëjmë ligjin për institucionet e arsimit të lartë. Prandaj, jo një debat, jo disa debate, disa dëgjime publike, edhe ashtu jemi të obliguar si komision, por do t'i bëjmë derisa ta bëjmë vërtet një ligj të zbatueshëm, për këtë edhe jemi të thirrur, për këtë edhe e kemi obligim që të japim maksimumin, edhe pse nuk mund të themi që shumica e anëtarëve mund të jenë edhe të fushës adekuate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Balaj Halimaj, në emër të Nismës.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

E vërteta është se ne kemi pasur goxha nevojë për këtë ligj dhe fatmirësisht tashmë e kemi në Kuvend, një ligj i cili është me standarde goxha të larta dhe një ligj, i cili presim që të zhvillojë arsimin e lartë në Kosovë.

Pashë nga kolegët e Komisionit për Arsim, sepse ata të cilët folën, deputetët, pra janë shumica e tyre në Komisionin për Arsim, mendoj që ata sigurisht se i kanë shprehur mendimet e tyre edhe këtu në seancë, por që komisioni është një vend, në të cilin edhe kritikën që i kanë mund t'i diskutojmë bashkë aty dhe të shohim në fund si do t'ia bëjmë për secilin nen. Pashë që ka tendenca, që ka ligji tendencë për politizim, e tjera, gjë që fare nuk është e vërtetë, sepse nëse po flasim për të njëjtin ligj, unë në fakt nuk i kam parë aty, por megjithatë kontributin tonë ne si Nismë sigurisht do ta japim në Komisionin për Arsim dhe besoj që me miratimin e këtij projektligji, arsimit i lartë në vend do të ketë ngritje edhe të cilësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar 6+.

MÛFERRA SRBICA-ŞINIK: Faleminderit, kryesues!

Yüksek Öğretim Yasasının birinci okunuşunu 6+ Parlamenter Grubu olarak kabul etmekteyiz. Kosova için çok önemli olan bu Yasa Tasarısının iyi hazırlanmış olduğunu görmekteyiz, ancak daha da iyi olabilmesi için genelde eğitimci milletvekillerinden oluşan eğitim komisyonunda katkımızı sunacağız. Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Bunjaku-Rexhepi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Edhe ne e mirëpresim këtë projektligj, ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjit për arsimin e lartë. U tha edhe para folësve të mi se ky projektligj do shumë angazhim dhe përkushtim, profesionalizëm dhe unë personalisht i kam nxjerrë disa pika, të cilat kemi mundësi si propozime për t'i ndryshuar.

Pika 6 e nenit 7, korniza e kualifikimeve dhe ciklet e studimeve në arsimin e lartë, faqe 19, ne kërkojmë që të riformulohet, si në vijim: Për regjistrimin në studimet e ciklit të tretë kandidati duhet të ketë fituar titullin master i shkencave, master i arteve ose ekuivalente, për regjistrim në studimet e ciklit të tretë kandidati duhet të ketë të fituar në ciklin e dytë të studimeve universitare ose duhet të riformulohet ndryshe. Në Projektligjin për arsimin e lartë duhet të jenë e qartë grada e masterit dhe e doktoratës, sepse më pastaj kandidatët po kanë probleme me punësimin, por edhe juritë profesionale po bien në konfuzion se cili kandidat ka gradë. Edhe ky nen duhet të ndryshohet.

Kemi edhe nenin 8, llojet e institucioneve të arsimit të lartë duhet të ndryshohen te faqja 20, pasi që shpesh po bien studentët në konfuzion se çfarë institucioni po studiojnë, a është universitet, a është kolegë, a është shkollë? Prandaj për t'i shmangur këto parregullsi duhet të ndryshohet edhe neni 8.

Në paragrafin 2.2, faqe 21, thuhet se universiteti duhet të ketë së paku 120 anëtarë të personelit akademik me orar të plotë pune dhe së paku gjysma e tyre duhet të kenë titullin më të lartë shkencor. Kosova nuk ka numër të mjaftueshëm të kuadrove, unë besoj që edhe në këtë nen do të japim propozim që të ndryshojmë. Në pikën 2.4. universitetet publike duhet të ndryshohen domosdoshmërisht, kjo ngase vetëm universitetet publike mund të ofrojnë programe studimi që bien në kualifikime për mësimdhënësit në nivel parauniversitar. Ministri e mban të drejtën ekskluzive të aprovimit apo refuzimit të programeve të tilla. Unë besoj që edhe këtu ka nevojë për ndryshim, sepse nuk duhet t'i lihet e tërë kompetenca Ministrisë së Arsimit. Duhet të

plotësohet edhe neni 9 i sigurimit. Sigurimi i brendshëm i cilësisë me një paragraf të ri, çdo institucion i arsimit të lartë duhet të ketë një zyrë për cilësi, e cila do të bashkëpunojë shumë ngushtë me Agjencinë Kombëtare të Akreditimit, duke monitoruar performancën e mësimdhënësve dhe të synojë në vazhdimësi rritjen e cilësisë në këto institucione. Kemi edhe në pikën tjetër, pikën 9, në faqe 32, 33 të Projektligjit, ne propozojmë që të përcaktohet se propozimet për anëtarë të vijnë nga Akademia e Shkencave dhe Arteve. Domethënë edhe kjo pikë ka nevojë për ndryshime.

Në pikën numër 7, faqe 37, është e pakuptimtë, aty thuhet se anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë zgjidhen përmes një procesi konkurrimi dhe emërohen nga ministri. Edhe kjo besoj që duhet të ndryshohet. Kemi edhe pikën 14, ku thuhet se nëse institucioni dështon për herë të dytë në marrjen e akreditimit, i revokohet licenca. Sa i përket nenit 17, bashkimi, ndarja apo mbyllja e institucioneve publike është kompetencë e ministrisë, kjo nuk duhet të jetë kompetencë e ministrisë kjo duhet të jetë kompetencë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse universitetet publike janë formuar dhe janë votuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe vetëm Kuvendi mund të arrijë t'i mbyllë këto universitete. Në atë kohë janë krijuar këto universitete, sikurse universitete për vota elektorale dhe tanimë ato nuk janë universitete të Thaçit, por janë universitete tona publike, të cilat ne duhet t'i mbrojmë me fanatizëm dhe duhet t'u japim mundësi që studentët tanë prej atyre universiteteve publike të dalin kuadro të mirë që në një të ardhme të udhëheqin shtetin.

Prandaj, edhe unë si anëtare e Komisionit nga Lidhja Demokratike do të jap kontributin tim në komisionin përkatës dhe nuk do të kursehem në asnjë mënyrë që të vijë një projektligj i suksesshëm dhe i arsyeshëm në favor dhe në të mirë të gjithë studentëve dhe qytetarëve tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Deliu.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti Haliti!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë deri tani folën të gjithë anëtarët e Komisionit Funkcional, natyrisht që do t'i prekë vetëm disa prej pikave që mendoj që komisioni në fjalë do t'i trajtojë me seriozitet. Janë disa komente dhe specifika që përmban sidomos Fakulteti i Arteve karshi njësisë të tjera akademike në Universitetin e Prishtinës dhe nëse ne e kemi sot Projektligjin për arsimin e lartë, unë konsideroj që deputetët e këtij komisioni duhet t'i trajtojnë me seriozitet, sidomos nenin 27 që është mbi titujt akademikë, pikën 3, siç parashihet me draftligjin, të cilin ne e kemi tani, titujt akademik të profesorit të rregullt, të profesorit të asociuar dhe të profesorit asistent mund t'i jepen kandidatit, i cili e ka përfunduar doktoratën, natyrisht që për degë specifike, për shembull, siç janë degët e mjekësisë, të farmacisë apo të veterinarisë, krahasuar me titujt akademikë kërkohet edhe diplomim

apo edukim pasdiplomik, specializim apo subspecializim, megjithatë një praktikë e njëjtë është totalisht ndryshe në Fakultetin e Arteve, nuk është paraparë forma se si të zgjidhet stafi akademik i Fakultetit të Arteve, ku aktualisht pothuajse të gjitha fakultetet e arteve do të thotë jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë titujt akademikë zgjidhen me përvojën e tyre në praktikë, punën e tyre profesionale, e jo botimet në revista të caktuara.

Këto vlejné vetëm për ato lëndë, të cilat janë lëndë teorike, të cilat natyrisht që titujt e caktuar duhet t'i kenë parasysh dhe të mbarojné doktoratën për lëndët praktike, natyrisht që duhet të mbarojné edhe studimet përkatëse. Ekziston një rregull aktuale e zgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në Fakultetin e Arteve, e cila është punuar bashkë me rektoratin, ku janë konsultuar natyrisht përvojat më të mira të shteteve, të cilat e kanë të rregulluar shumë mirë këtë çështje të titujve në Fakultetin e Arteve. Neni 30 flet për veprimtarinë shkencore, por në këtë nen është anashkaluar totalisht veprimtaria artistike, e cila konsideroj shumë që duhet të përfshihet në projektligjin në fjalë, e cila në Fakultetin e Arteve vepron në tri departamente, të cilat funksionojné si fakultete të ndara, e që janë: artet vizuale aplikative, artet muzikore, si dhe artet dramatike apo artet skenike. Veprimtaria e tyre duhet të njihet do të thotë konform angazhimit të tyre praktik, ka shumë muzikantë të suksesshëm, të cilët kanë suksese në lëmenj të caktuar dhe në vepra të caktuara, kompozitorë të suksesshëm, të cilët kanë punime të tyre të rëndësishme artistike, gjithsesi edhe të arteve dramatike, të cilët nëpërmjet performansave të tyre artistike kanë marrë edhe tituj të caktuar. Megjithatë unë nuk e di nëse ka ndonjë shtet të caktuar që ka një doktor të violinës, me përjashtim të anës teorike, ku gjithsesi ajo duhet të vlejë, por konsideroj që projektligji në fjalë duhet ta marrë me seriozitet dhe ta trajtojë çështjen e Fakultetit të Arteve, sepse është specifikë në vete dhe duhet të parashihet dhe të rregullohet brenda projektligjit.

Unë besoj shumë që edhe kryetari i Komisionit për Arsim, zoti Kurteshi, do t'i ketë në konsideratë këto vërejtje, të cilat unë i dhashë dhe natyrisht nëse ka një dakordim ne gjatë punës në Komisionin Funkcional do të kujdesem që të punojmë bashkarish që ta sjellim një ligj, i cili do të jetë gjithëpërfshirës dhe t'i rregullojë të gjitha kategoritë veç e veç. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Të dashur qytetarë,

Kryesues dhe kolegë të nderuar,

Pa dyshim që sot po trajtojmë një ndoshta prej projektligjeve më të rëndësishme që mund të vijë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sepse ka për synim rregullimin e një sferë që shpeshherë referohet edhe si shtylla e një shteti, pra për sferën e arsimit. Veçanërisht ka të bëjë me një pjesë të lëmit së arsimit që në periudhën e kaluar është veshur me një mori problemesh dhe që kanë përfunduar deri në skandale, besa edhe në aktakuza nga Prokuroria e Shtetit.

Kështu që po shpresoj që Ministria e Arsimit me këtë projektligj ka synuar që jo vetëm të rregullojë këtë sferë, por të ketë një synim pak më të thellë, pra që të bëjë një reformë gjithëpërfshirëse të sferës së ofruesve të arsimit të lartë ose bartësve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Është e qartë se ka pasur probleme të mëdha edhe unë e kisha pasur shpresën që edhe ministri ndoshta mund të na tregojë dhe të na informojë nëse i kanë trajtuar disa prej problemeve që kanë buruar nga e kaluara, veçanërisht nga praktika, siç ka qenë një prej çështjeve edhe mosdefinimi i qartë në mes të institucioneve private, publike dhe atyre që nuk janë as private as publike, por që janë të organizuara si organizata joqeveritare ose jofitimprurëse.

Çështja e mosharmonizimit të standardeve, varësisht a po flitet për universitete publike apo private dhe në mes të atyre kategorive. Çështjet tjera kanë qenë çështje që kanë buruar nga ligji, por që nuk kanë qenë në përputhje me kapacitetet e vartësve të arsimit të lartë. Një prej tyre që më kujtohet ka qenë edhe garancia bankare e cila është kërkuar prej të gjitha kolegjeve, por në fakt asnjë prej tyre nuk kanë pasur kapacitet financiar që të ofrojnë për akreditim. Pastaj çështjet që kanë pasur të bëjnë me mungesën e indikacioneve ose udhëzimeve të qarta sa i përket emërimit të kolegjit, universitetit e kështu me radhë. Prandaj, shpresa është që edhe pse të gjithë ne këtu do të mundohemi që të kontribuojmë si të themi në arritjen e një versioni sa më të mirë të këtij projektligji kur të përfundon si ligj, po shpresa është që Ministria e Arsimit vërtet i ka trajtuar këto probleme nga praktika dhe është në gjendje që ta sjellë neve një projektligj me të cilin vërtet mund të punojmë, në krahasim me disa projektligje të tjera të cilat po vijnë këtu dhe po janë tërësisht të papërpunueshme.

Veç desha të theksoj këtë me shpresën sepse po shoh që ka disa çështje që duhet patjetër të adresohen dhe një prej tyre p.sh. është te përkufizimi i institucionit privat. Në fakt, me këtë përkufizim keni përjashtuar të gjitha institucionet private të cilat janë të organizuara si shoqëri tregtare, pra që janë vërtet private. Sepse përkufizimin që e keni dhënë është i tillë që mbulon vetëm këto organizatat jofitimprurëse. Pra, a ka qenë qëllimi që të përjashtohen dhe të mos ketë bartës të arsimit të lartë që janë të organizuara si shoqëri tregtare apo është vetëm lëshim teknik, i cili duhet të përmirësohet gjatë punës në mes të dy leximeve, gjatë punës edhe në Komision, edhe në grupe punuese.

Kështu që shpresa është që shpresa është që ta marrim këtë projektligj ndoshta me një seriozitet edhe më të lartë sesa që merren të gjitha projektligjet e tjera që vijnë këtu, duke e pasur parasysh ndjeshmërinë e sferës të cilën po e mbulon dhe problemet që i kemi pasur në të kaluarën e këtë sferë.

Dihet qartë që një prej problemeve kyçe ka qenë edhe standardet që i kanë tejkaluar rrethanat në të cilat gjendet Kosova. U përmend edhe nga Valentina, pra standarde shumë të larta, me kërkesa për numër shumë të lartë qoftë të stafit profesional e akademik, qoftë për numrin e studentëve

për të marrë një emër të caktuar që është e paarritshme për një vend si Kosova me 1 milion e 700 mijë banorë edhe me kapacitetet që ka. Kështu që edhe një herë uroj që të gjithë deputetët të kontribuojnë në këtë drejtim dhe të gjithë t'i ofrojmë kapacitete tona edhe për komisionin përkatës dhe të nxjerrim një Projektligj që në fund do të jetë një ligj që do ta rregullojë këtë sferë në mënyrë të duhur. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Kur kemi parasysh se Kosova e zë vendin e parë në Evropë për nga numri i studentëve, ne i kemi në 100 mijë banorë rreth shtatë mijë studentë, derisa mesatarja e Evropës sillet diku rreth katër mijë studentë. Po ashtu kur kemi parasysh edhe rrëmujën që po ndodh në këtë sferë shumë të rëndësishme të jetës sonë, për shkak të mungesës së një ligji të mirë dhe po ashtu për shkak të mosrespektimit edhe të këtij ligji ekzistues, Republika e Kosovës ka shumë nevojë për një Ligj të ri për arsimin e lartë.

Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës kanë bërë përpjekje edhe në legjislacionin e kaluar që ta hartojnë një ligj, por për shkak të pengesave që kanë ardhur nga Lista Serbe të cilës i është mundësuar me Kushtetutë që të bëjë obstrukcione sepse kjo rrjedh nga ajo logjika e kompromiseve të kompromisxhinjve tashmë të njohur në Kosovë, ka ndodhur që edhe ne të mbetemi për një kohë tepër të gjatë pa këtë ligj të rëndësishëm.

Ligji i sponsorizuar nga Qeveria ka shumë të meta që janë fundamentale, që duhet të amendamentohen ndërmjet dy leximeve në Kuvend. Fjalën time e pata filluar me analizën e plot neneve dhe pikave, po aq shumë kishte vërejtje në nenet dhe pikat e këtij ligji sa unë vendosa t'i përmend vetëm disa çështje në parim. Së pari, vërehet se hartuesi i këtij Projektligji nuk është konsultuar me institucionet e arsimit të lartë, me studentët, me profesorët dhe udhëheqësit e këtyre institucioneve në mënyrë që t'i dëgjojë edhe vërejtjet, edhe sugjerimet, prandaj edhe kemi shumë reagime nga kategoritë që i përmenda më lart, e të cilat do të kenë mundësi që ndërmjet dy leximeve të bëjnë vërejte dhe të kontribuojnë në këtë ligj.

Përmes këtij Projektligji, legjitimohet cenimi i autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë nga Ministria e Arsimit, nga ministri personalisht përmes Këshillit Drejtues të universiteteve dhe mekanizmave të tjera, të cilat, në një mënyrë ose tjetër, do ta kontrollojnë arsimin e lartë në Kosovë, ashtu siç ka ndodhur edhe gjerë më tani.

Po ashtu, shihet hapur se në Projektligjin e propozuar, hulumtimeve shkencore nuk iu kushtohet rëndësi e duhur dhe nëse edhe në këtë drejtim nuk bëhen korrigjime të nevojshme, hulumtimet shkencore në vend do të mbeten në gjendje në të cilën janë, e ato aktualisht janë diku rreth pikës zero. Me këtë ligj lejohet ndërhyrja e Ministrisë, ose e ministrit të arsimit edhe në punët e

Agjencisë Kosovare të Akreditimit, që do të ishte një gjë krejt e palejueshme, për arsye se me ndërhyrje të tilla e kemi sjellë vendin në këtë gjendje në të cilin është.

Projektligjit i mungojnë edhe nene të caktuara të cilat do t'i kushtonin rëndësi bashkëpunimit ndërkombëtar dhe sidomos aplikimit në projekte ndërkombëtare që do ta mundësonin edhe ushtrimin e hulumtimeve dhe të punës shkencore, por do të krijoheshin edhe mundësi për përfitime financiare të institucioneve të arsimit të lartë.

Një çështje po ashtu shumë e rëndësishme në këtë Projektligj e që duhet të korrigjohet është çështja e financimit. Me Projektligj parashihet që studentët të paguajnë për studimet e tyre derisa ky nen bie në kundërshtim me nenin që e përmendi më lart kolegu Çausi që kjo e cenon edhe barazinë në studime të atyre që janë të interesuar të studiojnë. Po ashtu, sa i përket financimeve, kemi edhe formulime të këtilla që së paku për momentin janë të papranueshme në vendin tonë. Propozohet që me këtë projektligj propozohet që edhe institucioneve të pavarura të arsimit të lartë t'iu ndahen mjete financiare derisa buxheti i Kosovës nuk i mbulon as shpenzimet për institucionet publike të arsimit në të gjitha nivelet. Unë sot më herët përmenda që kemi mësues, kemi edhe zyrtarë të tjerë që janë të angazhuar në arsim dhe atyre nuk iu jepen të ardhurat për shkak të mungesës së buxhetit.

Po ashtu me këtë Projektligj, prapë po ndalem te financimi, parashihet edhe financimi i programeve që për një arsye ose një arsye tjetër e humbin akreditimin e fituar më parë, pra kërkohet që këto programe të financohen edhe për një kohë të pacaktuar e që do të ishte gabim vërtet i madh nëse këto programe financohen, edhe atë pa kohë të caktuar.

Përkundër të gjitha këtyre të metave, ky Projektligj duhet të kalojë në lexim të parë, me kushtin që të gjithë të angazhohemi që të ndihmojmë në korrigjimet e nevojshme dhe në leximin e dytë ligjin ta sjellim ashtu siç i nevojitet institucioneve të arsimit të lartë, prandaj i ftoj publikisht të gjithë të interesuarit që në tryezat tona, në debatet tona publike që do t'i organizojmë së shpejti në lidhje me këtë projektligj të marrin pjesë me komente, me sugjerime dhe me vërejtjet që i kanë, në mënyrë qeta ndihmojnë këtë projektligj të dalë sa më i mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Pre svega, prvo razmatranja Nacrta zakona u ovoj so kom obrazovanju Republika Kosove je jedan zakon koji stagnira duge niz godina ovde kod nas i jedan je od važećih i gorućih problema obrazovnog sistema Republike Kosova. Svi mi moramo biti važni akteri u ovom, počev od Ministarstva, dobro je što ćemo institucijonalno rešiti napokon ovaj problem, ali organizovanjem okruglih stolova, i javnih debata, medijsko prezentovanje u medijama daće kvalitet preporuke i odgovornosti obrazovnim institucijama kako to treba da funkcioniše.

Važno je da spomenem da mi kao zajednica imamo dva javna univerziteta, odnosno naše fakultete, i to u Prizrenu na Univerzitetu “Ukshin Hoti”, imamo u Peću na Fakultetu “Haxhi Zeka”, tamo gde bosanski jezik je službeni jezik u upotrebi. Međutim, eto koristim priliku i u prošlom mandatu, i u prethodnom mandatu sam za ovom govornicom iznosila monopol pojedinih naših profesora, koji već skoro dve decenije drže svoje individualne smerove, znači to nije fakt da studenti imaju kvaliteta i profitiraju i završe uspešno te smerovi ili programe i kasnije budu zaposleni u našim institucijama, nego konstantno imamo zloupotrebu individualno službenih položaja pojedinih profesora, i jedne te iste smerove znači samo edukativnih smer Učiteljski i Fakultet biznisa u Peći.

Koristim priliku da zamolim i ministra, tu nam je potrebna i njegova pomoć da kosovsko tržište zahteva sasvim neke druge smerove, i tu nam trebaju pristupiti u pomoći i albanski profesori, koji jako dobro znaju naš jezik, ali nam trebaju i institucije Sandaka, institucije Bosne i Hercegovine, kako bismo akreditovali nove smerove i našim studentima dali pristupim novim smerovima, kako bi lakše došli do posla.

Ono što takođe mene brine jeste nostrifikacija diploma naših studenata koji su završili u zemljama u regionu. Gospode poslanici, zamislite da jedan Bošnjak koje diplomirao u zemljama u regionu nemože se zaposliti u našim institucijama, jer treba proces nostrifikacije da traje godinama, ali jedan Srbin se može zaposliti sa istom takvom diplomom, i tu vidim propust naših institucija po tom pitanju i nadam se da će ministar uzeti u obzir da se taj proces što brže sprovede na delu.

Tako da ovaj bitan zakon u prvom čitanju danas ovde u Parlamentu važno da ga svih podržimo, zato što kvaliteta obrazovnog sistema zavisi od jednog civilizovanog društva i smatram da je vreme da pokažemo ozbiljnost svih nas i kvalitet, ne samo kvantitet, nego kvalitet, kako bismo našu omladinu zadržali na ovim prostorima, kako bismo im obezbedili dobra radna mesta sa dobrim i jakim smerovima. Tu snosimo odgovornost i svi mi, ne samo Ministarstvo obrazovanja, nego i mi kao poslanici, i Rektorat, i obrazovani sistem, počev od profesora i sve nadole. Tako da do drugog čitanja zakona imamo dosta vremena da damo sve sugestije, da damo preporuke u granicama naših mogućnosti i sposobnosti, ali da budemo otvorenih za svaki vid saradnje koje ide kompromisno u pozitivnom smislu našeg društva. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit i nderuar nënkryetar Haliti!

Të nderuar ministra,

I nderuar ministër i Arsimit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht duhet të sqarojmë një fakt sepse Ligji për arsimin e lartë edhe në mandatin e kaluar ka qenë në lexim të parë në Kuvend, i përgatitur nga Ministria e Arsimit dhe ministri Arsim Bajrami, por që ky ligj nuk mori votat e dy të tretave të komuniteteve. Në fakt, komuniteti serb nuk e votoi ligjin, për arsye se Ligji parashihte edhe integrimin e universitetit të pjesës veriore në kuadër të arsimit të lartë të Republikës së Kosovës dhe licencimi i tyre parashihej që të bëhej nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës. Kjo ishte një nga arsyet që komuniteti serb nuk e votonte Ligjin për arsimin e lartë, prandaj për disa muaj qëndroi në sirtarët e Kuvendit dhe pastaj ai ligj u tërhoq sepse nuk kishte votat e mjaftueshme.

Unë duke falënderuar Ministrinë e Arsimit dhe ministrin Bytyqi që ka sjellë sërish këtë ligj në Parlamentin e Republikës së Kosovës në lexim të parë, e para e punës ne duhet të dimë se a i kemi votat për ta kaluar këtë ligj më tutje, apo do ta përdorim këtë ligj që ne të diskutojmë problemet e arsimit të lartë dhe pastaj ky ligj prapë të tërhiqet, sepse nëse nuk i ka votat deputetëve serbë.

Marrë në tërësi, ligji është një koncept-dokument i parapërgatitur, i cili ka të mirat e tij, por koncepti i përgjithshëm mendoj ende duhet të punohet në këtë projektligj që të përmirësohet. Ndoshta edhe mundësinë e ndryshimit të zgjedhjes së udhëheqjes së universiteteve, në veçanti nëse në vazhdimësi ka pasur vërejtje ose janë emëruar njerëz të politikës në udhëheqje të institucioneve arsimore, në këtë rast në arsimin e lartë në universitete, atëherë sigurisht se zgjedhja e rektorëve në këto universitete do të duhej të ishte më e drejtpërdrejtë. Pra duke përfshirë edhe studentët, pjesëmarrjen e tyre, por edhe vetë stafit akademik në zgjedhjen e rektorëve, pra të jetë një zgjedhje më e drejtpërdrejtë.

Sido që të jetë, nëse Ligji kalon në leximin e parë, ne do të kemi mundësi që të bëjmë amendamentet tona dhe pastaj ato dot ‘i diskutojmë me komisionin parlamentar për arsim, por edhe me Ministrinë e Arsimit sa i përket këtyre objektivave. Ajo çka është me rëndësi dhe që kemi menduar edhe në ligjin paraprak për arsimin e lartë ka qenë që profesorët e rregullt të kenë tituj profesorë të rregullt, pensionimi i tyre të jetë në 68 vjet, ndërsa ata emeritus me 70 vjet, pra që të kenë mundësi që përvojën e tyre akademike, njohuritë e tyre t’i transmetojnë te gjeneratat e reja.

Qasja jodiskriminuese e këtij projektligji na jep një detyrë që të punojmë me komunitetin serb që ato të cilat sot njihen si institucione të arsimit të lartë në pjesën veriore, që të punojmë që t’i integrojmë. Është edhe detyrë, edhe përgjegjësi, edhe obligim i joni që të punohet në integrimin e tyre dhe mos të na ndodhë që në konferencat shkencore të prezantohemi ne me Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, e ata të pjesës veriore me Universiteti i Prishtinës - Mitrovicë dhe Republika Serbe. Sepse na ka rastisur disa herë në konferencat shkencore të bëjmë vërejtjet tona sa i përket mënyrës sesi janë prezantuar studentët, por edhe profesorët e universitetit të pjesës veriore.

Mendoj se edhe te Agjencia e Akreditimit do të thotë duhet të ketë ende specifikime, që të rritet pavarësia e Agjencisë së Akreditimit dhe që të kemi një profesionalizëm më të mirë, të merren edhe praktikrat edhe të vendeve të tjera, në veçanti që edhe fitimi i titujve akademikë dhe gradave shkencore të krijohet një mekanizëm, ku nuk do të jetë kjo vetëm përgjegjësi më e Universitetit të Prishtinës dhe të jetë monopol i Universitetit të Prishtinës një qasje e tillë, por që kjo pastaj të jetë edhe më liberale, por që të jetë gjithsesi më transparente dhe shumë më domethënëse në aspektin e publikimeve shkencore dhe hulumtimeve shkencore.

Pra, nëse këto nuk janë të mundshme të bëhen me anë të këtij ligji e që siç po duket, dhe nëse jemi objektivë dhe realë, gjasat që ky ligj të kalojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës me dy të tretat e komunitetit serb, të komuniteteve në fakt, janë të vogla, atëherë kërkoj nga ministri i Arsimit që pjesë të kësaj objektivë të tij, me këto ndryshime të prezantuara në këtë projektligj t'i bëjë me anë të statuteve.

Unë edhe i kam bërë një pyetje parlamentare ministrit të Arsimit sa u përket statuteve të universiteteve publike, që këto statute të plotësohen dhe ndryshohen, sepse disa nga ato janë prej kohës së themelimit të tyre, e kam fjalën për universitetet publike të reja, të cilat kanë nevojë të kenë statute të cilat janë në shërbim të studentëve dhe mësimeve dhe duhet të adaptohen dhe të specifikohen bazuar në specifikat e fakulteteve, sepse në veçanti me theks të veçantë, me specifikat e Fakultetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Arteve ku kërkohet një qasje më ndryshe, edhe njohuri, edhe përvojë, edhe publikime shkencore, apo veprimtarisë artistike e cila nuk mund të publikohet në dokumente, po mund të publikohet në prezantime apo në sesione akademike të niveleve të artit, ashtu siç i prezanton krejt bota.

Duke i dhënë mbështetje këtij projektligji e duke besuar që ndoshta votat për të do të bëhen, e nëse nuk bëhen atëherë i nderuar ministër, mbetet puna që të punojmë në statutet e universiteteve publike, që ato të cilat janë të nevojshme të plotësohen dhe të ndryshohen, të bëhet përmes statuteve të universiteteve publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur, nuk ka kuorum për t'u votuar, besoj që nesër bëhet kuorumi. Dua t'ju informoj që interpelancën me ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica të kërkuar nga z. Faton Topalli dhe i mbështetur nga 11 deputetë, si dhe debatin parlamentar me kërkesë të deputeti Faton Topalli në lidhje me mosekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës me kërkesë të sponsorizuesit unë e tërheq deri në seancën e ardhme nga rendi i ditës dhe vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës:

24. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të zgjedhurve

E ftoj zotin Zafir Berisha që në cilësinë e propozuesit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Tashmë ka një kohë të gjatë që flitet për këtë ligj, rreth këtij ligji. Është diskutuar edhe në legjislaturat e kaluara. Unë jam munduar që këtë ligj që është përpunuar dhe adaptuar edhe me ndihmën e krejt kolegëve të tjerë ta sjell në mënyrë të rregullt në Kuvend, dhe po besoj që ky ligj, plotëson një boshllëk që ka ekzistuar tash e 20 vjet pas luftës.

Ky projektligj ka për synim që të kaluarën e hidhur të shoqërisë sonë në sistemin komunist jugosllav të asaj kohe dhe aktorët e atij sistemi të kufizohen në marrjen e përgjegjësi në institucionet publike, njëherësh të rehabilitojë moralisht të gjithë ata të cilët për shkak të bindjeve të tyre politike kanë vuajtur nga padrejtësitë e bëra nga ky sistem.

Projektligji ka një strukturë të përbërë prej 30 neneve, përmes të cilëve adreson qëllimin e ligjit. Grupi i deputetëve iniciues të këtij projektligji, përmes 30 neneve, në mënyrë të detajuar ka paraqitur kohën e fillimit dhe mbarimit të periudhës në të cilën do të sanksionohen personat fizikë të cilët i kanë shërbyer regjimit komunist. Drejtoria për Buxhet dhe Pagesa të Kuvendit ka vlerësuar se Projektligji për pastërtinë e figurave të zyrtarëve të lartë në institucione dhe të zgjedhurve ka implikime financiare normalisht, dhe ne duke pasur parasysh që ligji prek një periudhë të caktuar dhe është i afatizuar në veprim për shkak se tash akterët e sistemit të bartjes së pozitive në sistemin e regjimit komunist, një pjesë e madhe është moshë e moshuar, ligji natyrisht do të jetë i atribueshëm deri në 2037-ën dhe natyrisht Komisioni i cili parashihet me ligj, faktikisht do të veprojë në përpunime edhe me atë sesi veprojnë komisionet e tjera që i japin llogari Kuvendit.

Unë po mendoj se mbështetja e këtij ligji është e rëndësishme. Ky ligj natyrisht bazohet edhe në kartën e BE-së të vitit 1996 ku natyrisht aty kërkohet që vendet e ish-blokut komunist ta bëjnë një shkëputje e kaluara e tyre komuniste dhe kriminale. Kështu që pres nga të gjithë deputetët ta mbështesin këtë ligj dhe natyrisht të japin kontributin e vet dhe po besoj që brenda dy leximeve, të gjithë aktorët e interesuar edhe në debatet që besoj që komisioni përkatës t'i organizojë, këtë ligj ta bëjmë më të mishëruar dhe thjesht mundësisht edhe të zbatueshëm për shkak të disa specifikave që ka Republika e Kosovës dhe mungesën e mundshme që mund ta ketë në dokumentacione, për shkak se regjimi i Serbisë i ka prekur shumë arkiva dhe thjesht mund ta vështirësojë punën e komisionit që parashihet sipas këtij ligji. Ju faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Myfera Shinik.)

KRYESUESJA: Faleminderit! Tani e ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, zonja Albulena Haxhiu, për arsyetimin e raportit të Komisionit.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit zonja nënkryetare e Kuvendit!

Komisioni për legjislacion e ka shqyrtuar në parim Projektligji për pastërtinë e figurave të zyrtarëve të lartë në institucione publike dhe të zgjedhurve dhe në kohën kur e kemi shqyrtuar si Komision këtë projektligj, ne e kemi ftuar njëkohësisht edhe z. Zafir Berisha që ta arsyetojë këtë projektligj, mirëpo z. Berisha nuk ka mundur të jetë i pranishëm. Arsyeja se pse e kemi ftuar është për shkak se edhe është propozues. Natyrisht i ka edhe disa deputetë të tjerë që e kanë mbështetur nga grupet e ndryshme parlamentare, por për shkak që kemi hasur në terminologji të cilat nuk i përkasin termeve të institucioneve në Republikën e Kosovës, p.sh. përmendet Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Kosova nuk ka këshill të lartë të drejtësisë, por ka Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial, por nuk e ka këshillin e lartë të drejtësisë, këtë e ka Republika e Shqipërisë. Pastaj e kemi parë që ka shumë ngjashmëri me ligjin që është në fuqi në Shqipëri, dhe kemi parë që aty është bazuar. Megjithatë, ne jemi pajtuar në Komision që në parim ta përkrahim këtë projektligj. Pra, është pak shumë Ligji për lustracion. Dhe kemi menduar që më qoftë se Kuvendi e jep votën për. Unë shpresoj që të jetë vota për. Atëherë, ne si komision do të kemi punë goxha shumë për shkak se duhet t'i adresojmë shumë çështje.

Në emër të grupit parlamentar flet deputeti Sami Kurteshi dhe do t'i adresojë, por unë vetëm po them që komisioni e ka përkrahur në parim, pra ai i ka rekomanduar seancës që të votojë për. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Prej Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Armend Zemaj, urdhëroni!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit e nderuara kryesuese!

Ideja e këtij projektligji besoj që është e qëlluar, por është e vonuar edhe në aspektin procedural edhe në frymën e krijimit të institucioneve dhe të kushtetutshmërisë në Republikën e Kosovës.

Duke i marrë për bazë rrethanat e krijimit të shtetit të ri, por edhe të kaluarën e cila nuk ka krijuar mundësi edhe ligjore, edhe atë që kërkohet procedurale që Republika e Kosovës të gëzojë, apo të ketë në dispozicion dosjet nga sistemi i kaluar komunist, i cili padrejtësisht ose janë grabitur ose janë tjetërsuar nga shteti okupues serb dhe nga republikat tjera që e kanë përbërë Federatën jugosllave.

Si shqiptar të Kosovës kemi të drejtë dhe duhet të kërkojmë edhe në frymën e Rezolutës së Këshillit të Evropës që definimi i së kaluarës apo lustrimi për figurat publike të bëhet në mënyrë

të saktë, pa pretendime të cilat e dëmtojnë shoqërinë kosovare, por duke insistua që të gjithë ata që kanë qenë pjesë e krimeve makabre të komunizmit të mos jenë pjesë e institucioneve të reja në Republikën e Kosovës. Për këtë pajtohemi.

Ajo çka i mungon këtij projektligji është ajo çka e potencoi edhe kryetarja e komisionit. Është një projektligj kopje, pothuajse e ligjit nga shteti amë Shqipëria, dhe me disa nuanca të cilat në aspektin procedural të amendamentimit, sigurisht komisioni duhet t'i analizojë edhe atë që e potencova; kushtet dhe rrethanat në të cilat funksionon Republika e Kosovës.

Për këtë arsye duhet me kujdes të ketë shqyrtim. Jo pse është pak e ngutshme si iniciativë, po duhet të kemi trajtim të saktë, sepse kemi të bëjmë me një sistem komunist afatgjatë dhe ku shqiptarët e Kosovës nuk janë trajtuar drejt edhe në aspektin e asaj që potencova dhe është e drejtë elementare që të kemi në zotërim si institucione dosjet nga ai sistem.

Ndoshta kjo mund të ketë një arsyes në atë që ne po kërkojmë tash në dialogun me Serbinë që të dorëzohen të gjitha arkivat që ka poseduar atëherë Krahina Autonome e Kosovës.

Të ketë definim të saktë sepse kemi të bëjmë me një periudhë e cila është e ndjeshme dhe pastërtia publike do të jetë e lehtë të definohet në arsyeshmërinë që ka dhënë deputeti apo grupi i deputetëve në pjesën që lidhet me nenet e caktuara.

E dyta, mendoj që ajo çka i mungon projektligjit është...Pasi këta janë thirre në frymën e rezolutës së Këshillit Evropës, është edhe një rezolutë tjetër e vonshme, e cila thotë se Serbia i mbanë 700 punëtor aktiv të shërbimit sekret tash në Republikën e Kosovës.

Tani ky është edhe një problem tjetër, i cili mendoj që pa ato që unë i parafrazova paraprakisht do të jetë e pamundshme që të kemi, apo ky komision që do të krijohet, sepse edhe te komisioni e pashë që një shpërputhje të madhe te nominimi, kushtet, kriteret, kush si dhe raporti pozitë-opozitë, komunitete shumicë. Mendoj që këto janë çështje të lehta sepse i takon komisionit që t'i zgjidhë. Por, çështje delikate mbetet te gjithçka që lidhet me dosjet dhe shqyrtimin e dosjeve.

E dyta dhe e fundit që do ta potencoj. Unë mendoj që çdo shërbim sekret që potencohet në Republikën e Kosovës që i ka bërë dëm vendit, duhet të ketë verifikim të së kaluarës së tyre.

Edhe ato shërbime të cilat janë thirrur që janë kombëtare, por ka pretendime që janë antikombëtare. Kjo gamë e verifikimit të së kaluarës dhe shqyrtimit të atyre dosjeve, besoj që duhet të trajtohen në mënyrë të saktë.

Po besoj që edhe ju edhe deputeti që e ka propozuar edhe deputetët edhe kolegët tjerë e dinë për cilat shërbime e kam fjalën. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Hajdar Beqa, nga Grupi Parlamentar i PDK-së.

HAJDAR BEQA: Faleminderit e nderuar nënkryetare!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar me vëmendje Ligjin nr. 06/L-126 për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të zgjedhurve.

Ne edhe në grup parlamentar, por edhe si anëtar të komisionit për legjislacion e kemi parë që ka nevojë për shumë plotësim-ndryshime në këtë ligj. U tha edhe nga parafolësit se është i ngjashëm me ligjin e Republikës së Shqipërisë.

Ne e kemi një formë ndoshta ndryshe të organizmit të institucioneve, por megjithatë unë e përgëzoj në këtë rast sponsorizuesin e këtij ligji. Mendoj që është më shumë sesa i domosdoshëm për Republikën e Kosovës që ta kemi një ligj të tillë, duke pasur parasysh se ka kaluar Kosova gjatë historisë e sidomos për pjesën e periudhës komuniste.

Unë mendoj që ka qenë ndoshta i vonuar, por megjithatë ne si Parti Demokratike, si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, do ta japim kontributin tonë mes dy leximeve.

Edhe në Komisionin për Legjislacion në grup punues, por edhe nëpërmjet amendamenteve. Nuk do të ndalemi sot në materie. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sami Kurteshi, nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje.

SAMI KURTESHI: Faleminderit zonja kryesuese!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Ne e kemi përpara një tekst një projektligj që sido që ta quajmë i hershëm apo i vonshëm, po shihet që i ka ardhur koha dhe është punë e mirë që është paraqitur ky projektligj.

Natyrisht që do të ketë shumë punë. Ky është njëri ato ligje që nuk duket shumë i madh, dhe momentalisht nuk ka ngjallur ndonjë polemikë të madhe. Por, sigurisht do të vjen koha kur do të diskutohet edhe në shoqëri pak më gjatë ky ligj, sepse prek një pjesë më të madhe të popullsisë sesa që mendohet vetëm me këtë ligj.

Ne e kemi trajtuar këtë ligj edhe në komision edhe si subjekt si parti politik, edhe natyrisht që ne i kemi edhe pyetjet tona, edhe vërejtjet tona, sugjerimet tona.

Unë tash nuk do të ndalem, vërtetë që ta flas për çështje teknike. Lëshime gjuhësore apo mossaktësimi, meqenëse mossaktësimi i koncepteve të përdorua këtu mund të jetë problematik. Këto do t'i lëmë sigurisht në grupin punues.

Unë e dëgjova edhe zotin Berisha që në të vërtetë ka ofruar këtë projektligj dhe kjo është punë e mirë, prandaj edhe po e falënderoj. Mirëpo, foli për disa gjëra që unë i dëgjova dhe, ndoshta edhe zoti Berisha më dëgjon me kujdes. Realisht në këtë projektligj askund nuk flitet për rehabilitimin.

Ndoshta është mirë të mendojmë dhe si koncept ta fusim rehabilitimin. Në këtë tekst nuk e kemi këtë. Këtu kemi të bëjmë me pastrimin e figurës, bile jo as me sanksionimin apo dënimin e krimeve të komunizmit siç është atje në memorandumun shpjegues të Qeverisë për këtë ligj.

Bazën ky projektligj e ka në një Rezolutë të Këshillit të Evropës të viti '96, kur ka filluar pastrimi i figurës së personave publik kryesisht në vendet e Evropës Lindore, edhe kjo ka qenë një nevojë një domosdoshmëri jashtë së cilës nuk kanë mundur të ikin.

Natyrisht, ajo që gëzon këtë ligj, është se nuk do të ketë hakmarrje. Dënimet për ata njerëz që kanë mundur të bëjnë vepra të dënueshme duhet t'i shqiptojë gjykata. Kjo është shumë e drejtë dhe prandaj ky projektligj do të kërkojë që të sqarohet përmes udhëzimeve administrative, saktësisht procedura dhe rruga sesi bëhet verifikimi.

Ajo që unë dua ta theksoj edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje është; janë disa çështje që ne duhet t'i vërejmë dhe që duhet të rregullohen. Çështja e parë është në të vërtetë ai thelbi, themeli. Kush cakton komisionin e parë, kush e hedhë farën e parë për krijimin e një komisioni, cilët janë ata persona apo cili është ai çelës për zgjedhjen e këtyre personave që mandej do ta caktonin komisionin verifikues.

Sigurisht, edhe për këtë duhet të mendohet shumë seriozisht, dhe ata që e kanë propozuar këtë projektligj, të cilin ne e përkrahim, por kjo do të jetë çështja e parë.

Ka mandej edhe çështje që duhet të diskutohen. Për shembull thotë; deri në vitin 2037. Zoti Berisha nuk ka qenë në komision edhe pse kishte ftesë, s'ka mundur të vjen dhe t'i sqarojë disa dilema që ne i kemi pasur në lidhje me këtë propozim.

Sigurisht, para leximit të dytë, gjatë punës edhe në grup punues edhe në komision, shumë çështje sikur kjo do të sqarohen. Mandej ka edhe gjëra të tjera të krijimi i komisioneve, përbërja e komisionit. Kriteret për zgjedhjen e personave që do të jenë në ato komisione, dhe si do të fillojë hapi i parë, ku do të fillojë hapi i parë i verifikimit për arsye se, sidoqoftë pas hapit të parë kemi

të bëjmë edhe me persona që sigurisht do ta kenë të drejtën e ankesës në procedurën e verifikimit nga një komision.

Sigurisht, pastaj duhet t'i shohim edhe çështjet tjera edhe ato do t'i diskutojmë më vonë.

Ne kemi edhe disa gjëra të tjera. Për shembull kemi... Duhet të shkojmë meqenëse me kompjuterë pak...Kemi edhe gjërat themelore, në njërin anë mendohet që të krijohet një komision që burimin, pjesërisht do ta ketë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, mirëpo buxhetin e miraton Qeveria e Kosovës.

Unë mendoj se në këtë drejtim duhet të kihet kujdes, sepse së paku unë sa i mbaj mend disa qeveri, në raste të tilla sensitive kanë ditur ta luajnë rolin e tyre "të të madhit", duke lejuar mjete ose duke ndalur mjete, sepse e kanë në kompetencë të tyre drejtpërdrejt. Dhe kjo është një çështje domethënë.

Një çështje tjetër që është shumë me rëndësi edhe që duhet të thuhet është edhe problemi i trajtimit të dosjeve edhe i të dhënave personale të personave që verifikohen, ta themi në këtë mënyrë.

Sigurisht, kjo do duhej të jetë, ky verifikim, kjo procedurë duhet të jetë në përputhje me legjislacionin që është në Republikën e Kosovës, dhe ajo ka të bëjë me të dhënat personale të individit.

Një çështje tjetër shumë me rëndësi që do duhej ta theksoja edhe mandej dalëngadalë i vjen fundi, është çështja se ky verifikim nuk e ka të qartë krejt periudhën për të cilën flitet, 1944-1999. Mirëpo, nuk i ka kriteret e qarta pse duhet të zgjasë deri në vitin 2037. Cilat janë ato elemente? Dhe këto elemente sigurisht që duhet të nxjerrën, po shpresoj që do të nxjerrën.

Çështja e fundit parimore që dua ta nxjerr është në të vërtetë, pastaj në procedurën e ankesave. Po kthehem përsëri te gjykata dhe aty duhet të rregullohet, ngase gjykatësi, gjykatësja, trupi gjykues që merret me çështje të tilla edhe e trajton procesin e verifikimit të një personi, në të vërtetë vet gjykata, trupi gjykues apo gjakësi apo gjykatësi duhet të jenë të verifikuar nga ky komision.

Kjo ka me qenë njëra ndër çështjet që duhet të shihet me kujdes shumë të madh edhe duhet të diskutohet.

Edhe njëherë po them Lëvizja Vetëvendosje, grupi parlamentar e përkrahë këtë projektligj dhe natyrisht që ne do të angazhohemi që ky projektligj të ecë sa më shpejt përpara edhe të bëhet një ligj i mirë, i cili do ta arrit qëllimin për të cilin edhe është dorëzuar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Prej Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Shkumbin Demalijaj.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, nënkryetare!

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës përkrahë projektligjin për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve.

E kemi shqyrtuar edhe në komision ashtu siç e tha edhe kryetarja e komisionit edhe kolegët tjerë paraprakisht që biseduan.

Nuk është hera e parë që kjo iniciativë vjen në Kuvendin e Kosovës. Ka qenë edhe në legjislaturën e tretë, mirëpo jam shumë skeptik lidhur me këtë çështje për shkak se këtu duhet një sinqeritet i të gjitha subjekteve politike se a duan që të hyjnë dhe ta kryejnë këtë punë ose jo.

Pra, duhet të bashkërenditen të gjitha subjektet se a e kanë përnjëmend këtë çështje. Dihet Rezoluta e Këshillit të Evropës të vitit '96 për pastrimin e figurave dhe dënimin e krimeve të komunizmit, mirëpo në rastin tonë konkret, historia jonë e pasluftës ka treguar diçka ndryshe. Sepse, tek ne bartësit e këtyre proceseve, pikërisht bartësit e këtyre proceseve të cilët flasin për pastërtinë e figurave po edhe për dënimin e krimeve të komunizmit i kemi pasur në krye të institucioneve.

Janë liderë të partive politike në Kosovë, çdonjëri është më i vogël se ata. Çdonjëri është më i vogël se shefat ekzekutiv të asaj periudhe. Gatishmëria jonë duhet të jetë e fortë dhe të ulen subjektet politike dhe të merren vesh se a duan t'i qasen këtij drejtimi ose jo.

Pastaj, s'po flasim vetëm për krimet e komunizmit, po flasim edhe për periudhën e okupimit klasik në kohën Milosheviqit. Njerëzit që kanë bashkëpunuar në atë kohë kur shqiptarët kanë krijuar institucione paralele edhe i kanë kaluar në demokraci. Njerëzit që kanë bashkëpunuar në atë kohë, ku janë dhe në cilat institucione janë tash. Pjesa tjetër është se kur flas për kompaktësinë, a jemi të interesuar si Kosovë që të merremi me një çështje të tillë dhe përfundimisht të bëhet ky pastrim i këtyre figurave.

Ne e kemi edhe te komunitet problemin e madh. Ende sot në Kuvendin e Kosovës, po edhe nëpër institucione kemi njerëz që e kanë përkrahur Milosheviqin edhe ndryshimet kushtetuese, edhe krimet dhe sot thonë "Kosova e Metohija" në Kuvendin e Kosovës. Në rastin adekuat duhet të jemi në kontinuitet, unë kushtimisht e them, por kërkoj edhe nga grupi im parlamentar që të kenë një gatishmëri që së bashku me të gjitha partitë politike të ulen, sepse jam shumë skeptik se të gjithë ata që po trumbetojnë edhe po flasin më së shumti në këtë drejtim, dështojnë në momentin e përfundimit të kësaj.

Jemi për si AAK dhe mendojmë se duhet të japim kontributin në komisionet funksionale dhe ky ligj të marrë udhën dhe të aprovohet në Kuvendin e Kosovës.

KRYESUESJA: Faleminderit! Në emër të Qeverisë nuk ka të paraqitur. Fjalën e ka kërkuar zoti Zafir Berisha, urdhëroni!

ZAFIR BERISHA: Faleminderit!

Unë dua të kërkoj falje që nuk kam qenë i njoftuar se ky projektligj është trajtuar në komision. Përndryshe, me gjithë dëshirë do të merrja pjesë edhe do t'i jepja disa sqarime të cilat po mendoj se duhet t'i jap tash, e kam pasur për obligim, po ja që nuk kam qenë i njoftuar, por megjithatë unë mendoj se nuk është vonë.

Siç e potencova, dhe disa nga kolegët pastaj besoj se u dakorduan se ky projektligj nuk e ka qëllimin dhe idenë që t'i hakmerremi dikujt. Ideja e projektligjit është që Republika e Kosovës të distancohet nga e kaluara e hidhur që kanë kaluar qytetarët e Kosovës, veçanërisht shqiptarët.

Aty ku e përmenda rehabilitimin, unë po mendoj se ligji ka më shumë të bëjë me rehabilitimin moral, ndërsa mbështetja për të cilën u fol për ata që kanë pësuar nga regjimi në atë kohë, unë mendoj se disa kategori janë duke u trajtuar me ligje të veçanta për këtë punë. Megjithatë, unë mendoj se nuk është materie e këtij ligji ajo, por që mund të burojë diçka e tillë nga ligji nëse do të ketë nevojë.

Ideja është që jo të trajtohen rreth 70 mijë ish-anëtarë të Lidhjes Komuniste që ka pasur Krahina Socialiste Autonome e Kosovës, por ideja është që të trajtohen me ligj urdhërzbatuesit dhe urdhërdhënësit e regjimit komunist të njëanshëm në Kosovë.

Është një numër i kufizuar i njerëzve, por nuk nënkupton se të gjithë anëtarët e Lidhjes Komuniste dhe unë po mendoj që brenda ligjit është e definuar, veçanërisht neni 13 i ligjit bukur mirë e sqaron se për kë është fjala.

Mendoj se edhe është trajtuar si debat, po asnjëherë nuk ka hy në thelb dhe nuk ka arritur në Kuvend një dokument i shkruar si ky, edhe përkundër se është diskutuar, po e përsërisë disa herë, për këtë ligj ose për natyrën e këtij ligji.

Është një e vërtetë se është marrë si model nga Shqipëria, po e adaptuar në rrethanat që ka kaluar Republika e Kosovës. Unë besoj që ata që e kanë lexuar me vëmendje e kanë parë se brenda ligjit se ligji i trajton qytetarët e Kosovës të lindur para viti '82.

Ideja është se ata që kanë lindur pas viti '82 deri '99 nuk kanë mundur të jenë as anëtarë të sistemit, të regjimit ose të mekanizmave të regjimit vrastar të ish-Jugosllavisë.

Pikërisht, përkon me 2037-tën për shkak se atëherë faktikisht edhe ata që kanë mundur të jenë shumë të rinj pjesë e atij regjimi, do të jenë pensionistë. Kështu që faktikisht, ky është ai përkufizimi pse deri më 2037.

Unë mendoj se komisioni për dallim nga ato vende që e kanë zbatuar një formë të tillë, ndryshon pak gjithmonë me idenë që me i ik politizimit të atij komisioni dhe për këtë arsye më shumë është marrë modeli i themelimit të komisioneve tjera të pavarura të Kuvendit, po që i raportojnë Kuvendit, jo ndonjë mekanizmi tjetër duke llogaritur se Kuvendi është organi më i lartë kushtetues i këtij vendi dhe përgjegjës për rregullim dhe mbarëvajtjen e jetës në këtë shoqëri.

Aty është i kufizuar numri i anëtarëve të komisionit që më shumë është i thirrur që të jetë profesional, dhe natyrisht anëtarët e komisionit duhet të jenë të parët ata që nuk bien ndesh me ligjin, përndryshe atëherë nuk do të ketë kuptim.

Gjykata nuk do merren me ligjin, sepse ata që bien ndesh me ligjin nuk do të shkojnë të trajtohen nëpër gjykata, sepse mendoj se duhej të ishin ligjet tjera që e rregullojnë zbatuesit dhe urdhërdhënësit e politikës gjenocidale.

Ligji, thjesht ua ndalon atyre personave që të jenë bartës të institucioneve. Tash në fund unë mendoj se duhet të t'ia heqim “dushkun kësaj pune” për shkak se të gjithë keni diskutuar dhe keni stërdiskutuar në Kuvend, se janë pikërisht ata njerëz të cilët janë në krye të institucioneve siç e tha njëri prej kolegëve.

Duke qenë njerëz me hipotekë të kaluar ata njerëz janë shantazhuar edhe sot shumë institucione, por veçanërisht organet e drejtësisë, do të thotë ka një krizë morale dhe e kemi një situatë që e kemi dhe që nuk është e lakmueshme.

Ata njerëz që i kanë shërbyer sistemit dhe që kanë vazhduar pastaj t'i shërbejnë grupeve të nëntokës me devotshmërinë që të mund ta shpëtojnë vetveten për shkak të kaluarës, i kanë sjellë në një krizë institucionet dhe natyrisht një pakënaqësi jo vetëm qytetarëve të Kosovës, por edhe një pakënaqësi të qëlluar dhe të arsyeshme të mekanizmave ndërkombëtarë në raport me disa institucione, ku njerëzit jokredibilë janë në krye të tyre.

Po mendoj se, ky ligj është mirë të trajtohet me një seriozitet siç i tha edhe këtu dhe thjesht dalëngadalë me vu dorë përmes ligjit mbi disa individë pa ju hakmarrë po e ripërsëris, të cilët është mirë me leshu rrugë sepse Kosova tashmë ka rrugëtim tjetër dhe nuk mund të mbesë peng i individëve për shkak të së kaluarës së tyre.

E kaluara e tyre le të mbetet në ndërgjegjen e tyre ose le të trajtohet edhe me ndonjë ligj tjetër, por jo për shkak të kaluarës së tyre të mbahet peng e ardhmja e këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! E kemi përfunduar me diskutimet. Ta ka përmendur emrin? Po, urdhëro kryetare e komisionit Albulena.

ALBULENA HAXHIU: Mund të mos jetë shumë e rëndësishme, por megjithatë vetëm si sqarim.

Unë në fillim të fjalimit tim në emër të komisionit kur fola, thash që e kemi ftuar zotin Berisha dhe nuk ka ardhur. Tash e-mail-i i ka shkuar më 20 dhjetor. Ne mbledhjen e kemi mbajtur më 26 dhjetor, pra 6 ditë pas.

Unë i kam këtu edhe dëshmitë që e kemi ftuar, por nuk ka ardhur. Prandaj, vetëm që të jenë në dijeni deputetët dhe qytetarët që po na ndjekin që ne e kemi ftuar, por megjithatë nuk ka qenë i pranishëm. Ndonëse kjo mund të mos jetë e rëndësishme, por meqë tha që s'na kanë ftuar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Nuk ka kuorum për votim, kalojmë në pikën tjetër.

26. Interpelanca e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, zoti Valdrin Lluka, sipas kërkesës së kryetarit të Grupi Parlamentar Partia Socialdemokrate, zoti Dardan Sejdiu, i mbështetur edhe nga 11 deputetë, në lidhje me themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës, shoqëri aksionare NKEC

Në pajtim me iniciuesin deputetin zoti Sejdiu, kjo pikë shtyhet për një seancë tjetër.

Kalojmë në pikën tjetër:

27. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, mbështetur edhe nga 9 deputetë nënshkrues, në lidhje me të drejtat e pensionistëve kontributdhënës

Në konsultim me iniciuesin deputeten Teuta Haxhiu, kjo pikë shtyhet për seancën e radhës.

29. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetit Korab Sejdiu, lidhur me nevojën urgjente për vendosje të sanksioneve ekonomike (përfshirë embargon) dhe sanksioneve politike kundër Serbisë, si masë reciprociteti

Në konsultim me deputetin Korab Sejdiu, edhe kjo pikë shtyhet... Më falni, kishte një gabim.

30. Raporti i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës

Në pajtim me kryetarin e komisionit hetimor, zoti Dardan Sejdiu, edhe kjo pikë shtyhet për seancën e radhës. Pauzë dy deri në tre minuta, vjen kryetari i Kuvendit.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Kemi ardhur në situatën kur janë kryer pothuajse shumica e pikave të rendit të ditës. Në pajtim edhe me kryetarin e komisionit hetimor edhe këtë pikë e kemi shtyrë për seancën e radhës.

Çështja është që këto pika të cilat kanë mbetur, a dëshironi t'i bartni për të shtunën ose nesër siç dëshironi ju? Të shtunën a po? Atëherë i bartim... A dëshironi t'i vendosim menjëherë në vazhdim të seancës në orën 10:00, apo pas saj? Pas asaj seance.

Atëherë po i bartim për ditën e shtunë, pas seancës. Me kaq, sonte i mbyllim punimet. Faleminderit shumë për punën tuaj!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*